


PLANI KOMBETAR

PER EMERGJENCAT CIVILE

Ministria e



Pushtetit Vendor

Decentralizimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT

PLANI KOMBETAR PER EMERGJENCAT CIVILE

Miratuar me VKM nr. 835, dt. 3 Dhjetor 2004

Design: Studio Grafike Elsi Kongo
Shtypi: GentGrafik

PËRMBAJTJA

1. Konsiderata të Përgjithëshme	5
1.1 Parathënie	5
1.2 Qëllimi, synimet dhe parimet	6
1.3 Baza ligjore	7
1.4 Lidhja me planet e tjera	7
2. Organizimi i Sistemit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në Shqipëri	9
2.1 Përgjegjësitë në nivel kombëtar	9
2.2 Përgjegjësitë në nivel qarku	15
2.3 Përgjegjësitë në nivel bashkie dhe komune	16
3. Bashkëndimi	18
3.1 Hyrja dhe përkufizimi	18
3.2 Rolet, funksionet bashkënduese dhe Plani Kombëtar	18
3.3 Përgjegjësitë për bashkëndimin e emergjencave civile	19
4. Parandalimi dhe Lehtësimi	21
4.1 Hyrja dhe përkufizimi	21
4.2 Prioritetet për Parandalimin dhe Lehtësimin	21
4.3 Masat e përgjithëshme për Parandalimin dhe Lehtësimin	22
4.4 Masat shtesë për Parandalimin dhe Lehtësimin	28
4.5 Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes Civile	28
5. Përgatitja dhe Mbrojtja	29
5.1 Hyrja dhe përkufizimi	29
5.2 Plani Kombëtar i Emergjencave Civile për Përgatitjen dhe Mbrojtjen	29
5.3 Institucionet dhe planet e emergjencave	30
5.4 Planet sektoriale të emergjencave dhe gadishmërisë	30
5.5 Identifikimi i rreziqeve të mundëshme	30
5.6 Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rreziqet	31
5.7 Monitorimi dhe mekanizmat aktiv	32
5.8 Njoftimi i hershëm	32
5.9 Punët publike emergjente dhe masa të tjera	32
5.10 Parapërgatitja sezonale dhe masat mbrojtëse	33
5.11 Rolet dhe Përgjegjësitë	33
5.12 Prioritetet për Përgatitjen dhe Mbrojtjen	35
6. Përgjigja	36
6.1 Hyrja	36
6.2 Raportimi i situatave të emergjencave civile	36
6.3 Qendra Kombëtare e Emergjencave Civile	36
6.4 Sistemi Kombëtar i Shërbimit të Emergjencave Civile	37
6.5 Etapat për aktivizimin e sistemit kombëtar	37
6.6 Rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së Përgjigjes	41
6.7 Shpërndarja dhe transmetimi i Informacionit Publik	46
6.8 Asistenca Ndërkombëtare	46
6.9 Doganat, emigracioni dhe karantina	46
6.10 Çështjet financiare	47
6.11 Raportimet dhe vlerësimet	48
6.12 Burimet dhe kapacitetet kombëtare për Përgjigjen në rastet e Emergjencave Civile	48
7. Rikthimi në Gjendjen Normale	52
7.1 Hyrja dhe përkufizimet	52
7.2 Rolet dhe përgjegjësitë	52
7.3 Bashkëndimi dhe informacioni	53
7.4 Largimi ose zvogëlimi i rreziqeve direkte	53

7.5	Stabilizimi i pasojave që vijnë nga burime dytësore rreziku	53
7.6	Proçedurat për rikthimin e sigurt dhe aktivitetin normal	54
7.7	Rivendosja e shërbimeve publike bazë	54
7.8	Strukturat e dëmtuara dhe të shkatërruara	55
8.	Rishikimi dhe Vlerësimi	56
8.1	Hyrje	56
8.2	Përmbledhje e shkurtër mbi momentet kryesore të operacionit	56
8.3	Rishikimi	56
8.4	Vlerësimi	57
8.5	Fazat vijuese	57
9.	Pergatitja e Strukturave (Trainimet)	58
9.1	Parathënie	58
9.2	Qëllimi i programit të trainimit për emergjencat civile	58
9.3	Zhvillimet në fushën e trainimeve	58
9.4	Planet e emergjencave dhe testimi i tyre	59
9.5	Metodologjia e trainimeve dhe grupet përfituese	60
9.6	Stërvitjet në tryezë dhe stërvitjet në terren	60
10.	Masat për Zbatimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile	62
SHTOJCAT		
A.	Rreziqet, Karakteristikat dhe Faktoret që Ndikojnë në Menxhimin e Emergjencave Civile	65
A.1	Termetet	65
A.2	Përmytjet	69
A.3	Bllokimet nga dëbora	75
A.4	Rrëshqitjet e tokës	79
A.5	Zjarret në pyje	82
A.6	Emergjencat industriale dhe teknologjike	85
A.7	Sulmi terrorist	87
B.	Baza Ligjore, Funkcionet dhe Detyrat e Institucioneve	90
C.	Strukturat e Gadishmerise dhe Skemat e Grumbullimit të Informacionit dhe Lajmerimit në Raste të Emergjencave Civile	102
C.1	Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të gatishmërisë të emergjencave civile	102
C.2	Skema e informimit dhe lajmerimit në rast termeti	105
C.3	Skema e informimit dhe lajmerimit në raste aksidentesh industriale	107
C.4	Skema e informimit dhe lajmerimit në raste aksidentesh gjatë transportit të materialeve të rrezikshme	108
C.5	Skema e informimit dhe lajmerimit në raste aksidentesh në det	109
C.6	Skema e informimit dhe lajmerimit në raste aksidentesh ajrore	110
C.7	Skema e informimit dhe lajmerimit në raste aksidentesh shkaktuar nga aktet terroriste	111
C.8	Skema e informimit dhe lajmerimit në raste shperthimi digash dhe dambash	112
D.	Formatet e Raporteve dhe Kerkesave	113
D.1	Raporti i njoftimit të parë	113
D.2	Raporti i të dhënave të para për emergjencën	114
D.3	Formati i raportimit të situatës për organizmat ndërkombëtare	116
D.4	Format kërkesë drejtuar kryeministrit ose ministrit të Mbrojtjes për angazhimin e FA	118
SHKURTIMET		120

I. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

I.1 Parathënie

“Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) është dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile”.

Në kushtet kur ekziston një bazë ligjore, një strukturë në ngritje dhe përmirësim dhe ku burimet shtetërore janë të kufizuara, planifikimi i përdorimit të kapaciteteve, ndarja mirë e përgjegjësi, identifikimi i boshllëqeve dhe shmangia e mbivendosjeve është mjaft e nevojshme. Këto kërkesa bëhen realitet nëpërmjet PKEC-së, që ofron mundësi për menaxhim efektiv të strukturave shtetërore dhe joshtetërore për përballimin e emergjencave civile. PKEC-ja duhet të shihet si dokument praktik, i hartuar nëpërmjet një procesi të gjatë konsultimesh dhe planifikimi të përbashkët me një numër të gjerë institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, për ta mbajtur planin koherent dhe të freskuar me informacion të ri në mënyrë të vazhdueshme, aktual e të lidhur me ndryshimet e mjedisit shqiptar, për të arritur qëllimin për të cilin është hartuar: mbrojtjen e popullsisë, të pronës dhe të trashëgimisë kulturore nga emergjencat civile.

Është e rëndësishme të theksohet se PKEC-ja është një burim praktik i përdorshëm për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, duke filluar nga parapërgatitja, përgjigjja dhe duke vazhduar më tej në fazën e rikthimit në gjendjen normale dhe lehtësimin e pasojave. Seksioni 6 i Planit, i cili mbulon fazën e përgjigjes ndaj emergjencave civile, mund të shkëputet përkohësisht për t’u mbajtur më vete gjatë periudhës së emergjencës, për të shërbyer si mjet praktik për bashkërendimin e aktiviteteve në përgjigje të situatës në terren. Të gjitha seksionet e planit janë hartuar në mënyrë të tillë për të qenë në harmoni dhe në mbështetje të fazave që paraqesin dhe përmbajnë referenca për shtojcat, të cilat përfshijnë udhëzues, standarde dhe lista informative.

Për arsye se PKEC-ja është hartuar nga vetë protagonistët pjesëmarrës, ai është pronë e të gjitha ministrive dhe autoriteteve në qarqe, komuna dhe bashki, e të gjitha organizatave shtetërore dhe të shoqërisë civile, institucioneve, organizatave vullnetare dhe e publikut të gjerë

Ai është dokument, i cili reflekton përvojën për një sërë dukurish të mundshme rreziku, kapacitetet dhe vështirësitë në përballimin e emergjencave civile në Shqipëri.

PKEC-ja shërben si burim i gjallë, real, një manual ku përmbledhen informacione, në të cilin janë përshkruar faktorët më të rëndësishëm dhe rolet e të gjitha institucioneve dhe të strukturave të përfshira në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile. PKEC-ja nuk do të jetë asnjëherë plotësisht i përfunduar ose i mbyllur. Ai duhet të rishikohet e të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar bashkëpunimin e përhershëm dhe ndryshimet në nevoja dhe burime të Shqipërisë. Fuqia e PKEC-së qëndron në bashkëpunimin dhe konsensusin e të gjitha institucioneve dhe strukturave, për të zvogëluar rreziqet, për të shpëtuar jetë njerëzore dhe për të minimizuar dëmtimet që vijnë si rrjedhojë e emergjencave civile në Shqipëri.

Shqipëria është mjaft e ekspozuar përballë një numri të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish që mund të vijnë nga veprimtaria njerëzore.

Rreziku më i madh nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tërmetet, por kohët e fundit kanë qenë mjaft evidente përmytjet, rrëshqitjet e tokës apo emergjencat dimërore, edhe pse të shkallëve të vogla deri tek të mesme. Nisur nga gjendja ekonomike, infrastruktura, mjetet e pakta të komunikimit, emigrimi masiv, bumi i ndërtimeve si dhe një numër faktorësh që lidhen me shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore, si: pyjeve, burimeve ujore dhe ndotja e mjedisit, e bëjnë më të prekshme popullsinë dhe ekonominë e saj ndaj këtyre dukurive.

Për të identifikuar rreziqet, si dhe për të pasur informacion për humbjet dhe dëmet e pritshme, gjatë vitit 2003, u realizua për herë të parë vlerësimi i rreziqeve në nivel kombëtar. Studimi me titull “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri” harmonizon rezultatet dhe gjetjet nga mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe analiza e bërë gjatë një viti pune. Studimi “Vlerësimi i rreziqeve” përmban seksione të përqendruara në rreziqe të veçanta për dukuritë e mundshme të rrezikut, si: tërmetet, përmytjet, bllokimi nga bora, rrëshqitjet e tokës, zjarret në pyje dhe sëmundjet e mundshme infektive. “Vlerësimi i rreziqeve” është një hap mjaft i rëndësishëm përpara dhe shërben si bazë në procesin e hartimit të PKEC-së, duke siguruar bazën informative në të cilën mund të hartohet një plan më efektiv. Synimi kryesor i këtij studimi është të japë drejtimit bazë për planifikimin, mbi bazën e të dhënave të të cilit mund të ngrihen skenarë të mundshëm për përballimin e emergjencave civile si dhe për të pasur informacion për dëmet e mundshme. Studimi tjetër me titull “Vlerësimi i prekmërisë dhe i kapaciteteve në nivel lokal” pasqyron kapacitetet dhe mundësitë që ka komuniteti për të zvogëluar rrezikun dhe për të përballuar emergjencat e mundshme, si dhe jep të dhëna të cilat duhen mbajtur në konsideratë gjatë planifikimit në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

1.2 Qëllimi, synimet dhe parimet

PKEC-ja është dokument i rëndësishëm i hartuar në mbështetje të ligjit nr. 8756, datë 26 mars 2001, “Për emergjencat civile” dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me emergjencat civile.

Duke mbledhur së bashku dhe duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve, strukturave shtetërore dhe shoqërisë civile, nëpërmjet PKEC-së synohet:

- Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
- Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.
- Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Nëpërmjet këtij plani krijohen rrugët e komunikimit dhe të shkëmbimit të informacionit të duhur, forcimi i vendimmarrjes dhe, nëpërmjet bashkërendimit, arrihet forcimi i kapaciteteve të përgjigjes në të gjitha fazat e ciklit të emergjencave civile. PKEC-ja, në thelb, është mjet bashkërendimi, i cili, nëse përdoret në mënyrë korrekte:

- do të shpëtojë jetë njerëzore dhe pasuri,
- do të rritë ndikimin e kapaciteteve ekzistuese,
- do të sigurojë mjetet për kërkimin e burimeve dhe të ndihmës shtesë.

Në planin afatgjatë, qëllimi kryesor është ai i parandalimit e lehtësimit dhe PKEC-ja është rruga e nevojshme për t’u ndjekur në arritjen e këtij qëllimi. Sjellja së bashku që në kohë të qetë e të gjithë protagonistëve me synimin, krijimin e një tabloje dhe klime bashkëpunimi është mjaft e rëndësishme. Kjo krijon mundësinë për dhënie përparësi çështjeve të veçanta dhe zgjidhjen e tyre në vijimësi në kohë dhe kushte për trajtimin e bashkërenduar, i cili është i nevojshëm për të kërkuar ndihmën ndërkombëtare shtesë.

Procesi i hartimit të PKEC-së është udhëhequr nga disa parime të cilat do të jenë të njëjta edhe në procesin e zbatimit të tij.

- Plani është përqendruar në objektiva të përgjithshëm të hartuar dhe të miratuar në mënyrë të qartë.
- Të gjithë objektivat specifike në PKEC do të jenë koherentë me objektivat e përgjithshëm.
- Plani reflekton ligjet dhe vendimet ekzistuese, të cilat, në këmbim, do ta forcojnë atë.

- Plani përfshin të dhëna, informacion nga të gjitha institucionet në mënyrë të përshtatshme.
- Plani do t'i qëndrojë besnik objektivave të tij dhe nuk do të negociohet në asnjë çast deri në mediokritet, për të shmangur sfidat ekzistuese dhe ato të parashikuara.
- Struktura bazë e planit, e plotësuar me të dhëna për kapitujt bazë dhe anekse, do ta kompletojë atë, duke e bërë një burim të përdorshëm të cilit duhet t'i referohen strukturat përkatëse.
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë bazën, shpirtin dhe elementet të cilat prekin planin në tërësi, për të rritur në maksimum ndikimin e të gjitha burimeve të disponueshme si dhe sigurimin e konsensusit.
- Qartësia e përgjegjësive, funksionet dhe detyrat themelore, si përgjegjësi dhe si vendimmarrje paraprake janë përfshirë në këtë plan.
- Plani inkurajon iniciativa dhe nuk shndërrohet në instrument ndalues për strukturat dhe njerëzit që duhet të veprojnë.
- Plani do të mbetet punë në progres, por një punë mjaft këmbëngulëse për të qëndruar i përshtatshëm dhe për të qenë në gjendje të kapërcejë ndryshimet e mjedisit të jashtëm.

I.3 Baza ligjore

Procesi i hartimit të të parit PKEC në Shqipëri është ndërmarrë bazuar në një bazë ligjore, referuar ligjit nr. 8756, 26 mars 2001, “ Për emergjencat civile”.

Formati i PKEC-së reflekton kërkesat e bazës ligjore për Shërbimin e Emergjencave Civile (SHEC) në Shqipëri dhe në këtë mënyrë përmbledh katër seksione të veçanta të cilat paraqesin katër fazat kryesore të ciklit të emergjencave.

Institucionet dhe strukturat e ndryshme, në aktivitetin e tyre të përditshëm, funksionojnë mbi bazën e akteve ligjore, shumë prej të cilave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, prekin probleme që kanë të bëjnë me emergjencat civile. Për këtë arsye PKEC-ja i është referuar dhe ka marrë shumë nga ato, për të qenë i bazuar dhe i zbatueshëm.

Kjo është bërë për t'i dhënë hapësirë ligjore zbatimit të këtij plani, duke u krijuar mundësinë strukturave shtetërore dhe joshtetërore për të vepruar në mënyrë efektive dhe për t'iu përmbajtur detyrimeve ligjore në lidhje me emergjencat civile.

Vërehet, gjithashtu, se për zbatimin sa me korrekt të këtij plani dhe për ushtrimin e kompetencave të strukturave të përfshira, në disa drejtime ose sektorë të veçantë lind nevoja e akteve të tjera ligjore e nënligjore, veçanërisht për aspektin e parandalimit të emergjencave civile, ku vlen të theksohet rëndësia që kanë përpjekjet e strukturave për t'i zbatuar ato.

Në shtojcën “B”, e cila ka të bëjë me rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve, ka më shumë informacion për bazën ligjore mbi të cilën funksionojnë strukturat e tyre.

I.4 Lidhja me planet e tjera

PKEC-ja është dokument harmonizues, gjithëpërfshirës, i cili mbledh së bashku të gjitha institucionet dhe strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare në përgjigjen ndaj emergjencave civile. Ministritë, drejtoritë, strukturat lokale dhe institucione të ndryshme kanë hartuar dhe do të hartojnë planet e tyre të emergjencave civile. Planet specifike sektoriale kanë vlerë të veçantë dhe PKEC-ja nuk i zëvendëson ato, por i harmonizon dhe i sjell ato së bashku në një frymë bashkërendimi.

PKEC-ja është hartuar përmes konsultimeve dhe shkëmbimit të informacioneve me institucione të ndryshme, si rrjedhim, përfshin idetë dhe procedurat e planeve specifike, duke i lidhur ato me përgjigjen e planifikuar të institucioneve, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Në mënyrë të veçantë në seksionin 6 (Përgjigjja), procedurat e bashkërendimit dhe të vendimmarrjes dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit në nivel kombëtar janë ilustruar në mënyrë të qartë për institucionet dhe strukturat përkatëse. PKEC-ja nuk i përjashton dhe as i zëvendëson planet e ministrive të linjës, ato të qarqeve, bashkive, komunave, objekteve të rëndësishme ekonomike shtetërore dhe joshtetërore, përkundrazi, i përfshin ato duke mos rënë ndesh, i stimulon dhe i mbështet ato. Planet e ministrive, të institucioneve të tjera qendrore, qarqeve, bashkive, komunave dhe të

gjitha institucioneve të tjera shtetërore e subjekteve private do të plotësojnë pamjen e përgjithshme në nivel kombëtar, duke ushqyer procesin e vendimmarrjes, i cili, nga ana tjetër, do të plotësojë dhe do të forcojë përgjigjet sektoriale dhe strukturat e përfshira në këtë proces.

PKEC-ja, për shkak të përfshirjes së një kuadri më të gjerë, shkon përtej planeve specifike dhe paraqet lidhjet drejtpërdrejt funksionale nëpërmjet shtetit dhe ndihmës ndërkombëtare, përmes Planit të Gatishmërisë të Agjencive të Kombeve të Bashkuara (PGAKB). Ky është aspekt i rëndësishëm i një plani kombëtar për emergjencat, për faktin se ndihma ndërkombëtare thithet në bazë të informacionit të bashkërenduar e të konsoliduar në lidhje me nevojat dhe kapacitetet e disponuara.

PKEC-ja reflekton përgjegjësi me të gjera, jo vetëm në përgjigje, por edhe në parandalim, lehtësim, përgatitje, mbrojtje dhe rikthim në normalitet.

Pas PKEC-së, planet e emergjencave civile të niveleve dhe të strukturave të ndryshme duhen rishikuar dhe përpunuar, që edhe ato të jenë koherente dhe të përshtatshme. Vazhdimisht do të lindë nevoja e përgatitjes së planeve të reja, siç janë planet e gatishmërisë të cilat hartohen për një ngjarje që ka mundësi të ndodhë në një kohë të afërme dhe të shërbejnë për një periudhë kalimtare deri sa të hartohen planet e emergjencave.

Veçanërisht të aplikueshme këto plane janë për rreziqet stinore ose për ato rreziqe të cilat më parë nuk kanë qenë potenciale.

2. ORGANIZIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCEVE CIVILE NË SHQIPËRI (SMEC)


SMEC-ja në Shqipëri përbëhet nga struktura të përhershme dhe të përkohshme në nivel qendror, qarku dhe lokal. Nëpërmjet këtyre strukturave, çdo ministri, drejtori ose institucion, aktualisht, ka role dhe përgjegjësi të veçanta për të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave. Këto role dhe përgjegjësi ndahen shpesh ndërmjet dy ose më shumë institucioneve, të cilat merren, për shembull, me çështje të tilla, si: furnizimin me ujë, hapjen e kanaleve, ngritjen e mureve mbajtëse, digat ose pritat, si dhe me çështje të tjera. Për të krijuar një pamje më të qartë dhe për arritjen e një bashkërendimi sa më funksional të roleve dhe të përgjegjësive të këtyre strukturave, ku përfshihen institucione shtetërore dhe joshtetërore, këto përgjegjësi janë përshkruar në detaje në seksionin 6, “Përgjigjja”; gjithashtu, janë paraqitur të veçuara për çdo ministri dhe institucion, në shtojcën “B”.

Këto role dhe përgjegjësi tashmë janë të përfshira në planet specifike ekzistuese për emergjencat civile të hartuara nga këto institucione. Kur këto institucione kanë rol të caktuar në fazën e përgjigjes, pothuajse në më të shumtën e rasteve ato do të kenë rol korrespondues në fazat e tjera të ciklit të menaxhimit të emergjencave, duke përfshirë këtu parandalimin dhe lehtësimin. Detajet e paraqitura në seksionin 6 “Përgjigjja” dhe në shtojcën “B” u japin mundësi përdoruesve të këtij plani të identifikojnë menjëherë rolet parësore/përparësore dhe të përcaktojnë cili institucion apo organizatë duhet të jetë përgjegjës për të zbatuar/përmbushur një detyrë të caktuar gjatë gjithë fazave të ciklit të menaxhimit të emergjencave.

2.1 Përgjegjësitë në nivel kombëtar

2.1.1 Këshilli i Ministrave (KM)

Këshilli i Ministrave drejton SKMEC-në në Shqipëri. Ai miraton strategjitë, politikat dhe programet të cilat kanë si qëllim parandalimin, lehtësimin, përgatitjen dhe përgjigjen ndaj situatave të



emergjencave civile. Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, instrumentet e tjera ligjore, marrëveshjet ndërkombëtare dhe konventat, parashikon fonde për forcimin e sistemit të mbrojtjes ndaj emergjencave të cilat kërcënojnë popullsinë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Kur shtrirja e emergjencës civile i kalon mundësitë e komunës, të bashkisë dhe të qarkut dhe kërkohet të aktivizohen kapacitetet e qarqeve të tjera ose ato qendrore, Këshilli i Ministrave, pas mbledhjes së të dhënave të nevojshme, shpall gjendjen e emergjencave civile në një zonë të caktuar ose në të gjithë vendin.

Me shpalljen e gjendjes së emergjencës civile, Këshilli i Ministrave:

- Krijon Komitetin Ndërmintor të Emergjencave Civile (KNEC).
- Cakton kryetarin e KNEC-së, i cili mund të jetë zëvendëskryeministër ose një ministër, në varësi të natyrës/llojit të emergjencës civile.
- Informon presidentin e Republikës dhe Kuvendin e Shqipërisë për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe për masat e marra deri në këtë moment.
- Kur është e nevojshme, kërkon nga Kuvendi i Shqipërisë miratimin e akteve ligjore.
- Nëse është e nevojshme, vendos rialokimin e fondeve shtetërore dhe i propozon Kuvendit të Shqipërisë ndryshimin e ligjit ekzistues "Për buxhetin".

2.1.2 Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile

Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile (KNEC) bashkërendon aktivitetet e të gjitha institucioneve të përfshira në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj situatës së emergjencës civile. Këto aktivitete janë:


- Përgatit dhe drejton apel për ndihmë ndërkombëtare në rast se është e nevojshme, procedurat e të cilit ndiqen nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ).
- Bashkërendon veprimet dhe aktivitetet e institucioneve të strukturave qendrore, vendore, Kryqit të Kuq Shqiptar (KKSH), organizatave vullnetare dhe donatorëve.
- Kërkon përfshirjen e plotë të institucioneve të përfshira në PKEC, si dhe angazhimin e tyre në të gjitha veprimet e nevojshme për përballimin e situatës së emergjencës civile.
- I kërkon Këshillit të Ministrave përdorimin e rezervave shtetërore, përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në zonën e goditur nga emergjenca, si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare që vihen në dispozicion për përballimin e emergjencës.
- Drejton procesin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, analizon mundësitë e riaftësimit të zonës/ave të goditura dhe i propozon Këshillit të Ministrave rrugët e zgjidhjes.
- Në zbatim të detyrave dhe funksioneve të tij, KNEC-ja nxjerr vendime, urdhra dhe udhëzime, të cilat kanë fuqi vepruese për sa kohë zgjat gjendja e emergjencës civile (EC).
- Përfundon aktivitetin e tij në momentin kur mbaron gjendja e emergjencës civile.
- Për drejtimin e operacioneve të përgjigjes ndaj emergjencave civile, KNEC-ja cakton drejtuesin qendror të operacionit (DQO).

2.1.3 Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (MPVD)

MPVD-ja zbaton politikat e Këshillit të Ministrave në fushën e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile. Nëpërmjet strukturave të saja të përhershme, ministria monitoron gjendjen e emergjencës në të gjithë territorin e Shqipërisë, ndërsa në kohë të qetë dhe në gjendjen e gatishmërisë, në rastet e emergjencave të shkallës së ulët, bashkëpunon me institucionet dhe strukturat qendrore të cilat janë të përfshira në çështjet e emergjencave civile. Me shpalljen e gjendjes së emergjencës civile, siguron staf shtesë për Departamentin e Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile (DPPEC).

Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit:

- Bashkërendon veprimet ndërmjet institucioneve të cilat kanë detyra për monitorimin, informimin, planifikimin dhe përgjigjen në nivel qendror dhe lokal, Kryqin e Kuq Shqiptar (KKSH), vullnetarët, donatorët, strukturat vendore oganizatata ndërkombëtare, përmes fazave të ciklit të menaxhimit të emergjencave civile.



- Në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, prefektët e qarqeve dhe drejtuesit në nivel lokal, vlerëson nivelin e dëmeve të shkaktuara, u kërkon strukturave dhe shërbimeve të duhura të ndërhyjnë në përgjigje ndaj emergjencës dhe bën propozimet e nevojshme për deklarimin e gjendjes së emergjencës civile (GJEC).
- Informon agjencitë ndërkombëtare, organizatat jofitimprurëse dhe donatorët brenda vendit për nevojat dhe domosdoshmërinë e asistencës.
- Përcakton rregullat e përdorimit të fondeve dhe të ndihmave humanitare për zonat e prekura nga emergjenca.
- Bashkërendon aktivitetet e administratës të Ministrisë dhe të strukturave vartëse me kërkesat e KNEC-së dhe DQO-së.
- Propozon ngritjen e strukturave shtesë për të funksionuar në mënyrë më efektive në përgjigje të emergjencës, nëse është e nevojshme, dhe propozon hartimin e VKM-ve me kërkesa të veçanta për trajnimin e personelit të përfshirë në emergjencat civile.

2.1.4 Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile (DPPEC)

DPPEC-ja është strukturë e përhershme e specializuar, e cila merr pjesë në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave civile. Departamenti është drejtpërdrejt përgjegjës për koordinimin në çastet e para të përgjigjes në një situatë emergjente.

Në kohë të qetë, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile (QKOEC), DPPEC-ja:

- Mban nën kontroll situatën e emergjencës në të gjithë territorin e vendit.
- Mban kontakte të vazhdueshme me zyrat e emergjencave civile në 12 qarqet e Shqipërisë, si dhe me sektorët e emergjencave civile të institucioneve qendrore.

Në etapën e “alarmit për rritjen e gatishmërisë” dhe fillimin e “përgjigjes”, DPPEC-ja:

- Mbështet QKOEC-në me staf shtesë për të monitoruar situatën ose për të menaxhuar një situatë emergjente e cila është në shfaqje.
- Mban kontakte të vazhdueshme me strukturat e monitorimit, të informimit dhe strukturat operacionale.
- Mban kontakte të vazhdueshme me organet e pushtetit vendor.
- Vlerëson dëmtimet dhe nevojat, siguron informacion dhe masa për përballimin e emergjencave civile.
- Bashkërendon aktivitetet e strukturave të përfshira në përgjigjen ndaj emergjencës civile.
- Bën analizën e informacionit, nxjerr përfundime dhe u bën propozimet e nevojshme strukturave eprore.

Në momentin kur shpallet GJEC, DPPEC-ja:

- Këshillon dhe siguron informacion mbështetës për KNEC-në, MPVD-në dhe DQO-në.
- Harton dhe analizon të dhënat, llogaritjet statistikore, kërkon dhe jep informacion për lehtësimin e menaxhimit të operacioneve dhe të aktiviteteve në përgjigje të emergjencës.
- Këshillohet me Komisionin Teknik Këshillimor të Emergjencave Civile (KTKSEC) për ngjarjen specifike.

2.1.5 Ministrinë e linjës

Çdo ministri është përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave civile sipas fushës së tyre të veprimtarisë. Aktivitetet e tyre përfshihen në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave dhe, sipas rastit, ato luajnë rolin drejtues ose mbështetës, në varësi të natyrës së emergjencës së shfaqur. Sidoqoftë, për të qenë efektive në kryerjen e detyrave dhe sigurimin e nevojave për përballimin e emergjencave civile, kërkohet bashkërendimi i kapaciteteve të një numri të madh institucionesh. Kur deklarohet GJEC-ja, ministrinë përkatëse të linjës dërgojnë përfaqësuesit e tyre pranë QKOEK-së. Ata sjellin me vete të dhënat e tyre, informacionin për burimet dhe kapacitetet e ministrive dhe kanë autoritetin për t'u përfshirë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me përdorimin e kapaciteteve të ministrive që përfaqësojnë.


Kur është e nevojshme, ministrinë përkatëse sigurojnë shërbime specifike, ngrënë struktura të veçanta që merren me situatat e emergjencave civile dhe lehtësojnë përfshirjen e administratave të tyre në përgjigje të situatave të emergjencave civile.

2.1.6 Forcat operacionale (FO)

Forcat kryesore operacionale ose strukturat vepruese aktive në Shqipëri përbëhen nga:

- Forcat e Armatosura (FA).
- Strukturat e PMNZSH-së.
- Shërbimi i urgjencës (SHU).
- Policia e Shtetit (PSH) dhe policitë e tjera.
- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit (DPRSH).
- Grupet e specializuara për minierat, për naftën etj.
- Struktura monitoruese dhe vepruese mbështetëse.

Këto struktura kanë role, detyra dhe përgjegjësi të veçanta për të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave dhe është thelbësore që ato të bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra-tjetrën për të siguruar përgjigjen më efektive të mundshme.



2.1.7 Drejtuesi Qendror i Operacionit (DQO)

DQO-ja është drejtuesi kryesor i aktiviteteve të përgjigjes në nivel qendror. Ai zgjidhet nga stafet e përgatitura dhe të trajnuara për drejtimin dhe menaxhimin e operacioneve të përgjigjes ndaj emergjencave civile:

- Drejton operacionet e strukturave aktive operacionale dhe mbështetëse të nevojshme për t'iu përgjigjur situatës së emergjencës civile.
- Në punën e tij për menaxhimin e operacioneve të emergjencave civile ndihmohet nga ekipi i menaxhimit të emergjencave civile (EMEC) (Task Force), i cili funksionon pranë QKOEC-së.
- Konsultohet me drejtuesit e strukturave operacionale aktive, drejtuesit e strukturave monitoruese dhe strukturave mbështetëse operacionale, si dhe me menaxherë dhe specialistë të tjerë të punësuar në institucionet e përfshira në PKEC.
- Organizon ndarjen dhe dërgimin e grupeve ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit (KSH), zbaton masat e duhura për lehtësimin e operacioneve të tyre dhe plotëson kërkesat e tyre për të arritur rezultatin maksimal në përgjigje të emergjencës.
- Nxjerr urdhrat dhe udhëzime të nevojshme për menaxhimin e operacioneve të përgjigjes ndaj emergjencës civile.
- Njofton KNEC-në dhe zbaton detyrat e dhëna prej tij.
- Merr të gjitha masat për përfshirjen e forcave operacionale, të grupeve të tjera dhe të individëve të cilët duan të kontribuojnë me kapacitetet e tyre në përballimin e situatës.
- Bashkërendon aktivitetet e drejtuesve të operacioneve të niveleve të ndryshme dhe ato në nivel lokal.


2.1.8 Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (QKOEC)

Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (QKOEC) shërben si një qendër informacioni dhe koordinimi për emergjencat civile në Shqipëri. Qendra luan rol aktiv në të katër fazat e menaxhimit të emergjencave, veçanërisht për grumbullimin dhe analizën e informacionit. Roli i saj në përshtatje me situatën konkrete emergjente është si më poshtë:

a) Në kohë të qetë ose situatë jo-emergjente civile

Në kohë të qetë, QKOEC-ja përbëhet nga stafi i përhershëm, bazuar në një strukturë të miratuar dhe:

- monitoron situatën emergjente në të gjithë territorin e vendit gjatë 24 orëve;
- vendos dhe mban kontakte të vazhdueshme me të gjitha strukturat e emergjencave civile (SEC) në gatishmëri, të cilat janë detajuar në shtojcën "C";



- informon instancat qendrore dhe lokale për situatën në vazhdim dhe përgatit raporte çdo 24 orë për situatat emergjente në të gjithë vendin.

b) Në kohë gadishmërie (Alarmi dhe Gadishmërie):

Në këtë kohë stafi i përhershëm i QKOEK-së mbështetet nga stafi i Drejtorisë së Planifikimit dhe të Koordinimit të Emergjencave Civile (DPKEC) dhe PMNZSH-ja. Detyrat kryesore gjatë kësaj kohe janë:

- informimi i strukturave operacionale për vendosjen në gjendje gatishmërie;
- aktivizimi i strukturave të tjera të nevojshme;
- monitorimi i situatës dhe mbledhja e informacionit;
- bashkërendimi i aktiviteteve të strukturave operacionale për përgjigjen në nivel qarku, bashkie dhe komune.


c) Në kohën kur është shpallur Gjendja e Emergjencave Civile (Aktivizimi):

Menjëherë pas shpalljes së gjendjes së emergjencës civile, QKOEK-ja vendoset në dispozicion të DQO-së. QKOEK-ja është vazhdimisht përgjegjëse për të përmbushur detyrat, si: sigurimin e komunikimit, sigurimin e të dhënave për situatën në terren, bashkërendimin e aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve të emergjencës civile.

Me deklarin e gjendjes së emergjencës civile, pranë QKOEK-së, sipas situatës dhe nevojës, mblidhet dhe funksionon ekipi i menaxhimit të emergjencës civile (EMEC), pjesëtarë të të cilit janë përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve qendrore.

Në këtë rast, EMEC-ja funksionon mbi bazën e katër sektorëve kryesorë, të cilët janë:

- sektori i informacionit (personeli i përhershëm i QKOEK-së, zëdhënësi),
- sektori i planifikimi,



- sektori operacional,
- sektori i logjistikës.

Përbërja e këtyre katër sektorëve mund të ndryshojë në varësi të natyrës dhe të situatës së emergjencës civile. Megjithatë, parimi bazë është ai i përfaqësimit në këta sektorë të institucioneve që lidhen me natyrën e tyre. Për shembull, sektori operacional përbëhet nga përfaqësuesit e atyre ministrive ose institucioneve që kanë forca operationale etj. Detyrat dhe funksionimi i saktë i QKOEK-së dhe i sektorëve që krijohen me shpalljen e gjendjes së emergjencave civile përshkruhen më në detaje në rregulloren e QKOEK-së, e cila përmban detyra dhe përgjegjësi që u përkasin etapave dhe fazave të ciklit të emergjencave civile.

2.2 Përgjegjësitë në nivel qarku

2.2.1 Prefekti i Qarkut

Prefekti i qarkut kryen këto detyra:

- Monitoron dhe menaxhon situatën emergjente nëpërmjet koordinimit të strukturave qendrore të pranishme në këtë nivel, të cilat janë përfshirë në planet e emergjencave në nivel rajonal ose “qark”.
- Thërret komisionin e emergjencave civile në qark (KECQ).
- Kërkon ndihmë kur situatat e emergjencës civile janë përtej mundësive apo kapaciteteve të qarkut, duke kërkuar të shpallet gjendja e emergjencës civile në një pjesë ose në të gjithë territorin e qarkut.
- Mban kontakte të vazhdueshme dhe bashkërendon veprimet me MPVD-në (DPPEC), me KNEC-në si dhe me DQO-në, në varësi të situatës, dhe me kryeministrin.

2.2.2 Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark (KPPECQ)

Detyrat e këtij komisioni janë:

- Bashkërendon veprimet institucionale të nevojshme në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj emergjencës civile.
- Bashkërendon veprimet e strukturave qendrore të pranishme në nivel rajonal me veprimet dhe aktivitetet e strukturave lokale, të KSSH-së, të vullnetarëve dhe të donatorëve të ndryshëm.
- Vlerëson nevojat materiale dhe financiare, dëmtimet e shkaktuara, kostot e rehabilitimit të rajonit të prekur nga fatkeqësia dhe kërkon mbështetjen e strukturave të tjera qendrore në nivel rajonal.
- Bashkërendon forcat operationale të përfshira dhe grupet e ndihmës dhe ato vullnetare të cilat veprojnë në rajon me organet e pushtetit vendor.

2.2.3 Drejtuesi i Operacionit në Qark (DOQ)


Në situatën e emergjencës civile, burimet materiale dhe njerëzore të listuara në planet e emergjencave të qarkut vendosen nën autoritetin e drejtuesit të operacionit në qark (DOQ). Ai/Ajo bëhet përgjegjës për menaxhimin e situatës së emergjencave civile në qark dhe kryen këto detyra:

- Bashkërendon strukturat qendrore në nivel lokal, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihmë.
- Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e tjerë të operationeve në nivel vendor dhe të qarqeve fqinje, informon dhe kërkon asistencë nga KPPECQ-ja dhe DQO-ja.

2.2.4 Në nivel rrethi

Nënprefekti ka këto përgjegjësi dhe detyra :

- Informon prefektin për mundësinë e ndodhjes apo ekzistencën e një situatë emergjence në



rrethin ku ushtron detyrat e tija funksionale.

- Në bashkëpunim me drejtuesit e forcave operacionale, bashkërendon përgjigjen dhe kërkon ndihmë për ndërhyrje të strukturave të tjera jashtë territorit të rrethit.
- Raporton tek prefekti dhe KPPECQ-ja për situatën e emergjencave dhe aktivitetet në përgjigje të saj, bashkërendon aktivitetet e forcave që vijnë në ndihmë.

2.2.5 Këshilli i Qarkut

Këshilli i qarkut është i përfshirë në menaxhimin e emergjencave civile, duke bashkëpunuar me administratën e prefektit, KPPECQ-në, si dhe me autoritetet e bashkisë dhe të komunës. Në raste të situatave të emergjencave civile, këshilli i qarkut kryen këto detyra:


- Angazhon administratën dhe strukturat e tija aktive në procesin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara dhe të nevojave, si dhe në përballimin e situatës emergjente.
- Në bashkëpunim me strukturat e tjera lokale, përcakton vendet për krijimin e vendbanimeve të përkohshme, magazinat e përkohshme dhe pikat e shpërndarjes, terrenet për varreza masive dhe nevoja të tjera të mundshme.

2.3 Përgjegjësitë në nivel bashkie dhe komune

Bashkitë dhe komunat kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki, komunë, njësitë bashkiake në Bashkinë e Tiranës bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin dhe freskojnë periodikisht.

Çdo bashki dhe komunë, duke përfshirë dhe njësitë bashkiake të Bashkisë së Tiranës, krijojnë dhe mbajnë një sistem të:

- Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kyç.
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.
- Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.
- Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca.



2.3.1 Komisioni Vendor i Emergjencave Civile (KVEEC) është përgjegjës për:

- Hartimin e masave për parandalimin, lehtësimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile.
- Sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta.
- Vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave.
- Mbajtjen e kushteve higjienike duke siguruar furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe kujdesjen për viktimat.
- Bashkërendimin dhe mbështetjen për grupet e kërkim-shpëtimit dhe të vullnetarëve.
- Çështje të tjera që kanë për qëllim përgjigjen efektive ndaj situatës së emergjencës civile.

3. BASHKËRENDIMI

3.1 Hyrje dhe përkufizimi

Bashkërendimi është mjaft i gjerë dhe i domosdoshëm në të gjithë fazat e një emergjence civile. Bashkërendimi ka të bëjë me shkëmbimin e informacionit si dhe me koordinimin e një sërë aktiviteteve të strukturave të ndryshme për të bashkuar përpjekjet në menaxhimin e situatave emergjente. Rëndësia e bashkërendimit del më në pah veçanërisht në fazën e reagimit të menjëhershëm, në të cilën nevojitet koordinim efektiv për të minimizuar boshllëqet, për të shmangur dublimet, asistencën dhe ndërhyrjet jo të përshtatshme, vonesat, pengesat si dhe ngadalësitë në reagim e veçanërisht në vendimmarrje. Bashkërendimi i dobët sjell përgjigje jo të kënaqshme ndaj situatës së emergjencës.

Në këto raste rritet zhgënjimi i panevojshëm nga ana e të mbijetuarve për strukturat zyrtare dhe atyre që merren me dhënien e asistencës.

Situata emergjente shpesh karakterizohet nga një gjendje kaotike dhe paniku, qoftë nga masat e gjera të popullsisë së prekur, ashtu edhe nga strukturat të cilat merren me menaxhimin e kësaj situatë, prandaj aktivitetet dhe kapacitetet duhet të jenë në mënyrë sa më të harmonizuar që përgjigja dhe efektet të jenë sa më pozitive. Situata mund të duket e rrëmuishme, por duhet të kuptohet që bashkërendimi lind nga veprimet e menduara për të harmonizuar përgjigjet e individëve dhe të grupeve të ndryshme, për të maksimalizuar ndikimin dhe sjelljen e situatës në një gjendje të tillë ku efektet dhe ndikimet negative në jetesën e komunitetit të jenë sa më të pakta.

Për këtë arsye, bashkërendimi, edhe pse më pak i dukshëm, është po ashtu një lloj i rëndësishëm si në fazën e përgjigjes edhe gjatë fazave të tjera të ciklit të menaxhimit të emergjencave. Për shembull, në fazën e lehtësimit të situatës, bashkërendimi i mirë midis institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e ujëmbledhësve, mirëmbajtjen e kanaleve tretësore, dytësore dhe parësore, stacioneve të pompimit, furnizimit me energji elektrike dhe menaxhimit të tokës për përdorim në nivel lokal, mund të sjellë si rrjedhojë zvogëlimin në mënyrë të dukshme të numrit të njerëzve të prekur nga përmbytjet ose, dhe në disa raste, parandalimin e përmbytjes.

Prandaj, në rastin më të mirë, bashkërendimi përbëhet nga një sërë aktiviteteve të cilat shtojnë në maksimum efektivitetin në menaxhim, duke sjellë rezultate më të mira të pritshme, shërbime të shpërndarjes në kohën e duhur dhe kërkon burime të mjaftueshme për arritjen e rezultateve të pritshme, të tilla, si: sa më pak vuajtje njerëzore dhe dëme materiale, rikthim i shpejtë në kushtet normale të jetesës dhe përmirësim i masave parandaluese dhe lehtësuese të pasojave, përkundrejt situatave të emergjencave në të ardhmen, të cilat shihen gjithashtu si përbërës të procesit të zhvillimit.

3.2 Rolet, funksionet bashkërenduese dhe Plani Kombëtar

Themeli i bashkërendimit është krijimi i raporteve të ndërsjella dhe shkëmbimi i hapur dhe i vazhdueshëm i informacionit ndërmjet institucioneve dhe strukturave të emergjencës.

Për shkak të kërkesave që vijnë si rezultat i situatës së emergjencës civile dhe përfshirjes së menjëhershme të tyre në shkëmbimin e informacionit, këto institucione dhe struktura duhet të hyjnë sa më shpejt në rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Si rezultat i bashkërendimit duhet të evidentohen dhe të trajtohen problemet më me përparësi, por njëkohësisht të mos neglizhohen edhe problemet dytësore, në mënyrë që rezultati të jetë sa më i plotë. Në këtë mënyrë, interesi i institucioneve për rivendosjen e shërbimeve ose të kushteve për të cilat ata kanë përgjegjësi funksionale, paraqitet në një tablo më të gjerë nëpërmjet vendosjes së radhës së përparësive dhe përdorimit të drejtë dhe efektiv të burimeve.

Në situatat e emergjencës civile, autoriteti i ngarkuar me rol bashkërendues ka autoritetin për të kërkuar bashkërendimin e përpjekjeve dhe të kapaciteteve të institucioneve të tjera. Ekzistojnë lidhje të fuqishme dhe të ndërsjella të bashkëpunimit, të cilat bazohen në raportet e punës midis institucioneve/strukturave dhe shkëmbimit të informacionit midis tyre. Institucionet apo individët përkatës ndërmjet njëri-tjetrit, duhet të shikojnë vlerat shtesë që sjell pjesëmarrja në procesin e bashkërendimit.

Bashkërendimi kërkon impenjim nga ana e të gjithë protagonistëve. Kjo bëhet më e vështirë sidomos në rastet kur ka strese të mëdha në një institucion apo individ.

Bashkërendimi kërkon kohë, energji dhe përpjekje të përbashkëta. Duke u impenjuar në takimet bashkërenduese, mund të zbulohen aspekte të rëndësishme të situatës së përgjithshme të emergjencës, të cilat menjëherë mund të ndryshojnë përparësitë e njërit apo tjetrit institucion, duke zvogëluar shpërdorimin e përpjekjeve të tyre dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Për sigurimin e efektivitetit të bashkërendimit, funksionet bashkërenduese duhet të ndërmerren brenda një strukture të pranuar paraprakisht dhe të mbështetur nga të gjithë protagonistët e menaxhimit të situatës së emergjencës civile. Për këtë arsye, PKEC-ja i Republikës së Shqipërisë është ndër të tjera mjet bashkërendimi, i hartuar përmes konsultimeve të vazhdueshme dhe informacioneve të dhëna nga institucionet dhe strukturat pjesëmarrëse. PKEC-ja ka si qëllim mbledhjen së bashku të protagonistëve gjatë gjithë fazave të ciklit të emergjencave. Ai inkurajon bashkëpunimin nëpërmjet transparencës dhe përmban detaje të konsiderueshme në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë protagonistëve të nevojshëm, duke vendosur në listë të gjitha institucionet dhe strukturat. Për fazën e përgjigjes (seksioni 6), rolet dhe përgjegjësitë janë vendosur në listë në bazë të detyrave që ato kanë në sistemin kombëtar të shërbimit të emergjencave civile (SKSHEC).

3.3 Përgjegjësitë për bashkërendimin e emergjencave civile

Përgjegjësia për bashkërendimin në përgjithësi nuk bazohet në përgjegjësitë hierarkike. Përgjegjësia për bashkërendim u jepet institucioneve të cilat janë në gjendje dhe pozitë të mbledhin së bashku informacionet dhe vendimmarrësit, të cilët bëjnë kërkesa të pranuar dhe të miratuara për të gjithë protagonistët që përfshihen në operacionet e përgjigjes së emergjencave civile.

Ligji nr. 8756, dt. 26.III. 200 , “Për emergjencat civile”, nënvizon se përgjegjësia për bashkërendim është e vendosur në disa nivele në varësi të situatës. Në rastet e emergjencave të shkallës së lartë është përcaktuar niveli hierarkik politik për marrjen e vendimeve dhe ai teknik për drejtimin e operacioneve. Në ligj është përcaktuar funksioni bashkërendues i strukturave shtetërore që marrin pjesë në përballimin e emergjencave civile, edhe pse nuk është vendosur ende në mënyrë të saktë funksioni i tyre (PKEC ndihmon në këtë drejtim), është dhënë në mënyrë të tillë që të jetë reciprokisht mbështetës, duke filluar nga niveli bashki dhe komunë e deri lart tek DQO-ja dhe KNEC-ja.

Funksioni bashkërendues paraqet nevojat dhe kapacitetet e disponuara për përballimin e emergjencës, duke filluar nga komuniteti, deri lart në nivelin e institucioneve dhe të strukturave qendrore. Funksioni bashkërendues, në të vërtetë, është baza informative në të cilën, nëse është e nevojshme, do të zhvillohen bisedimet dhe do të ndërmerren procedura në mënyrë koherente edhe për ndihmën ndërkombëtare.

Në nivele të ndryshme, funksioni bashkërendues reflekton përgjegjësinë e menaxhimit të emergjencave civile, ku strukturat, nëpërmjet mekanizmave bashkërendues, duhet të informojnë, të mbështetin dhe të sigurojnë bazën e procesit të vendimmarrjes.

Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave ka përgjegjësinë e përgjithshme për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave civile në Shqipëri. Nëpërmjet strukturave të përhershme dhe të përkohshme që krijohen në raste të emergjencave civile, Këshilli i Ministrave bashkërendon të gjithë punën për përballimin e situatave emergjente, duke qenë aktiv në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave.

Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile (KNEC)

KNEC-ja krijohet me shpalljen e gjendjes së emergjencave civile në një pjesë të territorit ose në të gjithë territorin dhe qëndron i mbledhur për sa kohë zgjat kjo gjendje.

Disa nga detyrat e KNEC-së për bashkërendim janë:

- Bashkërendimi i veprimeve të forcave reaguese gjatë situatës së emergjencës civile.
- Bashkërendimi në menaxhimin e ndihmave humanitare si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të tyre.

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (MPVD)

Disa nga detyrat e MPVD-së për bashkërendim janë:

- Bashkërendon veprimet e të gjitha strukturave qendrore me organet e qeverisjes vendore në përgjigje të emergjencës.
- Bashkërendon organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në emergjencat civile.
- Bashkërendon punën për vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave.

Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile (DPPEC)

Ndër detyrat e DPPEC-së për bashkërendim janë:

- Harton dhe bashkërendon planet e emergjencave me institucione dhe struktura të ndryshme. Siguron vënien e tyre në zbatim dhe ndihmon drejtpërdrejt MPVD-në në ushtrimin e funksioneve të saja bashkërenduese dhe përmbushjen e përgjegjësisë në lidhje me situatat e emergjencave në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe komune.
- Bashkërendon strukturat në nivel kombëtar gjatë 24 orëve nëpërmjet QKOEK-së, e cila ka lidhje dhe kontakte të drejtpërdrejta me SEC-në.
- Krijon raporte ndërinstucionale, të mirëkuptimit të përbashkët dhe raporte bashkërenduese në lidhje me çështjet e emergjencave civile nëpërmjet KTKSEC-së.

Ministritë e linjës

Ministritë kanë përgjegjësi për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile brenda fushës së veprimit dhe kompetencave të tyre duke bashkërenduar për:

- hartimin dhe bashkërendimin e planeve dhe të gjitha aktivitetëve për emergjencat civile me MPVD-në si dhe
- ofrimin e kapaciteteve dhe të strukturave që disponojnë në përgjigje të emergjencave civile.

Prefektët e Qarqeve.

Prefekti është përgjegjës për bashkërendimin e të gjitha aktivitetëve për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e qarkut.

Detyrat e prefektit për bashkërendim përfshijnë:

- Bashkërendimin e planeve të emergjencave në qark.
- Bashkërendimin e të gjitha aktivitetëve të strukturave shtetërore dhe joshtetërore në qark për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile nëpërmjet KPPECQ-së.

Bashkia dhe Komuna

Kryetarët e bashkisë dhe të komunës janë përgjegjës për bashkërendimin e të gjitha aktivitetëve për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile brenda territorit të tyre përkatës.

Detyrat për bashkërendim në nivelin bashki /komunë përfshijnë:

- Bashkërendimin e planeve të emergjencave me ato të qarkut dhe të komunave e të bashkive fqinje.
- Organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale.
- Nëpërmjet KVEC-së bashkërendimin e të gjitha aktivitetëve të strukturave shtetërore dhe joshtetërore në bashki/komunë për planifikimin dhe përballimin e situatave emergjente.

4. PARANDALIMI DHE LEHTËSIMI

4.1 Hyrje dhe përkufizimi

Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i Republikës së Shqipërisë merr në analizë çështje të emergjencave civile nëpërmjet katër fazave të ciklit të emergjencave civile. Faza e parë e këtij cikli është ajo e parandalimit dhe e lehtësimit.

Për qëllimin e PKEC-së:

Parandalimi përkufizohet, si: Tërësia e masave për shmangien e situatave të emergjencave civile që mund të prekin jetën, pasurinë dhe trashëgiminë kulturore.

Lehtësimi përkufizohet, si: Tërësia e masave për zvogëlimin e preksshmërive sociale, ekonomike dhe mjedisore ndaj dukurive të mundshme të rrezikut, që mund të vijnë nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të aktivitetit njerëzor.

Për menaxhimin me sukses të emergjencave civile është mjaft i rëndësishëm krijimi i shumë lidhjeve të drejtpërdrejta midis aktiviteteve të strukturave dhe institucioneve pjesëmarrëse, si në etapat e një faze, ashtu dhe gjatë katër fazave të ciklit të emergjencave.

Për arritjen e këtij qëllimi, çështjet e parandalimit dhe të lehtësimit nuk janë të lidhura vetëm me përgatitjen dhe mbrojtjen, përgjigjen e menjëhershme ndaj situatave të emergjencave civile, por edhe me çështjet kyç të fazës së rikthimit në gjendjen normale. Faza e rikthimit në gjendjen normale është një mundësi për të riparë dhe për të vlerësuar shkaqet dhe mënyrat e reagimit ndaj një situatë emergjence. Kjo është periudha më e mirë për të ndërmarrë aktivitete lehtësimiti, paralelisht me aktivitetet e rehabilitimit dhe të rindërtimit dhe shpesh është koha kur disponohen burimet e nevojshme për të investuar në masat parandaluese dhe lehtësuese, gjë e cila nuk do të mund të bëhej gjatë kohës së emergjencës.

Në këtë seksion përmblihen faktorët e përgjithshëm që duhen marrë në konsideratë në parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera dhe për lehtësimin e pasojave të tyre. Ka, gjithashtu, edhe elemente të veçanta në lidhje me dukuritë e mundshme të rrezikut me të cilat Shqipëria përballë, të cilat janë analizuar në bazë të metodave shkencore në studimin “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”.

Nga analiza e përgjithshme del qartë se në Shqipëri ekzistojnë burime dhe kapacitete të cilat mund të zvogëlojnë dukshëm rreziqet me pasoja tek njerëzit, pasuria dhe mjedisi. Gjithashtu, këto kapacitete, në mënyrë të konsiderueshme dhe/ose të dukshme, mund të lehtësojnë efektet e pashmangshme të situatave të emergjencave civile, tek njerëzit dhe pasuria e tyre.

4.2 Prioritetet për Parandalimin dhe Lehtësimin

Për të bërë të mundur përfshirjen e institucioneve dhe të strukturave përgjegjëse në procesin e parandalimit dhe të lehtësimit një sërë masash janë identifikuar si përparësi kombëtare.

Këto masa parësore janë përshkruar në seksionin 10 me titull “Hapat për zbatimin e PKEC-së”, por në mënyrë të përmbledhur janë:

- Masat për parandalimin dhe lehtësimin
- Masat për forcimin e SSHKEC-së.
- Masat për zbatimin e PKEC-së.

4.3 Masat e përgjithshme për Parandalimin dhe Lehtësimin

4.3.1 Strukturat ndërtimore ekzistuese, elementët infrastrukturorë dhe zonat mjedisore

Strukturat ekzistuese (objekte banimi, objekte shërbimi dhe publike), elementet infrastrukturore (rrugët, stacionet elektrike ose pompimi etj.) dhe zonat mjedisore (si liqenet, pyjet) mund të jenë të prekshme nga rreziqe të veçanta. Në Shqipëri rreziqet më të mundshme vijnë nga: aktivitetet sizmike, përmblytjet, rrëshqitjet, bllokimi nga dëbora, temperaturat ekstreme të ajrit, zjarret masive, aksidentet etj.

Strukturat me përparësi dhe elementet infrastrukturore duhet të jenë plotësisht funksionale në të gjitha situatat. Disa nga këto objekte, sidomos objektet e shërbimeve shëndetësore janë shumë të rëndësishme, veçanërisht në një situatë emergjente.

Të tjera struktura, si: digat, pritat e lumenjve, paraqesin rrezik në vetvete, nëse janë të dëmtuara. Për këtë arsye, këto kërkojnë investime më të mëdha nëpërmjet aktiviteteve parandaluese dhe lehtësuese. Parandalimi dhe lehtësimi, si masa që janë të lidhura ngushtë me strukturat ekzistuese, elementet infrastrukturore dhe zonat mjedisore në Shqipëri, janë përgjegjësi të përbashkëta të disa institucioneve, që kërkojnë:

a) Informacion të ndërsjellë të strukturave qendrore dhe lokale të planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit dhe të strukturave operacionale dhe mbështetëse të emergjencve civile. Informacioni është i domosdoshëm për njoftimin e hershëm, për informimin dhe këshillimin e publikut, planifikimin e masave parandaluese dhe lehtësuese në nivel kombëtar dhe lokal.

Informacioni duhet të përfshijë:

- Të dhënat rreth aktivitetit sizmik, hidrologjik, meteorologjik dhe gjeologjik.
- Gjendjen aktuale dhe kushtet teknike, nivelin e mirëmbajtjes, nevojat për riparimin dhe për rritjen e sigurisë në infrastrukturën e transportit, në infrastrukturën e furnizimit me ujë, në strukturat e prodhimit dhe të shpërndarjes me energji elektrike, gjendjen e digave, të objekteve industriale, minierave, objekteve të banimit etj.
- Gjendjen e baseneve ujëmbledhëse, pyjeve, lumenjve, kanaleve parësore, dytësore dhe tretësore, shpateve të paqëndrueshme, pritave malore, luginave dhe zonave të tjera që paraqesin rreziqe.
- Nivelin e ndotjes, higjienës dhe epidemiologjisë dhe nivelin e kriminalitetit.

Strukturat dhe mënyra e grumbullimit të informacionit paraqiten në skemën e mëposhtme:


b) *Ndjekje dhe realizim të standarteve.*

Zbatimi i programeve dhe i standardeve të zhvillimit kërkon mobilizimin dhe gjetjen e burimeve të reja duke përfshirë:

- Programe mirëmbajtjeje dhe remonti të rregullta periodike.
- Programe të parashikuara riparimi, të miratuara nga të gjitha institucionet dhe strukturat.
- Arritjen dhe zbatimin e standardeve kombëtare të miratuara, për rritjen e sigurisë dhe për zbatimin e procedurave të inspektimit.

c) *Përmirësime.*

Planifikimi dhe mobilizimi/gjetja e burimeve duke përfshirë:



- Rikonstruksione, përforcime, për ngritjen në një shkallë më të lartë dhe për përshtatjen me standardet e miratuara.
- Marrjen parasysh të dukurive të mundshme të rrezikut apo të rreziqeve, që mund të shfaqen rishtas ndaj objekteve apo elementeve infrastrukturore të ndryshme, përcaktimin e qartë të zonave me rrezik etj.
- Përafrimin me standardet e Komunitetit Europian, të cilat përbëjnë një objektiv për t'u arritur.

d) *Plane per parandalimin e emergjencave.*

Hartimi i planeve specifike për parandalimin e emergjencave nga sektorët dhe strukturat përkatëse për objekte, elemente infrastrukturore dhe zona mjedisore ekzistuese duhet të përfshijë:

- Role dhe përgjegjësi të qarta për strukturat përkatëse.
- Vendosjen dhe funksionimin e sistemit të monitorimit dhe të informimit.
- Vendosjen e rregullave të qarta për procedurat dhe hapat për zbatimin e njoftimit të parë.
- Miratimin dhe zbatimin e procedurave të qarta të informimit publik.
- Testimin e sistemit të gatishmërisë për emergjencat dhe organizimin e stërvitjeve simuluese.

e) *Trainime*

Identifikimi i nevojave dhe i grupeve të personelit që kanë nevojë për trajnime. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me partnerët përkatës, në lidhje me çështjet e parandalimit dhe të lehtësimit të emergjencave civile.

f) *Investime*

Planifikimi dhe kërkimi në mënyrë aktive i investimeve në parandalim dhe lehtësim nëpërmjet projekteve ekzistuese dhe të reja, planifikimit bashkëkohor dhe arritja e normave dhe e standardeve të BE-së.

4.3.2 Strukturat ndërtimore të reja, elementët infrastrukturore dhe zonat mjedisore në zhvillim

Strukturat dhe elementet infrastrukturore të reja, apo zonat mjedisore në ndryshim mund të jenë të prekshme nga rreziqe të veçanta ose përbëjnë në vetvete rrezik për elementet e tjera. Strukturat me përparësi dhe elementet infrastrukturore duhet të qëndrojnë plotësisht funksionale në të gjitha situatat, të jenë të projektuara në përputhje me standardet specifike për këto lloje objektesh. Përveç kodeve të ndërtimit, duhen marrë në konsideratë përfundimet e "Vlerësimit të rreziqeve në Shqipëri" për të parandaluar në maksimum dëmet që mund të shkaktohen nga fatkeqësitë e ndryshme.

Parandalimi dhe lehtësimi, si masa që janë të lidhura ngushtë me strukturat, objektet e reja, elementet infrastrukturore dhe zhvillimin e tyre, janë përgjegjësi e disa institucioneve, të cilat përfshijnë:

- *Informimin.*
Dhënia e informacionit për vendimmarrësit e ngarkuar me planifikimin, miratimin dhe ndërtimin e strukturave të reja, hartimin e projekteve zhvillimore të elementeve infrastrukturore.

Informacioni, ndër të tjera, përfshin:

- o Të dhënat për aktivitetet sizmike, hidrologjike, meteorologjike, gjeologjike të zonës që konsiderohet në zhvillim.
- o Informacionin teknik për faktorët e dukurive të mundshme të rrezikut, të përfshira në të gjitha proceset e reja të zhvillimit.
- o Tipat dhe ciklet e programeve të mirëmbajtjes, të riparimit dhe të kontrollit të kushteve të sigurisë në të gjitha projektet e reja të zhvillimit.
- o Informacionin teknik për ndikimet e zhvillimeve të reja të zonave mjedisore, si: baseneve dhe ujëmbledhësve, lumenjve, kanaleve parësore, dytësore dhe tretësore, masiveve pyjore, shpateve të paqëndrueshme, pritave malore, luginave, zonave të bonifikuara etj.

- *Standardet dhe normat.*
 Është i nevojshëm sigurimi i zbatimit të standardeve kombëtare, përafrimi dhe arritja e standardeve të BE-së, duke përfshirë:
 - o Rregullat e përdorimit të tokës.
 - o Rregullat e planifikimit dhe të ndërtimit të objekteve dhe të elementeve infrastrukturore të reja.
 - o Vlerësimin e plotë të mjedisit për rreziqet ekzistuese dhe ato që mund të ndodhin, të shkaktuara nga ndryshimet në mjedis.
- *Ruajtjen dhe zbatimin e standardeve.*
 Duke filluar nga faza e hartimit dhe e përgatitjes së buxhetit për planifikimin, miratimin dhe ndërtimin e strukturave të reja, elementeve infrastrukturore dhe të zhvillimit, duhet të parashikohen:
 - o Programet e mirëmbajtjes.
 - o Projektet e riparimit.
 - o Mbrojtja ndaj dukurive të mundshme të rrezikut që mund të shfaqen rishtas dhe rreziqet që mund të vijnë nga zhvillimi.

4.3.3 Rishikimi dhe zbatimi i legjislacionit

Legjislacioni ekzistues siguron dispozita ligjore për kufizimet në përdorimin e tokës, standardet e ndërtimit dhe bazën ligjore të veçantë për elemente infrastrukturore specifike, si: komplekset industriale, enët nën presion dhe materialet e rrezikshme. Legjislacioni shqiptar përmban, gjithashtu, standarde për sigurinë në objekte të veçanta, si: porte dhe aeroporte, të cilat, gjithashtu, duhet të përputhen me standardet e pranuar ndërkombëtare të sigurisë. Kodet e ndërtimit dhe ligjet për përdorimin e tokës janë të detyrueshme për nivelin qendror dhe lokal dhe, në disa fusha, janë në proces hartimi apo rishikimi për përafrimin me standardet e BE-së.

Në të gjitha vendet e sidomos në ato të cilat përballen me hapa shumë të shpejtë të procesit të zhvillimit, hartimi dhe zbatimi i ligjit përbën një sfidë shumë të madhe. Institucionet dhe strukturat që duhet të përballen me një sfidë të tillë janë:

KRRR-të në bashki, komunë dhe këshillat e qarqeve dhe KRRTRSH nëpërmjet ligjit të urbanistikës, Instituti i Studimeve të Urbanistikës (ISU), zyrat e urbanistikës pranë këshillave të qarqeve dhe të bashkive dhe zyrat e shërbimeve pranë komunave. Zyrat e kadastrave urbane pranë këshillave të qarqeve, të rretheve dhe të bashkive, Drejtoria e Tokave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Ndërtimore, Drejtoria e Kontrollit të Rrregullave Teknike, Drejtoria e Promocionit të Standardeve Turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Drejtoria e Ruajtjes së Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit etj.

Dy aspektet më kryesore në rishikimin dhe zbatimin e legjislacionit janë:

a) Planifikimi dhe përdorimi i tokës:

“Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri” u ndërmor me objektivin për evidentimin e rreziqeve kryesore dhe që të shërbejë si bazë informative për strukturat, të cilat kanë për detyrë planifikimin dhe përdorimin e tokës në nivel qendror dhe lokal, dhe synon të mbështetë këto struktura gjatë vlerësimeve të kualifikuara, për pasojat e mundshme të rreziqeve.

Administrimi i drejtë i tokës bëhet duke u mbështetur në ligje dhe akte nënligjore të miratuara nga organet legjislative dhe ekzekutive në vendin tonë, duke mbajtur parasysh zhvillimin ekonomik dhe social aktual dhe perspektiv të vendit, parandalimin e rreziqeve të mundshme, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe vënien në dukje të vlerave urbanistike, arkitekturore, arkeologjike etj.

Organet e pushtetit vendor janë administruese të territorit që ndodhet nën juridiksionin e tyre, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj.

Me qëllim që të përmirësohen kushtet e jetesës, të administrohet territori mbi bazë ligjore, të

sigurohet mbrojtja e mjedisit, të ruhet ekuilibri në zhvillimin e zonave urbane e rurale dhe të përmirësohen kushtet ekzistuese, organet e pushtetit vendor harmonizojnë vendimet e tyre duke respektuar në mënyrë të ndërsjellë autonominë lokale.

Mënyra e administrimit të tokës për ndërtime është e përcaktuar në ligjin “Për urbanistikën”; bëhet nëpërmjet planeve rajonale, masterplaneve, planeve rregulluese të përgjithshme dhe studimeve urbanistike pjesore. Përmbajtja e tyre përcaktohet në rregulloren e urbanistikës.

Në kuptimin e ligjit “Për urbanistikën”, si toka pronë private, ashtu edhe toka pronë publike kanë të njëjtën vlerë për urbanizim.

b) *Standartet dhe kodet:*

Inkurajimi i zbatimit të standardeve dhe kodeve duhet të bëhet nëpërmjet metodave të kombinuara, të cilat përfshijnë:

- Inkurajimin e një strukture të pavarur me specialistë, për rishikimin dhe supervizimin e standardeve në industrinë e ndërtimit, për sigurimin e zbatimit të këtyre standardeve, sidomos të atyre që kanë lidhje me godinat për përdorim publik dhe me një përqendrim të madh njerëzish, të tilla, si: stadiumet, shkollat, spitalet, teatrot, kinematë, diskot etj.
- Nxitjen e partneritetit ndërmjet pronarëve dhe sipërmarrësve të ndërtimit urban, me institutet, kompanitë e sigurimeve, i cili do të sjellë si rezultat nxitjen dhe përfshirjen në mënyrë të vullnetshme në legjislacionin dhe kodet e miratuara nga BE-ja.
- Zbatimin e normave, rregullave dhe kushteve të urbanistikës. Institutet projektuese në fushën e projekteve urbanistike, qofshin këto shtetërore apo private, vendëse apo të huaja dhe organet përkatëse që vlerësojnë dhe miratojnë projektet urbanistike mbi bazën e ligjit “Për urbanistikën” detyrohen të zbatojnë “Rregulloren e urbanistikës”.
- Gjetjen e burimeve dhe trajnimin e inspektorateve dhe të strukturave, të cilat mbulojnë fusha të tilla, si: ndërtimin, elementet infrastrukturore dhe ato të mjedisit (si pyjet dhe ujëmbledhësit).
- Respektimin e normave dhe të standardeve që kanë të bëjnë me zonat industriale, sidomos zonat mbrojtëse sanitare dhe masat parandaluese, masat mbrojtëse për ndotje mjedisi, largësia nga qendrat e banuara dhe specifikime të tjera sipas veçorive.
- Respektimin e kushteve teknike për ekzistencën e rrugëve me gjerësi të mjaftueshme kalimi për shërbimet e emergjencës.
- Nxitjen e zhvillimit nëpërmjet stimujve dhe vlerësimeve për përmirësimin dhe përshtatjen me standartet e duhura, si dhe krijimin e partneriteteve të reja, standardeve dhe skemave për zhvillimin e masave për parandalim dhe lehtësim.

4.3.4 Inspektoriatet, Sekretariatet dhe Policët

Pjesë e rëndësishme e fazës së parandalimit dhe lehtësimit është edhe kontrolli i realizimit të tërësisë së masave parandaluese për emergjencat civile.

Në SSHKEC, strukturat që i shërbejnë fazës së parandalimit dhe lehtësimit janë inspektoratet e kontrollit dhe policitë e ndryshme, të cilat janë të përfshira në strukturat përkatëse të ministrive të linjës dhe njësitë e pushtetit vendor.

Detyrë kryesore e këtyre strukturave është kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë, të rregullave dhe të standardeve për fusha të caktuara, në fazat e ndërtimit, prodhimit, magazinimit dhe shpërndarjes së produkteve deri tek konsumatori ose përdoruesi.

Fusha e veprimtarisë së kontrollit të këtyre inspektorateve shtrihet në subjektet shtetërore dhe ato private.

Në vendin tonë ushtrojnë funksionet e tyre strukturat si më poshtë:

a) *Inspektoratet:* higjiëno-sanitar shëndetësor; zooveterinar; i bimëve dhe i farave; ushqimor; i peshëmatjeve; i enëve nën presion; i minierave; i mjedisit; i punës; i standardeve turistike; i standardeve për hidrokarburet.

b) *Sekretariatet:* i Këshillit Kombëtar të Ujërave; ai teknik i digave të larta; i monitorimit të baseneve

ujore.

c) *Policitë*: Policia e Shtetit; PMNZSH-ja; ndërtime; elektrike; tatimore; pyjore; doganore; bashkiake dhe komunare.

Inspektoratet, sekretariatet dhe policitë që janë paraqitur më sipër, ushtrojnë aktivitetin e tyre në fusha të caktuara, por duket qartë se në fushën e emergjencave civile është e domosdoshme ngritja dhe funksionimi i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes Civile.

Detyrat dhe fusha e veprimit të tij përshkruhet në seksionin 4.5.

Raportet dhe informacionet

Inspektoratet, sekretariatet dhe policitë e ndryshme dhe të gjitha strukturat e tjera që merren me kontrollin e cilësisë, të standardeve dhe në tërësi me kontrollin e masave parandaluese, dërgojnë pranë institucioneve drejtuese programet e kontrolleve, raporte të veçanta dhe periodike, si dhe raporte për gjendjen reale dhe veprimtarinë e fushës që mbulojnë.

- Raportet periodike duhet të përmbajnë gjithë informacionin e nevojshëm të kontrolleve të ushtruara, të masave të marra, detyrimet nëpërmjet sanksioneve mbi subjektet shtetërore ose private.
- Raporte të veçanta për një situatë me precedent të lindjes së emergjencës duhet të përmbajnë: një përshkrim të shkurtër të situatës konkrete, rrezikun që paraqet, mundësinë ose jo të përballimit nga vetë struktura përgjegjëse dhe masat që rekomandohen.

Institucionet qendrore duhet të dërgojnë pranë DPPEC-së përmbledhje raportesh periodike dhe të veçanta për gjendjen e masave parandaluese sipas fushës specifike të emergjencave civile që mbulojnë dhe realizimin e këtyre masave.

4.3.5 Përgjegjësitë dhe planifikimi në nivele të ndryshme

Përgjegjësite për parandalimin dhe lehtësimin fillojnë nga strukturat qendrore, lokale, deri poshtë tek publiku i gjerë në të gjithë vendin. Përgjegjësitë përfshijnë të gjitha strukturat që kanë detyra funksionale për elementet infrastrukturore kryesore, objektet industriale, sektorët e transportit, të telekomunikacionit dhe të informimit publik, si dhe ato të përfshira në forcat operacionale, administratën në të gjitha nivelet dhe ata të cilët punojnë me njerëzit, institutet dhe kompanitë të cilat kanë njohuri, burime dhe përvoja të veçanta, që mund të përfshihen dhe të japin ndihmesën e tyre të specializuar për çështje që lidhen me parandalimin dhe lehtësimin e emergjencave civile.

Pothuajse të gjitha institucionet dhe strukturat që kanë disa përgjegjësi në fazat e gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj situatave të emergjencave civile, kanë edhe role korresponduese në fazën e parandalimit dhe të lehtësimit. Sidoqoftë, në fazën e lehtësimit vihet re qartë numri më i madh i institucioneve dhe i strukturave, të cilat, nëpërmjet bashkërendimit të aktiviteteve të tyre, vlerësojnë më mirë në bazë të rezultateve faktin se parandalimi dhe lehtësimi është mjaft i rëndësishëm. Institucionet qendrore dhe strukturat përkatëse janë ato që bëjnë politika dhe ndjekin procesin e marrjes së masave për parandalimin dhe lehtësimin e emergjencave civile.

Faktorë të rëndësishëm në nxitjen dhe marrjen e përgjegjësisë në parandalim dhe lehtësim përfshijnë çështje, si:

- *Ngritja e strukturave të përkohshme për vlerësimin e gjendjes.*
Për të vlerësuar gjendjen dhe për të dhënë rekomandimet për zgjidhjet e mundshme, në shumë raste lind nevoja e krijimit të grupeve të punës ose komisioneve të vlerësimit në nivel qendror, qarku, komune dhe bashkie për:
 - o Vlerësimin në detaje të masave për parandalim dhe lehtësim.
 - o Informimin e vendimmarrësve për gjendjen.
 - o Propozimin e zgjidhjeve praktike, nismave ligjore si dhe mënyrat e zgjidhjes së problemeve.
 - o Kontrollin në mënyrë të vazhdueshme të veprimeve/aktiviteteve të ndërmarra nga vendimmarrësit.

- *Zgjidhjet Praktike.*
Përgatitja dhe prezantimi i zgjidhjeve praktike për të reduktuar në mënyrë sa më të shpejtë ndikimet që mund të vijnë nga dukuri të mundshme rreziku për njerëzit dhe për pasurinë, si dhe puna për rikthimin në nivelin e duhur të kushteve të mjedisit është mjaft e rëndësishme. Kjo mund të bëhet nëpërmjet nxitjes dhe promovimit të projekteve të veçanta në nivel kombëtar dhe vendor:
 - o Nxitja e aktiviteteve të bashkërenduara për informimin publik, shpërndarjen e informacionit dhe forcimin e sistemit të lajmërimit dhe të njoftimit të hershëm.
 - o Përfshirja e komunitetit në programet e rehabilitimit, të zhvillimit dhe të rritjes së kushteve të sigurisë për mjedisin.
 - o Mbrojtja dhe nxitja e punëve publike dhe private në skema të tilla të cilat përfshijnë:
 - Pyllëzimin dhe mbrojtjen e pyjeve.
 - Rikthimin në normalitet dhe mirëmbajtjen e kanaleve dhe të ujëmbledhësve.
 - Zbatimin e masave mbrojtëse për zonat më në rrezik, si për shembull vendosjen e linjave shtesë/dytësore për furnizimin me energji dhe të stacioneve të pompave të ujit.
 - Organizimin dhe funksionimin e sistemit për njoftimin e parë, duke filluar që nga niveli lokal, për nivelet kritike, tejkalimi i të cilave mund të shkaktojë emergjencë civile.
- *Krijimi i partneriteteve për Fazën e Lehtësimit.*
Në disa raste kërkohet koordinimi i hapave dhe i nismave të veçanta në parandalim dhe lehtësim, duke krijuar partneritete të qëndrueshme me institucionet dhe strukturat përkatëse për:
 - o Marrjen e masave të duhura në bazë të çështjeve parësore.
 - o Kërkimin e burimeve shtesë për çdo hap që do të ndërmerret, nëse është e nevojshme.
 - o Nxitjen e bashkërendimit në nivel lokal dhe shkëmbimin e lirë të informacionit për të ushqyer strukturat e emergjencave civile në nivel qarku dhe atë qendror, me qëllim mbështetjen e masave për fazën e lehtësimit dhe informimin rreth masave parandaluese.
 - o Përgatitjen, informimin e publikut dhe të strukturave nëpërmjet aktiviteteve të edukimit publik për problemet e parandalimit dhe të lehtësimit.
 - o Sensibilizimin e publikut nëpërmjet aktiviteteve me vullnetarët e KKSH-së, OJF-ve për rreziqet e mundshme dhe masat që duhen marrë për parandalimin e emergjencave civile.
 - o Hartimin e planeve dhe të projekteve specifike për parandalimin e emergjencave ku degët e KKSH-së asistojnë në nivel vendor drejtuesit e njëjësive të qeverisjes vendore dhe komunitetin dhe, në nivel qendror, KKSH-në, MPVD-në.
- *Stërvitjet Simuluese.*
Nëpërmjet stërvitjeve simuluese, rishikimit dhe zhvillimit të metodave të përmirësuara të punës, duhet të punohet vazhdimisht për ndërgjegjësimin dhe pranimin e përgjegjësive për gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave në nivel lokal, qarku dhe qendror.
- *Planet e Emergjencave.*
Nxitja e hartimit dhe e rishikimit të vazhdueshëm të planeve të emergjencave nga të gjitha strukturat, veçanërisht ato të cilat punojnë pranë komunitetit dhe publikut të gjerë.
- *Planifikimi Plotësues.*
Sigurimi dhe përfshirja e planeve sektoriale të emergjencave civile, të cilat duhet të plotësojnë dhe të forcojnë mekanizmat e bashkërendimit dhe përgjegjësitë që jepen në PKEC.
- *Bashkërendimi dhe Planifikimi.*
Nxitja e bashkërendimit dhe e planifikimit nëpërmjet rishikimit të vazhdueshëm dhe të programuar të:
 - o Roleve dhe të përgjegjësive.
 - o Listave me pikat e kontaktit.
 - o Burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të institucioneve dhe të strukturave.
 - o Inventarëve të mjeteve të transportit dhe të pajisjeve të veçanta.
 - o Planeve të emergjencave civile të strukturave dhe prezantimit të saktë në skemat e institucioneve të përgjegjësive të tyre për emergjencat civile.
 - o Sistemeve dhe skemave të njoftimit, të alarmit dhe të evakuimit duke filluar nga niveli lokal

deri në nivel kombëtar.

- o Sigurimit në mënyrë të vazhdueshme të furnizimit me materiale, artikuj jetësorë dhe burime njerëzore pranë zonave më në rrezik.
- *Krijimi i Raporteve të Punës.*
Sistemi i integruar i strukturave të SHEC-së krijohet mbi bazën e raporteve të bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë të tyre në nivel lokal dhe atë qendror. Efektiviteti i këtij raporti të ndërsjellë arrihet nëpërmjet zbatimit të përgjegjësive të ngarkuara me akte ligjore dhe nënligjore, këshillimit, përfaqësimit, prezantimit dhe ekspertizës së njëra-tjetrës, duke përfshirë planet dhe burimet e veçanta plotësuese të çdo strukture apo institucioni.
- *Metoda Kombëtare e Punës për lehtësimin e Mbështetjes Ndërkombëtare.*
Një sistem i integruar kombëtar i menaxhimit të emergjencave në Shqipëri sjell përmirësimin e procedurave në nxitjen dhe negocimin e ndihmës ndërkombëtare për fazat e parandalimit dhe të lehtësimit. Në këtë mënyrë, shmangen dublimet dhe shpërdorimet, shtrohen të parat për zgjidhje përparësitë dhe plotësohen mangësitë gjatë fazës së parandalimit dhe lehtësimit.

4.4 Masa Shtesë për Parandalimin dhe Lehtësimin

Përveç masave të përgjithshme të përshkruara më sipër, një numër dukurish të mundshme rreziku dhe skenarësh të cilët mund të krijohen, kërkojnë masa specifike shtesë për fazën e parandalimit dhe të lehtësimit. Këto janë paraqitur në shtojcën “A”, duke paraqitur tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet, bllokimin nga bora, zjarret, emergjencat industriale dhe ato që mund të vijnë nga aktet terroriste.

4.5 Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes Civile (IKMC)

Bazuar në përvojën e deritanishme, si dhe në nevojën për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të emergjencave civile, duke i kushtuar më shumë vëmendje parandalimit dhe përgatitjes së strukturave të emergjencave civile, shihet e domosdoshme ngritja e një strukture e cila do të ketë ndikime në parandalimin e situatave emergjente.

IKMC-ja është një strukturë që funksionon nga qendra dhe deri në nivel qarku. Nëpërmjet tij, mbahet nën kontroll i gjithë territori i vendit. Për sa i përket mbrojtjes civile dhe IKMC-ja kryen këto detyra:

- Është i pranishëm në planifikimin, zbatimin dhe marrjen në dorëzim të objekteve.
- Monitoron, kontrollon dhe raporton duke ndjekur në proces punën e strukturave të ndryshme në lidhje me emergjencat civile.
- Kontrollon subjektet shtetërore dhe joshtetërore për planifikimin dhe marrjen e masave parandaluese për emergjencat civile.
- Kontrollon shkallën e përmbytjes, pajisjes dhe nivelin e përgatitjes së forcave operacionale dhe mënyrën e përgjigjes për përballimin e emergjencave civile
- Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të cilat përcaktohen me akte ligjore dhe nënligjore për marrjen e masave ndaj institucioneve, strukturave dhe subjekteve që nuk zbatojnë rregullat, standardet dhe bazën ligjore për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin, rikthimin e gjendjes normale dhe zhvillimin e zonës së dëmtuar nga emergjencat civile.

5. PËRGATITJA DHE MBROJTJA

5.1 Hyrje dhe përkufizimi

Faza e dytë e ciklit të emergjencave e trajtuar në PKEC është faza e përgatitjes dhe e mbrojtjes. Për qëllimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile:

Përgatitja përkufizohet, si: Tërësia e masave për të përgatitur njerëzit dhe mjedisin që të përballojnë në mënyrë sa më efektive të mundshme efektet e një kërcënimi ose rreziku të mundshëm të identifikuar.

Mbrojtja përkufizohet, si; Tërësia e masave për të mbrojtur fizikisht njerëzit dhe mjedisin dhe për të zbutur pasojat që mund të vijnë nga efektet e një kërcënimi ose rreziku të mundshëm të identifikuar.

“Masat mbrojtëse”, në ligjin nr. 8756, datë 26.III.2001, përkufizohen: “Masat mbrojtëse përfshijnë masat organizative dhe teknike, si dhe mjetet e tjera për mbrojtje personale dhe kolektive të menjëhershme të njerëzve, kafshëve, pronës, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe mjedisore kundrejt rreziqeve natyrore ose atyre që mund të vijnë nga veprimtaria njerëzore”.

Aktivitetet e përgatitjes dhe të mbrojtjes janë të lidhura ngushtë me aktivitetet e parandalimit dhe të lehtësimit, nga të cilat identifikohen shpesh masat mbrojtëse. Kjo fazë është gjithashtu e lidhur ngushtë me fazën e përgjigjes. Në rastin e ndodhjes së një emergjence, shumë nga masat përgatitore dhe mbrojtëse kthehen në aktivitetet e para të fazës së përgjigjes, si dhe përbëjnë hapat që merren në aktivizimin e SSHKEC-së.

Në këtë seksion jepen konsiderata të përgjithshme dhe të veçanta të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera që duhet të kemi parasysh për reduktimin e pasojave. Këto konsiderata mbështeten në përfundimet e dokumentit të “Vlerësimit të rreziqeve në Shqipëri”, ku janë vlerësuar rreziqet kryesore që prekin Shqipërinë dhe pasojat që vijnë prej tyre.

Marrja e masave për përgatitjen e strukturave dhe komunitetit për të përballuar efektet e rreziqeve dhe për t'i mbrojtur ato nga pasojat që mund të krijohen, duhet të jetë përparësi e institucioneve dhe e strukturave të niveleve të ndryshme. Në këtë mënyrë, ndikimi i një situatë emergjence civile të pashmangshme mund të zvogëlohet dhe rikthimi në gjendjen normale mund të bëhet më shpejt dhe me më pak humbje, kur strukturat dhe komuniteti janë sa më të përgatitur për përballimin e situatave emergjente.

5.2 Plani Kombëtar i Emergjencave Civile (PKEC) për Përgatitjen dhe Mbrojtjen

PKEC-ja është një dokument i cili përcakton rolin dhe përgjegjësitë e strukturave të çdo niveli, për të ndërmarrë masa paraprake përgatitore dhe mbrojtëse në momentin e identifikimit të një rreziku të mundshëm.

Nëpërmjet PKEC-së përcaktohet mënyra e realizimit dhe e përgatitjes së këtyre masave, përparësitë si dhe aktivitetet për realizimin e tyre.

Në këtë aspekt, PKEC-ja, shoqëruar edhe nga planet e tjera sipas fushave të veprimtarisë së institucioneve të përfshira në emergjencat civile, planeve në nivel lokal dhe rajonal, plotëson kuadrin teorik të realizimit me efektivitet të masave përgatitore dhe mbrojtëse në çdo nivel.

Në seksionin 10 janë përshkruar më në detaje hapat dhe përparësitë për zbatimin e PKEC-së për strukturat dhe institucionet në lidhje me përgatitjen dhe mbrojtjen.

5.3 Institucionet dhe planet e emergjencave

Institucionet dhe strukturat e ngarkuara me përgjegjësi për çështjet e emergjencave civile janë të detyruara të hartojnë planet e tyre të emergjencave civile, për të realizuar përgjegjësitë dhe detyrimet e dhëna në PKEC. Të gjitha planet specifike të emergjencave duhet të jenë koherente duke parashikuar masa për përgatitjen e strukturave, komunitetit dhe mjedisit në mënyrë që ndikimet e emergjencave të jenë sa më minimale. Këto plane të shoqërohen me ndryshimet e herëpashershme, të cilat duhet t'i dërgohen DPPEC-së. Më pas, ndryshimet e mbledhura do të reflektohen në PKEC gjatë fazës së rishikimit të tij.

5.4 Planet sektoriale të emergjencave dhe gadishmërisë

Të gjitha institucionet dhe strukturat, qofshin ato të sektorit shtetëror ose privat, detyrohen të hartojnë planet e tyre të emergjencave/gatishmërisë. Këto plane janë të domosdoshme, si për mbrojtjen e kapaciteteve të tyre në rastin e një situatë emergjence civile, ashtu edhe për të parashikuar afrimin e shërbimeve sa më të shpejta dhe të mundshme gjatë përballimit të situatave emergjente, si dhe gjatë rikthimit në gjendjen normale. Struktura dhe përmbajtja e detajuar e planeve të emergjencave/gatishmërisë, sektoriale dhe të objekteve me rëndësi, jepen në manualët e emergjencave civile të cilat janë pjesë e kurrikulës së emergjencave civile të hartuara nga MPVD-ja.

- Planet sektoriale për probleme të caktuara, mund të jenë kombëtare, rajonale ose lokale.
- Planet e gatishmërisë hartohen nga strukturat në nivel qendror, rajonal dhe lokal dhe përgatiten për menaxhimin e fatkeqësive të caktuara, që kanë mundësi të ndodhin në një të ardhme të afërt. Zakonisht, përdoren për një periudhë transit deri në përgatitjen e planit të emergjencave. Planet e gatishmërisë mund të përgatiten për emergjencat stinore, rreziqe të shfaqura rishtas ose për emergjencat të cilat nuk janë përfshirë në planin kryesor.
- Planet e emergjencave për objekte të rëndësishme të subjekteve juridike ose fizike, shtetërore ose private, janë plane specifike. Ato shërbejnë për të mbrojtur jetën dhe pasurinë brenda dhe jashtë objekteve. Planet parashikojnë përballimin e situatave emergjente nëpërmjet përdorimit të resurseve dhe kapaciteteve që disponohen për përballimin e emergjencave të tyre, si dhe për dhënien e ndihmës jashtë objekteve të tyre, në rast se kërkohet.

Në këto plane, krahas të tjerave, parashikohen masa mbrojtëse kryesisht për mjedisin, për mënyrën e menaxhimit të materialeve të rrezikshme, për shembull: ndërtimin e mureve mbrojtëse rreth depozitave të naftës, masat për parandalimin nga zjarri, ndotjet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, në mënyrë të veçantë ato detare etj.

5.5 Identifikimi i rreziqeve të mundshme

Në nivel qendror, qarku dhe vendor, përgatitja dhe mbrojtja efektive kërkon njohjen sa më të mirë të rreziqeve specifike dhe të pasojave të mundshme që sjellin ato. Në studimin “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”, analizohen në mënyrë të detajuar rreziqet specifike dhe pasojat e tyre në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë humbjet e mundshme në jetë njerëzish dhe vlera ekonomike. Në të identifikohen, gjithashtu, zonat e Shqipërisë të prekura historikisht nga këto rreziqe dhe ato që kanë më shumë mundësi të preken në të ardhmen. Rreziqet e mëposhtme janë rreziqet kryesore që kanë prekur Shqipërinë, të cilat janë shpjeguar dhe analizuar në tekstin e përmbledhjes ekzekutive të studimit, dhe janë të mbështetura nga tabelat dhe hartat e rreziqeve në territorin shqiptar. Për më shumë informacion, shihni shtojcën “A”.

- Rreziqet sizmike
- Rreziqet nga përmytjet
- Rreziqet nga dëbora
- Rreziqet nga rrëshqitjet e tokës
- Rreziqet teknologjike/industriale

- Rreziqet nga aktet terroriste

Identifikimi i rreziqeve dhe ndërgjegjësimi i strukturave përkatëse për pasojat që mund të shkaktojnë dukuri të mundshme rreziku, specifike në zonë, sjell marrjen në konsideratë të masave përgatitore për një ngjarje të tillë dhe gjetjen e mënyrave për mbrojtjen nga efektet e saja, për të pasur sa më pak ndikime për njerëzit dhe pasurinë.

Kjo fazë shkon përtej fazës së parandalimit dhe të lehtësimit, sepse vlerësohet cenueshmëria e popullsisë dhe e pronës dhe merren të gjitha masat e menjëhershme për përgatitje dhe mbrojtje nga të gjitha llojet e emergjencave.

Masat e përgjithshme për parapërgatitje dhe mbrojtje mund të jenë të aplikueshme për një sërë dukurish të mundshme rreziku, por secili ka dhe specifikat e tija, meqenëse mund të japin pasoja nga më të ndryshmet.

5.6 Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rreziqet

Ndërgjegjësimi ndaj rreziqeve dhe përgatitja për monitorimin e situatës janë hapat e parë për fazën e parapërgatitjes dhe të mbrojtjes dhe janë detyrim për institucionet, strukturat dhe subjektet fizike dhe juridike. Këto realizohen nëpërmjet aktiviteteve të vazhdueshme, të cilat përfshijnë:

- *Fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe të edukimit.*

Prodhimi dhe publikimi i fletëpalosjeve, posterave, hartave të rreziqeve dhe i materialeve të tjera edukative, dhënia e informacionit nëpërmjet medias, takimeve me publikun dhe punës në shkolla dhe organizata joqeveritare rrit ndërgjegjësimin e publikut dhe të institucioneve për rreziqet specifike dhe njëkohësisht inkurajon pjesëmarrjen dhe komunikimin e tyre në fazën e përgjigjes ndaj emergjencave. Aktivitete të tilla duhet të zhvillohen nga institucione dhe struktura përgjegjëse e të bashkërendohen nga DPPEC-ja. Këto mund të mbështeten në kapacitetet e grupeve të punës dhe duhet të bashkërendohen me administratën lokale, median e shkruar dhe elektronike, KKSH-në si dhe strukturat e tjera. Duke përdorur shprehjet dhe idetë e duhura, duhet të synohet sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i grupeve, si më poshtë:

- Drejtuesit në nivel qarku, komune dhe bashkie.
- Institucionet qeveritare me role kyç në çështjet e emergjencave civile.
- Zyrtarë të tjerë me rol kyç dhe vendimmarrësit në zyrat publike dhe në sektorin privat.
- Grupet e identifikuara të komunitetit në zonat urbane, familjet dhe komunitetin në zonat rurale.
- Vullnetarët, organizatat qeveritare dhe organizatat jofitimprurëse.
- Publiku i gjerë, duke përfshirë grupet më të prekura të shoqërisë, si: gratë, fëmijët, familjet e mëdha, grupet e të moshuarve dhe të minoreneve
- Komuniteti diplomatik dhe donatorët.

- *Planet dhe stërvitjet.*

Në mënyrë që planet e hartuara të jenë sa më afër përballimit të realitetit dhe ngjarjes, duhet të bashkërendohen veprimtaritë praktike të të gjitha institucioneve dhe të strukturave pjesëmarrëse. Gjatë zhvillimit të stërvitjeve simuluese, stërvitjeve të strukturave drejtuese dhe testimit në terren të planeve të evakuimit, si dhe të planeve operacionale të hartuara, bazuar në hartat e rreziqeve të zonës, duhet të përqendrohet vëmendja tek rreziqet specifike.

Institucionet qendrore dhe strukturat e niveleve të ndryshme kanë detyrime për përgatitjen dhe zhvillimin e stërvitjeve të ndryshme dhe për testimin e planeve. Në këto stërvitje rëndësi kryesore ka aftësimi i strukturave për menaxhimin e emergjencave civile.

Institucionet dhe strukturat që përgatitin dhe zhvillojnë stërvitje me tematike nga emergjencat civile, detyrohen të informojnë dhe të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me strukturat e SHEC-së

5.7 Monitorimi dhe mekanizmat aktiv

Monitorimi sistematik i rreziqeve që vijnë si rezultat i fatkeqësive të ndryshme, kërkojnë përcaktimin e saktë të roleve dhe të përgjegjësive të strukturave të emergjencave. Gjithashtu, kërkohej vendosja e linjave të qarta të raportimit midis strukturave monitoruese të emergjencave civile, qendrore dhe lokale. Procedurat e monitorimit përforcohen nga kritere ose tregues të qartë për njoftimin e hershëm dhe aktivizimin e SSHKEC- së. Institucionet dhe strukturat përkatëse që kanë kapacitete ose struktura vartëse për monitorimin dhe dhënien e informacionit, kanë për detyrë të japin informacion periodik dhe specifik në DPPEC. Këto kritere duhet të miratohen nga institucioni ose struktura që merr dhe jep informacion gjatë monitorimit. Në këtë mënyrë, monitorimi në bazë ditore vazhdon deri në momentin e shfaqjes të shqetësimit serioz, i cili mund të jetë pragu i një situatë emergjence të pritshme. Në këtë moment bëhet kontakti i menjëhershëm me strukturat e emergjencave civile dhe monitorimi e transferimi i vazhdueshëm i të dhënave do të shërbejë për përgatitjen e etapës I të fazës së përgjigjes, asaj të “Alarmit për rritjen e gatishmërisë”.

Kërkesat për monitorim dhe çështjet më kryesore që duhet të mbulohen, përfshijnë:

- Monitorimin e aktivitetit sizmik dhe hidrometeorologjik, vlerësimin e treguesve kritikë me qëllim aktivizimin e SSHKEC-së.
- Monitorimin e nivelit të ujit brenda kapaciteteve të sigurisë së digave, duke kërkuar derdhjen e tij në rastet e tejmbushjes.
- Monitorimin e zonave me rrezik rrëshqitjeje ose që kanë mundësi potenciale për të qenë të tilla.
- Monitorimin e reshjeve lokale të dëborës, shpejtësisë së erës/ drejtimit dhe kushtet e temperaturës, krahasuar me treguesit e lejuar të cilët ndikojnë në bllokimin ose në mbylljen e rrugëve.
- Monitorimin e trashësisë së konsoliduar të borës mbi faqet e thepisura të zonave me rrezik, kundrejt treguesve të lejuar, për pjerrësi prej 30 gradësh dhe më tepër.
- Monitorimin e kushteve dhe rreziqeve të rënies së zjarreve në pyje në zonat në rrezik
- Monitorimin e funksionimit të kushteve të sigurisë në objektet industriale dhe ndërtesat, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me strukturën e emergjencës civile në secilin objekt ose ndërtim.
- Monitorimin e ndotjes së mjedisit.
- Monitorimin e kushteve të higjienës dhe të epidemiologjisë.
- Monitorimin e sëmundjeve në bimë dhe në kafshë.

5.8 Njoftimi i hershëm

Sistemet e njoftimit të hershëm përfshijnë listat, rolet, përgjegjësitë dhe kontaktet që kanë lidhje drejtpërdrejt me aktivizimin e SSHKEC-së, etapën I, “Alarm për rritjen e gatishmërisë”. Institucionet të cilat kanë struktura në nivele të ndryshme, si dhe njësitë e qeverisjes vendore, kanë përgjegjësi të sigurohen që të gjitha strukturat në nivel lokal dhe qendror janë njohur me sistemet e njoftimit të hershëm si dhe me pikat e kontaktit dhe procedurat përkatëse. Gjithashtu, është përgjegjësia e personelit të caktuar për emergjencat në nivel qendror, qarku, komune ose bashkie, të sigurohet që mesazhet janë të thjeshta, të kuptueshme dhe t’i transmetohen në kohë publikut dhe institucioneve, duke i këshilluar ata për rreziqet dhe hapat e nevojshëm që duhet të merren prej tyre.

Njoftimi bëhet nëpërmjet strukturave përgjegjëse duke filluar nga organizimi më i vogël vendor deri në atë qendror si dhe nëpërmjet strukturave të specializuara.

5.9 Punët publike emergjente dhe masa të tjera

Punët publike emergjente janë pjesë e aktiviteteve për të siguruar parapërgatitje dhe mbrojtje ndaj rreziqeve të veçanta dhe stinore, në rastet kur masat lehtësuese dhe parandaluese nuk janë në

gjendje të ulin nivelin e rrezikut në kohë.

Masa të tilla përfshijnë:

- Masa të përkohshme shtesë për parandalimin e shtrirjes së përmytjes së mëtejshme, si për shembull: përforcimin e digave, pastrimin e kolektorëve dhe të kanaleve, rregullimin e portave të ujit, sigurimin e thasëve të rërës etj.
- Riparimin dhe përforcimin e urave, mbrojtjen e pjerrësive të paqëndrueshme dhe përforcimin e mureve mbrojtëse të rrugëve, pritave malore etj.
- Pastrimin e pyjeve dhe krijimin e zonave të ndarjes për zjarret .
- Shmangien e rrezikut nga ortekët nëpërmjet grumbullimit të dëborës në pjerrësi të mëdha që shkojnë më shumë se 30 gradë.
- Angazhimin dhe vendosjen në vend të pajisjeve speciale, kapaciteteve transportuese dhe artikujve të ndihmës gjatë periudhave që mund të cilësohen me rrezik.
- Përgatitjen e shenjave dhe vendosjen e pajisjeve për hapjen dhe mbylljen e shpejtë të rrugëve, urave dhe sigurimin e mundësive të tjera transporti lidhëse.

5.10 Parapërgatitja sezonale dhe masat mbrojtëse

Masat përgatitore dhe mbrojtëse të përshkruara në këtë seksion mund të quhen edhe si masa stinore parapërgatitjeje. Këto masa janë detyrime ligjore për institucionet dhe strukturat, të cilat duhet të ndërmerren përpara ardhjes së stinës përkatëse.

Në vendin tonë masat stinore të parapërgatitjes merren kryesisht për rreziqe, si:

- Reshjet e dendura dhe përmytjet e mundshme (shtator deri në prill).
- Reshjet e mëdha të borës (dhjetor deri në shkurt).
- Zjarret në pyje (qershor deri në gusht).

5.11 Rolet dhe Përgjegjësitë

Përcaktimi i roleve dhe i përgjegjësive të qarta të strukturave të emergjencave në nivele të ndryshme janë detyrime që rrjedhin nga aktet nënligjore. Këto realizohen nëpërmjet procedurave të bashkërendimit dhe duhet të jenë sipas llojeve të emergjencave dhe të rreziqeve të stinës.

Rolet dhe përgjegjësitë janë dhënë në seksionin 2, 6 dhe në shtojcën “B”.

5.11.1 Në nivel kombëtar

Ministritë e linjës, institucionet dhe strukturat e ndryshme, nëpërmjet personelit të emergjencave, i japin/ i konfirmojnë DPPEC-së:

- Të gjitha detajet e pikave të kontakteve në: ministritë përkatëse të linjës, strukturat vartëse të përfshira, forcat operacionale, institucionet, entet publike ose private, të drejtuesit të qarkut, komunës dhe bashkisë dhe të gjithë aktorëve të tjerë kyç, duke përfshirë përfaqësuesit e emergjencave të vendeve që kanë konventa bashkëpunimi bilaterale dhe rajonale, të Kombeve të Bashkuara dhe të Komunitetit Ndërkombëtar.
- Freskimin e rrjetit të lajmërimit publik dhe nëpërmjet testeve periodike bëjnë konfirmimin për gjendjen e mjeteve të komunikimit.
- Freskimin e të dhënave rreth gjendjes/disponueshmërisë së artikujve ushqimorë dhe joushqimorë në nivel kombëtar dhe të rezervës, si dhe të barnave mjekësore, pronë shtetërore ose private, të cilat janë të magazinuara në objekte të veçanta shtetërore dhe joshtetërore etj.
- Freskimin e të dhënave të logjistikës së transportit, duke përfshirë numrin e makinave, gjendjen teknike të tyre dhe disponueshmërinë e karburantit dhe rezervën e tij.
- Freskimin e të dhënave për llojet e makinerive të rënda dhe për vendndodhjen e makinerive në dispozicion, si nga sektori shtetëror, ashtu edhe ai privat.

- Vendin ku janë dërguar dhe vendosur mjetet e ndryshme të transportit dhe sjelljen e makinerive të rënda në zonat që kanë mundësi të izoloohen.
- Takimet e rregullta të personelit të përfshirë në SEC, për të siguruar parapërgatitjen dhe për t'u përshtatur gjatë rishikimit periodik të PKEC-së.

5.11.2 Në nivel Qarku

Prefekti dhe punonjësi i emergjencave civile:

- Njoftojnë në mënyrë të vazhdueshme DPPEC-në për ndryshimin e të dhënave të pikave të kontakteve të KPPECQ-së, për strukturat e emergjencave civile brenda qarkut, për zyrtarët e caktuar si përgjegjës për çështje të emergjencave civile në nivel komune dhe bashkie dhe pikat kyç në sektorët publikë, privatë dhe vullnetarë.
- Sigurojnë që sistemet e paralajmërimit të publikut dhe të komunikimit janë funksionale.
- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat rreth gjendjes ushqimore si dhe të dhënat në lidhje me ilaçet rezervë në institucionet shtetërore dhe ato private, në nivel qarku.
- Kontrollojnë dhe freskojnë detajet e logjistikës së transportit, duke përfshirë numrin e makinave, gjendjen e tyre teknike, disponueshmërinë e karburantit dhe rezervën e tij në nivel qarku.
- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat për llojet e makinerive dhe vendndodhjen e makinerive të rënda, të zotëruara si nga sektori shtetëror, ashtu edhe ai privat, në nivel qarku.
- Bëjnë veprimet e duhura për sjelljen e mjeteve të rënda të transportit dhe vendosjen e makinerive të rënda në zonat që mund të izoloohen, nëse është e nevojshme.
- Kontrollojnë marrjen e masave të tjera në nivel qarku, për t'u mbrojtur nga dukuri të mundshme rreziku, duke përfshirë:
 - o marrjen e masave për të siguruar pastrimin e kanaleve dhe të kolektorëve;
 - o njohjen e komunitetit me rrugët e evakuimit, mjetet për komunikimin gjatë emergjencave, mjetet e informimit, zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta;
 - o ndërgjegjësimin e komunitetit për ruajtjen e ushqimit të nevojshëm, të ujit dhe të rezervave të tjera minimale;
 - o marrjen e masave për hapjen e rrugëve ekzistuese dhe të rrugëve alternative, nëse është e nevojshme.

5.11.3 Në Nivel Bashkie dhe Komune

Strukturat e caktuara me përgjegjësitë për emergjencat civile në nivel bashkie dhe komune:

- Njoftojnë në mënyrë të rregullt prefektin e qarkut (zyren e EC-së) për të gjitha ndryshimet e pikave të kontaktit në njësinë përkatëse, si për kryetarin e bashkisë dhe të komunës, punonjësin e emergjencave civile në bashki dhe komunë, anëtarë të KVEC-së në bashki dhe komunë dhe kontaktet e tjera kyç në sektorët publikë, privatë dhe vullnetarë.
- Sigurojnë funksionimin e sistemit të paralajmërimit dhe të komunikimit të publikut.

Kontrollojnë dhe freskojnë inventarin e logjistikës së transportit, duke përfshirë numrin e makinave, gjendjen e tyre teknike, disponueshmërinë e karburantit dhe rezervën e tij në nivel bashkie dhe komune.

Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat rreth llojeve dhe vendndodhjes së makinerive të rënda të zotëruara, si nga sektori shtetëror, ashtu edhe ai privat, në nivel komune ose bashkie.

- Kontrollojnë marrjen e masave të tjera për mbrojtjen nga dukuri të mundshme të rrezikut në nivel komune ose bashkie, duke përfshirë:
 - o marrjen e masave për të siguruar pastrimin e kanaleve dhe të kolektorëve nga mbeturinat ose materialet inerte;
 - o njohjen e komunitetit me rrugët e evakuimit, mjetet për komunikimin gjatë emergjencave, mjetet e informimit dhe zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta;
 - o ndërgjegjësimin e komunitetit për domosdoshmërinë e ruajtjes së ushqimit, ujit dhe rezervave të tjera minimale.

5.12 Prioritetet për Përgatitjen dhe Mbrojtjen

Përparësi në fushën e përgatitjes dhe të mbrojtjes janë:

- Përgatitja e rregulloreve të funksionimit të strukturave të përkohshme, siç janë: KNEC-ja, KTKSEC-ja, EMEC-ja dhe QKOEK-ja.
- Përgatitja dhe pajisja e mjediseve të punës së KNEC-së dhe EMEC-së.
- Krijimi dhe vënia në funksionim e Qendrës Kombëtare të Trajnimeve (QKT) për Mbrojtjen Civile.

6. PËRGJIGJA

6.1 Hyrje

Faza e tretë e ciklit të emergjencave e cila përshkruhet në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, është faza e përgjigjes.

Për qëllimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile:

përgjigjja përkufizohet, si: Tërësia e veprimeve të forcave dhe të mjeteve për shpëtimin e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale (pronës) në një territor të prekur nga fatkeqësia.

Faza e Përgjigjes kalon në këto etapa:

- *Etapa 1:* “Alarm për rritjen e gatishmërisë” është tërësia e masave për njoftimin paraprak pas marrjes së informacionit se mund të lindë një situatë emergjence dhe shërben si sinjal për rritjen e gatishmërisë.
- *Etapa 2:* “Gatishmëria” është tërësia e masave për njoftimin paraprak, pasues, pas informacionit që një situatë emergjence është e afërt ose në zhvillim.
- *Etapa 3:* “Aktivizimi” është kur një situatë emergjence ka ndodhur realisht.
- *Etapa 4:* “Dalja nga situata” është mbyllja e fazës së përgjigjes, pavarësisht sesa etapa të mëparshme kanë ndodhur realisht.

6.2 Raportimi i situatave të Emergjencave Civile

Është detyra e çdo strukture shtetërore, joshtetërore dhe qytetari në Shqipëri që, në mënyrë të menjëhershme, të informojë tek njësitë vendore: komunë, bashki dhe qark, në administratën e prefektit dhe institucionet e strukturat qendrore të çdo niveli në lidhje me situata reale apo të mundshme për emergjenca civile.

Informacioni për ngjarje reale apo të mundshme emergjente zakonisht vjen nga vrojtuesi i parë drejtpërdrejt në vendngjarje, strukturat policore, forcat e armatosura, zjarrfikës, punonjës të strukturave të ndryshme shtetërore, institucione monitoruese apo qytetar dhe, nëpërmjet tyre, tek autoritetet e qeverisjes vendore, qarkut dhe ato qendrore dhe detajet rreth situatës duhet të shpërndahen për të gjitha autoritetet përkatëse dhe të bëhen të disponueshme për të gjitha institucionet, strukturat dhe publikun e gjerë në të gjithë territorin e prekur.

Për këtë qëllim shfrytëzohen të gjitha mundësitë e komunikimit dhe kapacitetet që ekzistojnë në strukturat shtetërore dhe joshtetërore.

Pas marrjes së njoftimit, autoritetet zyrtare duhet të kenë si përparësi përcjelljen e informacionit në QKOEK.

Në rastin kur informacioni merret drejtpërdrejt nga QKOEK-ja, informohen autoritetet përkatëse në bashki, komunë dhe qark dhe kërkohet prej tyre verifikimi i informacionit. QKOEK-ja informon drejtorin e DPPEC-së, i cili, sipas rastit, informon ministrin e MPVD-së për çdo emergjencë ose mundësi të ndodhjes së saj dhe, sipas rastit, mund të fillojë aktivizimi i SSHKEC-së, si më poshtë:

6.3 Qendra Kombëtare e Emergjencave Civile

Në QKOEK, në DPPEC dhe në MPVD mblidhet dhe përpunohet i gjithë informacioni për situatat reale apo të mundshme të emergjencave civile. QKOEK-ja është në kontakt të vazhdueshëm me punonjësit e emergjencave civile dhe qendrat operacionale të institucioneve dhe strukturave

qendrore dhe lokale, për transmetimin e menjëhershëm të informacionit në të gjitha etapat e parapërgatitjes dhe të përgjigjes. Në të njëjtën kohë, kjo qendër mban lidhje të vazhdueshme me të gjitha strukturat e gatishmërisë për emergjencat të cilat paraqiten në kapitullin 6.16.

6.4 Sistemi Kombëtar i Shërbimit të Emergjencave Civile (SKShEC)

SKShEC-ja është tërësia e strukturave, burimeve njerëzore dhe materiale, shtetërore dhe joshtetërore, të cilat angazhohen për përballimin e situatave emergjente.

SKShEC-ja përbëhet nga struktura të përhershme dhe të përkohshme të cilat, në varësi të kapaciteteve, aktivizohen sipas situatave që mund të krijohen. Me aktivizimin e SKShEC-së sigurohet një përgjigje e përshtatshme dhe e menjëhershme për të gjitha llojet e fatkeqësive edhe nëse nuk është dhënë alarmi për rritjen e gatishmërisë.

6.5 Etapat për aktivizimin e SKShEC

Nëpërmjet etapave të aktivizimit të SKShEC-së sigurohet përdorimi i kapaciteteve në mënyrë të përshtatshme për të gjitha llojet e emergjencave edhe pse, sipas situatave, mund të mos kalohet në të gjitha etapat. Në rastin e një ngjarjeje të papritur, të menjëhershme, aktivizimi i sistemit fillon drejtpërdrejt me etapën 3 “aktivizimin”. Në çdo rast, nëse merret informacion paralajmërues, për të siguruar parapërgatitjen optimale, shfrytëzimin në maksimum të burimeve dhe bashkërendimin në mënyrën më të mirë të mundshme të përgjigjes kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj emergjencës, ndiqen katër etapat e mëposhtme:

Etapa 1: “Alarm për rritjen e gadishmërisë”

Drejtori i DPPEC-së vendos fillimin e etapës 1, “alarm për rritjen e gatishmërisë”, në çastin e marrjes së njoftimit paraprak ose të informacionit për mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje e cila mund të shoqërohet me dëmtime në njerëz dhe dëme materiale.

ETAPA 1. “ALARM PËR RITJEN E GADISHMËRISË”

<i>Drejtori i Departamentit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile:</i>	<i>Kontrolli i realizimit të aktivitetit</i>
1. Informon Ministrin e MPVD për kalimin në gjëndjen “Alarm për rritjen e gadishmërisë”.	
2. Komunikon me Prefektin/tët dhe drejtuesit e organeve të pushtetit vendor.	
3. Informon të gjitha institucionet dhe strukturat e duhura.	
4. Informon institutet shkencore dhe kërkon prej tyre dhënien e informacionit të vazhdueshëm dhe parashikimin për zhvillimin situatës.	
5. Verifikon nëse QKOEK ka staf të mjaftueshëm dhe të pajisur për punë 24 orë gjatë etapës së “Alarm për rritjen e gadishmërisë”.	
6. Kontrollon mjetet e komunikimit, numrat e telefonave celularë, radiot, llambat e ndriçimit dhe siguron që telefonat të jenë të karikuar. Kërkohen numra telefonikë shtesë dhe njoftohen operatorët e komunikimit për situatën.	
7. Verifikon nëse mjetet e transportit të DPPEC janë në gadishmëri, të pajisura me mjetet e nevojshme, karburant dhe nëse kanë rezervë karburanti.	
8. Kërkon informacion për rezervën cash (monedhë) që mban Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për situatat emergjente.	

9. Kërkon DPRSH konfirmimin e nivelit të stokut, gjëndjen dhe vendndodhjen.	
10. Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmërimet dhe këshillimet e duhura për publikun me anë të mjeteve të informimit.	
11. Përgatit informacion të përmbledhur për përfaqësuesit e Qeverive Donatore, OKB-së, KKSH, organizatave jo fitimprurëse në vend dhe kontribuesve të tjerë.	

Etapa 2: Vendosja e Gjëndjes së Gadishmërisë

Drejtori i DPPEC-së vlerëson nevojën e fillimit të etapës 2, “vendosjes së gjëndjes së gadishmërisë”. Kjo bëhet kur një ngjarje e afërt konsiderohet e pashmangshme dhe që mund të shoqërohet me dëme në njerëz dhe materiale.

ETAPA 2. VENDOSJA E GJËNDJES SË GADISHMËRISË

Drejtori i Departamentit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile (DPPEC):	Kontrolli i realizimit të aktivitetit
1. Informon Ministrin e MPVD rreth situatës dhe nevojës për fillimin e etapës 2 “Vendosja e Gjëndjes së Gadishmërisë”, i cili pas konsultimeve dhe vlerësimeve vendos fillimin e kësaj etape.	
2. Mbledh pranë DPPEC-në, KTKSEC për emergjencat civile dhe kërkon përgatitjen për procesin e marrjes së vendimeve, takimeve informative për median dhe partnerët.	
3. Komunikon me Prefektin dhe drejtuesit vendor, duke kërkuar mbledhjen e KECCQ dhe ndjekjen e situatës sipas planeve të emergjencave.	
4. Informon të gjitha institucionet dhe strukturat e duhura, veçanërisht ato që përfshihen në përgjigjen e parë (njoftimi paraprak/informimi i publikut, evakuimi, kërkim-shpëtimi, ndihma e parë, zjarrfikësi, dhe sigurimi i vendeve të strehimit të përkohshëm).	
5. Komunikon me institutet, strukturat monitoruese dhe kërkon prej tyre dhënie të vazhdueshme të parashikimit të situatës, informacioni i cili i dërgohet në mënyrë të menjëhershme Ministrisë të MPVD.	
6. Siguron dërgimin urgjent të të gjitha të dhënave dhe parashikimeve Punonjësve të Emergjencave Civile dhe Qendrave Operacionale në Qark (QOQ).	
7. Harton Raportin e Parë për Situatën dhe informacione të rezervuara të cilat sipas rastit i dërgohen Këshillit të Ministrave, institucioneve dhe ministrive respektive të linjës dhe një përmbledhje të këtij Raporti ia dërgon Prefektit (ëve) të Qarkut (ve) të rrezikuara nga fatkeqësia.	
8. Kontrollon dhe siguron që të gjitha masat e mëparshme janë përmbushur. QKOEK-ja punon me staf të plotë, të pajisur për të punuar në Etapën e Gadishmërisë për 24 orë.	
9. Krijon Grupe të Përbashkëta Vlerësimi për në zonat e rrezikuara nga fatkeqësia, verifikimin e të dhënave për situatën dhe në mbështetje të strukturave të emergjencave civile.	
10. Përgatit materiale paraprake mbi dëmet, nevojat e pritshme dhe forcat operacionale që mund të përfshihen për përballimin e emergjencave, nisur nga informacionet, për zonën, natyrën e fatkeqësisë, të dhënat GIS dhe vlerësimi i rreziqeve etj.	
11. Përgatit informacione për publikun, median dhe raporte periodike për instancat Qeveritare, Donatorët, KKSH, dhe OJF-të interesuara.	

Etapa 3: Aktivizimi

Etapa 3 fillon në rastet kur një ngjarje e papritur ka shkaktuar dëmtime në njerëz dhe materiale ose kur një ngjarje e ngadaltë është në zhvillim e sipër dhe mund të sjellë të njëjtat pasoja të cilat tejkalojnë mundësitë për t'u përballuar nga strukturat e SHEC-së në nivel lokal. Ministri i MPVD-së është autoriteti që njofton fillimin e etapës 3, "aktivizimit", duke angazhuar vetëm strukturat e përhershme që në misionin e tyre kanë detyra për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Në rast se emergjenca është e përmasave të mëdha dhe shpallet gjendja e emergjencave civile, me vendim të Këshillit të Ministrave krijohet KNEC-ja. Në mbledhjen e tij të parë, KNEC-ja emëron DQO-në, që do të marrë drejtimin e përgjithshëm për përgjigjen në nivel kombëtar dhe ndihmën ndërkombëtare, nëse është e nevojshme.

ETAPA 3. AKTIVIZIMI

Për emergjenca të shkallës së ulët: Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit:	Kontrolli i përfundimit të aktivitetit
1. Sigurohet për aktivizimin e strukturave dhe kapaciteteve të përgjigjes në nivel komune, bashkie dhe qarku, duke përfshirë dhe vënien në funksion të KPPECQ.	
2. Kërkon informacion nga Prefekti dhe DPPEC, rreth situatës së emergjencës dhe gjëndjes me deklarinimin e etapës 3 "Aktivizimi".	
3. Qendron në kontakt me organizmat dhe donatorët brenda vendit, për sigurimin e mundësive të mbështetjes.	
4. Kërkon aktivizimin e menjëhershëm të institucioneve dhe strukturave qendrore operacionale te nevojshme.	
5. Nëse është e nevojshme, Ministri i MPVD ose Ministra te tjere sipas lloit te emergjences i propozojne Kryeministrit deklarinimin e Gjëndjes së Emergjencës Civile për zonën e përfshirë.	
6. Nëse është e nevojshme, Ministrit i MPVD i propozon Keshillit te Ministrave krijimin e KNEC.	
Drejtori i Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile	
7. Nëse nuk është bërë ende (për rastet e emergjencave të menjëhershme), mbledh pranë QKOEC-së atë pjesë të KTKSEC te domosdoshme per konsultime sipas lloit te emergjences dhe fillon përgatitjen për procesin e marrjes së vendimeve.	
8. Nëse nuk është bërë ende, krijon Grupe të Përbashkëta Vlerësimi për t'u dërguar në zonat e prekura nga fatkeqësia, për verifikimin e të dhënave për situatën dhe mbështetjen e autoriteteve lokale.	
9. Kërkon informacion periodik rreth situatës në terren, nga Grupet e Përbashkëta të Vlerësimit dhe KPPECQ dhe KVEC në Komunë/Bashki.	
10. Harton Raportin e Parë për Situatën dhe informacione të rezervuara të cilat sipas rastit i dërgohen Këshillit të Ministrave, institucioneve dhe ministrive respektive të linjës dhe një përmbledhje të ketij Raportit ia dërgon Prefektit (ëve) të Qarkut(ve) të rrezikuara nga fatkeqësia.	
11. Komunikon me institutet/strukturat monitoruese dhe kërkon prej tyre dhënien e informacionit të vazhdueshëm për parashikimin e situatës, infomacion i cili i dërgohet në mënyrë të menjëhershëm Ministrit të Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.	
12. Dërgon menjëherë të gjitha të dhënat dhe parashikimet për SEC në nivele të ndryshme.	
13. Siguron që QKOEC-ja të punojë me staf të plotë, të pajisur për të punuar 24 orë dhe pranë saj është gati vënia në funksion të plotë e Ekipit të Menaxhimit të Emergjencës.	
14. I propozon Ministrit të MPVD-së per të kërkuar asistencë nga Organizatat Ndërkombëtare që ndodhen brenda vendit dhe nga partnerët rajonal nëpërmjet marrëveshjeve ekzistuese.	

15. Përgatit informacione për publikun, median dhe raporte periodike për instancat Qeveritare, Donatorët, KKSH, dhe OJF-të e interesuara.	
Për fatkeqësi të shkallës së lartë: Pas emërimit, DQO do të sigurojë këto aktivitete:	
16. Verifikon që hapat e sipërhënuara 7, 8, 9, 11, 12,13, 14,15 janë përbushur dhe në plotësim të pikës 13 Ekipi i Menaxhimit të Emergjencave është vënë në funksion të plotë.	
17. Në varesi nga nevojat i propozon KNEC kërkesat për ndihmë nderkombetar, për pranimin apo refuzimin e asistencës ndërkombëtare për emergjencën (në para, në natyrë, ose shërbime si p.sh. grupe Kërkim-Shpëtimi (SAR), logjistikë, spitale fushorë etj).	
18. Nepermjet EME drejton të gjithë operacionet e strukturave qendrore dhe nderkombetare në mbështetje të drejtuesve të operacioneve në qark, komune dhe bashki.	
19. Përgatit raporte për situatën, kërkesa për ndihmë dhe draft-aktesh të ndryshme, komunikon me median e publikun dhe inspekton direkt operacionet në terren.	

Etapa 4: Dalja nga Situata

Njoftimi për etapën 4, “daljen nga situata”, bëhet nga i njëjti autoritet që e ka njoftuar fillimin e etapës 1, 2 ose 3.

Në etapën 4, “dalja nga situata”, mund të kalohet menjëherë pas etapës 1 ose etapës 2 dhe pa kaluar situatën e fatkeqësisë ose nga etapa 3 kur një ngjarje ka ndodhur realisht. Etapa 4, “dalja nga situata”, paraqet situatën normale në vend, kur nuk ekziston kërcënim i drejtpërdrejtë.

Në çdo rast dalja nga situata bëhet kur:

- Është bërë vlerësimi i plotë i situatës.
- Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar.
- Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e duhura.
- Nevojat më imediate janë plotësuar.

ETAPA 4. DALJA NGA SITUATA

Drejtori i Departamentit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile ndjek etapën 4 “Daljen nga Situata”.	Kontrulli përfundimit të aktivitetit
1. Komunikon me Prefektin/et dhe drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore.	
2. Verifikon që informacioni dhe këshillat e duhura i janë transmetuar publikut nëpërmjet mjeteve të informimit publik.	
3. Informon të gjitha institucionet dhe strukturat e duhura të listuara në 6.14 rreth gjendjes “Dalja nga Situata”.	
4. Informon institucionet/strukturat monitoruese rreth gjendjes “Dalja nga Situata”.	
5. Harton Raporte Përfundimtare të Situatës dhe i shpërndanë në të gjitha institucionet dhe ministrinë përkatëse.	
6. Përgatit informacion përmblledhës, për njoftimin e Etapës “Dalja nga Situata”, për median, Donatorë, OKB-në, KKSH dhe përfaqësuesit e OJF-ve.	
7. Mbledh të gjitha të dhënat, raportet, hartat, dhe korespondencën duke i vendosur ato në dosjet përkatëse nën datën/numrin dhe titullin përkatës.	
8. Siguron rikthimin e QKOEK-së në gjendjen normale të punës me kapacitet të plotë.	

9. Kthen çdo pajisje të marrë hua nga strukturat e tjera.	
10. Kontrollon që mjetet e transportit të DPPEC janë kthyer në vendin e parkimit, kutitë e paisjeve të punës janë plotësuar me materialet shtesë dhe nëse është e nevojshme janë bërë shërbimet shtesë të riparimit dhe furnizimi me karburant.	
11. Kërkon inventarin e gjëndjes financiare dhe mbledhjen e faturave përkatëse.	
12. Kontrollon mjetet e komunikimit, rishikimin e numrave të telefonave celularë, nëse është e nevojshme pajisjet e ndriçimit etj.	
13. I kërkon DPRSH të kontrollojë dhe të plotësojë nivelin e rezervës.	

6.6 Rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazes së Përgjigjes

Menjëherë pas informimit rreth ndonjë situatë emergjente ose ngjarjeje të mundshme të cilat mund të shkaktojnë një emergjencë në nivel rajonal (qark) ose lokal, prefektët, punonjësit e emergjencave civile ose autoritetet e zgjedhura në nivel vendor do të ndërmarrin veprime të njëjta në mbështetje dhe plotësim të SSHKEC-së.

Prefektët e qarqeve

1. Verifikojnë dhe japin informacion QKOEK-së për ngjarje të mundshme rreziku që mund të çojnë në situata emergjente. (Etapa 1 Alarmi).	<i>Kontrolli përfundimit të aktivitetit</i>
2. Sigurojnë raporte të vazhdueshme me gojë dhe me shkrim rreth zhvillimit të situatës. (Etapa 2 Gadishmëria)	
3. Mbledh KPPECQ - në. (Etapa 2 Gadishmëria)	
4. Cakton DOQ - në. (Etapa 2 Gatishmëria)	
5. Harton Raporte Ditore për Situatën dhe i raporton në mënyrë të vazhdueshme QKOEK-së. (Etapa 2. Gadishmëria dhe Etapa 3. Aktivizimi)	
6. Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e ve çanta të paraqitura në këtë plan për Nivelin e Qarkut në 6.6 (Etapa 3. Aktivizimi)	
Organet e Qeverisjes Vendore	
1. Jep informacion për Prefektin, QOQ-në ose direkt në QKOEK rreth ngjarjeve të mundshme të rrezikut. (Etapa 1 Alarmi)	
2. Mbledh KVEC-në në nivel Bashkie/Komune. (Etapa 2 Gatishmëria)	
3. Harton raporte të situatës me shkrim për Prefektin, QOR ose direkt për QKOEK-në. (Etapa 2 Gadishmëria dhe Etapa 3 Aktivizimi).	
4. Ndjek detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e veçanta të planifikuara për organet e qeverisjes vendore. (Etapa 3-Aktivizimi)	

Gjatë fazës së përgjigjes, që mund të quhet më vendimtarja, Rolet dhe Përgjegjësitë për çdo aktivitet janë si më poshtë:

Bashkërendimi i Përgjithshëm: Emergjencia të Shkallës së Ulët

Bashkërendimi i përgjithshëm i përgjigjes kombëtare dhe ndërkombëtare është nën përgjegjësinë e MPVD.

Bashkërendimi i Përgjithshëm: Emergjenca të Shkallës së Lartë

Bashkërendimi i përgjithshëm i përgjigjes kombëtare dhe ndërkombëtare është nën përgjegjësinë e KNEC mbështetet dhe këshillohet nga DPPEC.

KNEC, ka rol bashkërendues me ministrinë përkatëse të linjës, institucionet dhe strukturat monitoruese. KNEC, DQO dhe DPPEC mbështeten nga grupi i UNDAC (Grup i OKB për Vlerësimin dhe Bashkërendimin e Fatkeqësisë) kur ky organizëm është present.

Aktivizimi dhe Bashkërendimi i Forcave Operacionale të nivelit vendor

Aktivizimi i FO në nivel vendor, bëhet nga drejtuesit e organeve të pushtetit vendor, ndërsa bashkërendimi i strukturave të PSH, PMNZSH, FA dhe SHU në nivel qarku dhe i strukturave që vijnë në ndihmë, janë përgjegjësi e Prefektit, i cili këshillohet nga KPPECQ.

Aktivizimi dhe Bashkërendimi i Strukturave Aktive Vepruese dhe Mbeshtetese Kombëtare

Në rast se nuk janë mobilizuar ende, Drejtuesi i Operacionit u kërkon institucioneve përkatëse, aktivizimin e Strukturave Vepruese Aktive (SVA) dhe Mbeshtetese Kombëtare. Bashkërendimi i aktiviteteve të FA, PSH, PMNZSH, SHU etj, është përgjegjësi e DQO i cili mbështetet nga Ekipi i Menaxhimit të Emergjencës.

Operacionet e Kërkim-Shpëtimit (SAR)

Grupet kombëtare të Kërkim-Shpëtimit sigurohen nga: Ministria e Mbrojtjes (MM), Ministria e Rendit Publik (MRP), PMNZSH, Ministria e Industrisë dhe Energjitikës (MIE), grupe vullnetare etj. Operacionet e kërkim-shpëtimit mbështeten nga grupet e kërkim-shpëtimit ndërkombëtare dhe mund të bashkërendohen nga Grupi i UNDAC, në rast është në vend. Grupet ndërkombëtare të Kërkim-Shpëtimit preferohen të jenë të akredituara nga INSARAG (Grupi Ndërkombëtar Këshillues Kërkim - Shpëtimit) dhe t'i prezantohen Drejtuesit Qendror të Operacionit, nëpërmjet UNDAC-ut ose DPPEC.

Vlerësimi i Nevojave: Emergjencat e Shkallës së Ulët

Bashkërendimi për vlerësimin e nevojave për ngjarje apo emergjenca të shkallës së ulët, është nën përgjegjësinë e Prefektit të Qarkut të prekur nga emergjenca, si dhe nga drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore të cilat mund të mbështeten nga DPPEC, dega e KKSH ose grupe të përbashkëta.

Vlerësimi i Nevojave: Emergjenca të Shkallës së Lartë

Bashkërendimi për vlerësimin e Nevojave është nën përgjegjësinë e KNEC, nëpërmjet Grupeve të Përbashkëta të Vlerësimit. Grupet e Përbashkëta të Vlerësimit mbështeten drejtpërsëdrejti nga DPPEC dhe nga grupe specialistësh nga ministrinë e linjës, institucionet, qarqet e pa prekura nga emergjenca dhe institutet duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit (MBU), Ministrinë e Mjedisit (MMj), Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit (MRRTT), Ministrinë e Transporteve dhe Telekomunikacioneve (MTT), MM, MRP, MIE, nga personel tjetër shtesë duke përfshirë Prefektin, Punonjësit e Emergjencave Civile, Punonjësit e Komunave dhe Bashkive dhe personelin e KKSH në Zyrat Qendrore dhe Degët e saj.

Grupet e përbashkëta të vlerësimit

Grupet e vlerësimit, drejtohen nga specialistë të institucioneve përkatëse në varësi të natyrës së emergjencës. Specialistët mund të jenë nga MSH, MBU, MIE, MMj, MRRTT, MM, ose të MPVD, apo nga një institut i specializuar në varësi të tyre.

Vlerësimi i dëmeve (në aspektin e dëmtimeve të infrastrukturës dhe objekteve të ndërtimit)

Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturë dhe objektet e banimit për emergjencat e shkallës së ulët, bëhet nga Administrata e Prefektit e mbështetur nga DPPEC dhe për emergjencat e shkallës së lartë nga Grupet e përbashkëta të vlerësimit. Mbështetja teknike kryesore sigurohet nga specialistët dhe institucione më të specializuara në lidhje me dëmet, duke përfshirë: Entin Kombëtar të Banesave (EKB), Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve (DPRR), Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave, Aviacionit, Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve (DPUK), Drejtorinë e Përgjithshme të Elektroenergjitikës, Institutin e Teknologjisë së Ndërtimit, Institutin e Sizmiologjisë (IS), Institutin e Transporteve, Institutin e Studimit të Tokave, specialistët e institute private etj.

Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (QKOEK)

QKOEK është qendra kryesore për menaxhimin e informacionit. Ajo mbledh, përpunon, analizon dhe shpërndan informacionin për përballimin e emergjencës. Mbështetja dhe informacioni për QKOEK-në sigurohet nga të gjitha ministrinë të linjës, institucionet, autoritetet lokale dhe publiku i gjerë. Informacioni në lidhje me të gjitha aspektet e asistencës ndërkombëtare duhet t'i jepet menjëherë QKOEK-së.

Sigurimi i informacionit për Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile

Është përgjegjësi e të gjitha ministrive të linjës, institucioneve, strukturave, autoriteteve lokale përkatëse dhe subjekteve të sektorit privat dhe (kur është e nevojshme) edhe e publikut të gjerë, të sigurojë informacionin të vazhdueshëm nga terreni për QKOEK-në. Kjo mundëson DPPEC bërjen e propozimeve të drejta për Ministrinë e MPVD dhe KNEC. Kjo përgjegjësi përfshin sigurimin e informacionit teknik dhe shkencor në lidhje me kushtet dhe situatën hidrologjike, sizmike, meteorologjike dhe të mjedisit. Informacioni vjen në QKOEK-në gjithashtu nga Prefekti, KPPECQ, DOQ, KVEC në nivel Komune dhe Bashkie dhe Drejtuesit e tyre të Operacioneve dhe nëse është formuar, nga Grupi i Përbashkët i Vlerësimit të dëmeve dhe nevojave.

Ekipi i Menaxhimit të Emergjencës (Task Force)

Me shpalljen e gjëndjes së emergjencës civile pranë QKOEC mblidhet Ekipi i Menaxhimit të Emergjencave Civile (EMEC) i cili sipas situatës dhe llojit të emergjencave, përbëhet nga përfaqësues të Ministrive të linjes dhe institucioneve qendrore të cilët organizohen në seksionet përkatëse të përkrahura në seksionin 2.1.8. Pranë këtij ekipi mund të punojnë, ndihmojnë dhe përfaqësues të KKS, Organizmave Ndërkombëtare dhe të OJF-ve. Ky ekip përgatit tërë procesin e marrjes së vendimeve nga DQO dhe KNEC.

Njoftimi i hershem, ai i parë, informimi dhe këshillimi i publikut

Përgjegjësia kryesore për informimin e popullsisë, në varësi të shpejtësisë dhe shkallës së emergjencës, është e drejtuesve të organeve të pushtetit vendor Komunave dhe Bashkive, Prefektit dhe SEC, si dhe e FO në terren. Përgjegjësia për njoftimin e parë në nivel kombëtar për ngjarje të shkallës së lartë është e MPVD. Njoftimi, informimi dhe këshillimi i publikut bëhet kryesisht nga Radio-Televizioni Publik Shqiptar, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Media Private (elektronike dhe e shkruar), sistemi shkollor, vullnetarët e KKS, organizatat e Shoqërisë Civile, si dhe mjete e burime të tjera.

Lehtësirat/pajisjet e transportit të emergjencës duke përfshirë transportimin gjatë emergjencës të njerëzve, evakuimin, grupeve të Kërkim-Shpëtimit, artikujve të ndihmës, depozitave të ujit dhe naftës

Kërkesat për transport në kohë emergjence dhe kapacitetet e disponuara bashkërendohen në nivel kombëtar nga DQO. MTT, ka rrolin drejtues në sigurimin e mjeteve të transportit, qofshin këto në varësi të drejtorive vartëse të saj, të MM, DPRSH, sektorit privat etj. Në nivel lokal, punonjësit e emergjencave civile mbajnë inventare të kapaciteteve të disponuara duke përfshirë dhe ato të sektorit privat. Një përmbledhje e kapaciteteve kombëtare është bashkëngjitur në kapitullin 6.14.

Lehtësirat e Transportit Ndërkombëtar për Emergjencat (Ajri dhe Deti)

Aktivitetet në përgjigje të emergjencës të cilat kërkojnë përdorimin e lehtësirave portuale dhe aeroportuale bashkërendohen nga DQO. Drejtorja e Përgjithshme e Aviacionit Civil dhe Drejtorja e Përgjithshme e Transportit Detar, sigurojnë mbështetje teknike të menjëhershme dhe direkte. Mbështetje gjithashtu sigurohet dhe nga MPJ, MM, MRP (PSH), Ministria e Financave (MF) (Dogana) dhe të kontraktuarit nga sektori privat. Një përmbledhje e funksioneve të secilës ministri dhe institucion në lidhje me menaxhimin e emergjencave civile është listuar në Shtojcën B.

Hyrja për në zonat e prekura nga emergjenca

Bashkërendimi i aktiviteteve për hyrjen në zonat e prekura nga emergjenca sigurohet nga Drejtori i DPPEC ose DQO dhe strukturat përgjegjëse për emergjencat civile në nivel qarku dhe vendor. Hapja dhe pastrimi i rrugëve nacionale dhe hekurudhave është përgjegjësi e DPRR dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave. Këto mund të kërkojnë mbështetje nga kapacitetet e Drejtorive të Rrugëve Rurale pranë Këshillave të Qarqeve, nga MM, MIE, MRRTT, MBU dhe të kontraktuarit nga sektori privat, të cilët disponojnë pajisje për këtë qëllim. Në rastet kur në zonat e prekura nga emergjenca ka rrugë rurale, urbane ose komunale të bllokuara, përgjegjësinë për zhbllokimin e tyre e kanë autoritetet që i kanë në inventarin e tyre dhe në rast nevojë mbështeten nga strukturat si dhe në rastin e rrugëve nacionale.

Në të dy rastet, kur ato nuk mund t'i përballojnë me kapacitetet e tyre teknike zhbllokimin e rrugëve, atëherë i drejtohen për ndihmë Drejtorit të DPPEC ose DQO.

Kontrolli i kufijve në kohë emergjence

Përgjegjësia për kontrollin, zbatimin e rregullave doganore për Emigracionin dhe Kontrollin e Kufijve, janë të strukturave përkatëse dhe kryesisht, MRP (Drejtorja e Refugjatëve dhe Emigracionit, Drejtorja e Policisë Kufitare) MF (Dogana) dhe MPJ (marrëdhëniet ndërkombëtare) aktiviteti I të cilave bazohet dhe në konventat ose marrveshjet ndërkombëtare. Me shpalljen e gjëndjes së emergjencave civile përgjegjësinë për koordinimin e strukturave të mesipërme e ka KNEC.

Shërbimi shëndetësor parësor

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të urgjencës dhe Shërbimit Shëndetësor Parësor; për rrethin e Tiranës nëpërmjet Autoritetit Shëndetësor Rajonal dhe në pjesën tjetër të vendit, nëpërmjet Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe dhe 598 Qendrave Shëndetësore të cilat janë funksionale. Kërkesat dhe nevojat koordinohen nga DQO.

Shërbimi shëndetësor dytësor dhe tretësor

Shërbimi Shëndetësor Dytësor dhe Tretësor është në përgjegjësinë e MSH, Drejtorja Spitalore. Në nivel kombëtar dhe në nivel qarku ky shërbim rrealizohet nëpërmjet 3 spitaleve universitare, 11 Spitaleve Rajonal, 23 spitaleve në rrethe ose bashki, 8 spitaleve në zonat rurale, 4 njësi të specializuara dhe 29 bankave të gjakut.

Kapacitetet shtesë sigurohen nga MM, nëpërmjet Spitalit Fushor të BMC, ndihma ndërkombëtare dhe subjektet private. Kërkesat dhe nevojat koordinohen nga DQO. Një liste me kapacitetet e mundshme është në seksionin 6.14.

Menaxhimi i të dëmtuarve/viktimave në masë

Në kuptimin e këtij plani, menaxhimi i viktimave dhe të dëmtuarve në masë, konsiderohet një numër më i madh të dëmtuarish dhe viktimash se sa mundësitë e sistemit shëndetësor të përballojë në kohë normale.

Menaxhimi i Viktimave dhe të Dëmtuarve në Masë në momentet e para drejtohet nga strukturat e para reaguese, të cilat janë zakonisht forcat operacionale më të afërta në vendin e ngjarjes. Në varësi të vendit, Triazhi dhe Ndihma e Parë bëhet nga struktura të Shërbimit Shëndetësor të MSH, të mbështetura nga MM, PSH, (MASH)(Fakulteti i Mjeksisë), PMNZSH, KKS dhe vullnetarëve të kualifikuar nga sektori privat.

Evakuimi i të dëmtuarve për në shërbimin dytësor dhe tretësor është përgjegjësi e MSH, SHU në nivel kombëtar, dhe organeve të qeverisjes vendore në nivel lokal. Kapacitetet përforcohen dhe nga MRP, forcat speciale "DELTA", Forcat Specializuara të MM nëpërmjet grupeve të shpëtimit në det, ajër, evakuimit, urgjencës, dhe KKSH. Për identifikimin dhe menaxhimin e viktimave në masë përgjigjen Pushteti vendor, Strukturat e Policisë dhe MRRTT.

Sigurimi i Shërbimit të Shëndetit Publik:

MSH dhe Instituti i Shëndetit Publik në varësi të saj, kanë përgjegjësinë për monitorimin e cilësisë të ujit të pijshëm dhe higjienës, si dhe për Programin e Zgjeruar të Vaksinimit dhe sistemin përkatës monitorues të situatës epidemiologjike, mbështetur dhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh). Këto kapacitete përforcohen dhe mbështeten nga MRRTT, DPUK dhe specialistë të qarqeve e të strukturave të organeve të pushtetit vendor të të njëjtit profil. Gjithashtu ndihmesë mund të jape dhe KKSh.

Sigurimi dhe rivendosja në funksionim e shërbimeve jetike komunale.

Sigurimi i burimeve alternative me ujë duke përfshirë furnizimin me autobote dhe të ambalazhuar dhe riparimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm është përgjegjësi e MRRTT, e cila e realizon nëpërmjet strukturave të saj, ndërmarrjeve në nivel lokal, bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor dhe të kontraktuarit që kryejnë këto shërbime, mbështetur dhe nga MM.

Sigurimi i burimeve alternative të energjisë dhe riparimet e sistemit të furnizimit me energji elektrike janë përgjegjësi e MIE, Drejtorisë së Përgjithshme të Elektroenergjitikës, e cila e realizon nëpërmjet aktivizimit të grupeve të përgjigjes së menjëhershme (Grupi i eliminimit të avarive të Divizionit të pare) të KESH-it për prodhimin dhe transmetimin e energjisë, bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor dhe të kontraktuarit që kryejnë këto shërbime, mbështetur nga MM.

Sektori privat "Shoqëritë e Tregëtimit të Karburanteve dhe Gazit" kanë përgjegjësi të ngjashme për stacionet në pronësi të tyre, për masat e sigurisë dhe të furnizimit me gaz.

MBU, ka përgjegjësinë për sigurimin dhe shpërndarjen e lëndës drusore për ngrohje mbështetur për transport nga MTT dhe DPRSH.

Evakuimi i popullsisë civile:

Në situata emergjente dhe kur nuk është shpallur gjëndja e emergjencës civile me propozim të MPVD, urdhëri për evakuim në nivel kombëtar jepet nga Kryeministri dhe operacioni drejtohet nga Drejtori i DPPEC. Në raste kur është shpallur gjëndja e emergjencës civile urdhëri jepet nga KNEC dhe operacioni drejtohet nga DQO.

Në nivel qarku, përgjegjësia për evakuimin është e Prefektit, në nivel vendor e kryetarit të komunës/bashkise. Gjatë situatave të emergjencës, forcat operacionale në terren (FA, PSH, Stacionet e PMNZSH-se etj) mund të vendosin evakuimin e menjëhershëm për territore të kufizuara. Në varësi të situatës, rol të rëndësishëm luajnë forcat operacionale, strukturat vepruese aktive të MM, MRP, MTT, Kontraktorët e Sektorit Privat, KKSH.

Në fazën e evakuimit një rëndësi të veçantë merr informimi publik për rrezikun dhe masat që duhen marrë për të lëvizur në zona të sigurta.

Sigurimi i digave, pritave, kanaleve, lumenjve, liqeneve etj:

Përgjegjësia për kontrollin, mirëmbajtjen, sigurinë dhe riparimin e Digave e dambave, Pritave, Kanaleve, Lumenjve dhe Liqeneve etj, është e ndarë nëpër institucione si vijon:

- MRRTT, Sekretariati Teknik i Komitetit Shtetëror të Ujit (basenet ujëmbledhës duke përfshirë liqenet, lumenjtë dhe pritë në lumenj) Sekretariati Shtetëror Teknik i Komitetit të Digave të Larta (digat, rezervuarët).
- MIE, KESH-it (digat e hidrocentraleve).
- MBU, Drejtoria e Menaxhimit të Ujrave (pritat bujqësore, stacionet e pompimit, sistemet e kanalizimeve primare dhe rezervuarët), nëpërmjet drejtorive rajonale dhe kontraktoreve.

Mbështetja teknike sigurohet nga:

- MMj (Drejtorja e Parandalimit të Ndotjes, Sistemi i Lajmërimit dhe Agjensitë Rajonale të Mjedisit në 12 qarqe). Ndhmë shtesë sigurohet nga Prefektët e qarqeve, të cilët funksionojnë 6 Komitete të Baseneve Ujëmbledhës dhe nga organizmat përgjegjës për sistemet e kanalizimeve dytësore dhe tretësore në nivel lokal në bashkëpunim me MBU dhe autoritetet vendore.
- Mbështetje me mjete dhe pajisje të rënda, nëse është e nevojshme, sigurohet nga MM, MB, sektori privat.
- Shoqata e fermerëve Përdorues të Ujit.
- Kontraktorët shfrytëzues të burime ujore dhe rezervuareve.

Identifikimi dhe sigurimi i strehimeve të përkohëshme.

Caktimi i objekteve dhe rajoneve për sigurimin i vendstrehimeve të përkohshme të sigurta drejtohet nga autoritetet e bashkive dhe komunave, Prefektët dhe Keshillat e Qarqeve, të mbështetur nga Drejtori i DPPEC / DQO në nivel kombëtar. Ndhmë jepet nga Ministritë dhe strukturat që kanë kapacitete në ndërtesa apo terrene për vendstrehime të përkohshme, ku përfshihen: Ministria e Kultures Rinise dhe Sporteve (MKRS), MASH, MM, MPVD (DPRSH), Ministria e Drejtësisë (MD) (evakuimi dhe strehimi i personave të paraburgosur dhe të burgosur) dhe KKSH.

Menaxhimi i artikujve të ndihmës emergjente nga burime të brëndshme

Bashkërendimi për sigurimin, furnizimin, magazinimin dhe shpërndarjen e artikujve të ndihmës kombëtare, bëhet nga DQO/DPPEC.

- Sigurimi dhe furnizimi me artikuj të ndihmës bëhet nga: MBU, Ministria e Ekonomisë (ME), MM, MPVD (DPRSH), MSH, dhe KKSJ.
- Shpërndarja e ndihmës bashkërendohet nga DQO/DPPEC në nivel kombëtar dhe në nivel lokal nga qarku dhe organet e pushtetit vendor, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e MSH (për ndihmën në ilaçe), strukturat e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (MPCS) vullnetarët e KKSJ dhe kontraktore.

Menaxhimi i artikujve të ndihmës emergjente nga burime nderkombëtare

Kërkesa dhe procedurat për sigurimin dhe pranimin e Asitencës së Ndihmës Ndërkombëtare, pritjes, magazinimit bëhet nga KNEC me mbështetjen e DQO/DPPEC.

- Transporti dhe shpërndarja e artikujve të ndihmës në nivel kombëtar bashkërendohet nga DQO dhe në nivel lokal nga autoritetet e qarkut dhe organet e pushtetit vendor, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e MSH (për ndihmën në ilaçe), strukturat e MPCS, vullnetarët e KKSJ në nivel kombëtar dhe lokal dhe kontraktorët.
- Artikujt e ndihmës ndërkombëtare duhet të sigurohen dhe merren në bazë të rregullave të përshkruara në seksionet 6.10 dhe 6.11 në përputhje dhe me planet e tjera të organizmave ndërkombëtare siç është PGKB për Shqipërinë.

Telekomunikacioni i Emergjencës.

MTT ka rolin e përgjithshëm bashkërendues në telekomunikacion për emergjencat, duke u mbështetur në ndihmën e strukturave të pajisura me rrjete telekomunikimi.

Këto përfshijnë:

- DPPEC (rrjetin e QKOEC-së).
- MM (Qendrën e Bashkuar Operacionale të Ministrisë së Mbrojtjes “QBOMM”, rrjetet e radiove dhe telefonike me njësitë ushtarake).
- MRP (rrjetin e Qendrës së Informacionit dhe të Evakuimit në Ministrinë e Rendit Publik “QIEMRP”, njësitë e radiove dhe telefonike, rrjetin me qendrat operacionale në Komisaritet e Policisë).
- MF (rrjeti i radiokomunikimit i doganave dhe i policisë financiare).
- MBU (rrjeti radiokomunikimit i policisë pyjore)
- KKSJ (rrjetin e radiove, Ëave- mail dhe njësitë levizëse).

Ndihmë shtesë sigurohet nga Agjencia e Frekuencave, Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit, Drejtoritë Kombëtare të Telekomunikacionit, ALBTELECOM dhe kompanitë e komunikimit nga sektori privat.

Shërbimet e Ndihmës Sociale.

MPCS merr rolin bashkërendues në lidhje me çështjet e ndihmës sociale. Për vlerësimin e nevojave, identifikimin e më të prekurve dhe hartimin e zbatimit e asistencës sociale të nevojshme, ajo punon ngushtë me prefektët dhe organet e pushtetit vendor. Në punën e saj ajo asistohet nga DPPEC, Zyra Qendrore dhe Degët e KKSJ dhe OJF.

Ruajtja e Sigurisë dhe Rendit Publik.

- Për situata të jashtëzakonshme problemet e sigurisë drejtohen nga Presidenti i Republikës keshilluar nga Këshilli Kombëtar i Sigurisë dhe mbështeten nga MRP (PSH), MM, Sherbimi Informativ Kombëtar dhe autoritetet në nivel qarku, komune dhe bashkie.
- Në fatkeqesi të medha: përgjegjësia e përgjithshme është KNEC, nepermjet MRP (PSH) dhe ndihmuese MM si dhe autoritetet në nivel qarku, komune dhe bashkie, nepermjet strukturave të tyre policore.

Partnerët ndërkombëtar, donatorët.

Para shpalljes së gjendjes së emergjencës, kërkesa për ndihmë dhe ndihma e donatoreve brenda vendit, drejtohet nga MPVD.

Pas shpalljes së gjendjes së emergjencave civile KNEC përparësi dhe drejton apel për ndihme nderkombëtare procedurat e të cilit ndiqen nga MPJ, në përputhje me konventat përkatëse ndërkombëtare dhe marrëveshjet bilaterale të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare.

KNEC përcakton mënyrat për përdorimin e burimeve materiale sipas kërkesave të paraqitura nga DPPEC/DQO.

Kërkesa për ndihme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kërkesa për aktivizimin e kapaciteteve kombëtare në nivel qendror drejtohet nga MPVD dhe në nivel qarku nga Prefekti i qarkut.

Për ndihmën Ndërkombëtare rolin koordinues e ka KNEC, mbështetur nga DQO/DPPEC. Ndjekja e procedurave të apeli bëhet nga MPJ, bazuar në kërkesat e KNEC.

Mbështetja financiare e emergjencës në të gjitha nivelet shtetërore.

Fondet Rezerve për emergjencë mund të aktivizohen duke përdorur burimet në vijim:

- Fondin e Emergjencave Civile në Buxhetin e Komunave, Bashkive dhe Qarqeve.
- Fondin e Emergjencës në Buxhetin e MPVD.

- Rialokimin e buxheteve të Ministrive të Linjës.
- Fondin Rezervë të Këshillit të Ministrave.

Roli drejtues për mbështetjen financiare në emergjencat e shkallës së lartë merret nga Këshilli i Ministrave me kërkesë të KNEC-së. Mbështetje dhe këshilla jepen nga MPVD, MF dhe ministri të tjera përkatëse në varësi të natyrës së emergjencës civile.

6.7 Shpërndarja dhe transmetimi i Informacionit Publik

Informimi i publikut është element thelbësor i njoftimit të hershëm, parapërgatitjes dhe këshillimit të komunitetit. Informimi i publikut mund të luajë rol të rëndësishëm në shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre në raste emergjencash civile. Qartësia, korrektësia dhe shpejtësia e dhënies së informacionit është mjaft e rëndësishme në raste të emergjencave civile, e cila sigurohet në nivel qendror nëpërmjet njoftimeve periodike të QKOEK-së (sektorit të informacionit) dhe njëkohësisht nga autoritetet e drejtimit të operacioneve në nivele të ndryshme.

6.8 Asistenca Ndërkombëtare

Kërkesa për asistencë ndërkombëtare për përballimin e emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë bëhet vetëm në rastet kur vlerësohet se dëmet dhe nevojat nuk mund të përballohen nëpërmjet burimeve dhe kapaciteteve kombëtare. Apeli për ndihmë nga vendet e huaja ose organizmat ndërkombëtarë jashtë vendi drejtohet nga KNEC-ja dhe procedurat ndiqen nga MPJ-ja. Asistenca ndërkombëtare mund të kërkohet ose të ofrohet, si kontribut financiar, donacion në natyrë (artikuj ushqimorë dhe industrialë, barna dhe pajisje mjekësore etj.), ose si shërbime të veçanta (grupe kërkim-shpëtimi, grupe të menaxhimit të logjistikës etj.). KNEC-ja dhe DQO-ja, të mbështetura nga DPPEC-ja, përcaktojnë kërkesat për asistencën ndërkombëtare.

KNEC-ja siguron agjencitë donatore për mënyrën e përdorimit të asistencës së akorduar dhe hartimin e raporteve të kërkuara në bazë të termave dhe kushteve bashkëngjitur asistencës së dhënë.

Gjithashtu, në vend mund të vijë papritmas edhe ndihmë e pakërkuar, e cila duhet menaxhuar në mënyrë korrekte, në po të njëjtën mënyrë si edhe ndihma e kërkuar, në rast se është e nevojshme.

“Refuzimi” i ndihmës kombëtare dhe ndërkombëtare bëhet nga KNEC/MPVD-ja, këshilluar nga DQO/DPPEC-ja në rastet kur është e panevojshme ose kur me kapacitetet që disponohen, janë në gjendje për të përballuar situatën e krijuar.

Bashkërendimi efektiv i ndihmës ndërkombëtare është ngarkesë shumë e madhe për sistemin kombëtar të përgjigjes për përballimin e situatës së emergjencës. Ndihmë në këtë proces bashkërendues mund të kërkohet nga grupet e vlerësimit të emergjencave të Kombeve të Bashkuara (UNDAC), me qendër në Gjenevë. UNDAC-u mund të aktivizojë një grup me menaxherë me përvojë për emergjencat, të cilët vendosen në gatishmëri dhe, nëse është e nevojshme, vijnë brenda 24 orëve në Shqipëri. Roli i UNDAC-ut është të japë ndihmë dhe të mbështetë agjencinë e menaxhimit të emergjencave civile të një vendi për bashkërendimin e aktiviteteve të grupeve të kërkim-shpëtimimit dhe të menaxhimit të asistencës ndërkombëtare. Kërkesa për një grup të UNDAC-ut mund të bëhet nëpërmjet përfaqësuesit vendës të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

6.9 Doganat, emigracioni dhe karantina

Në rast se është drejtuar apel për ndihmë ndërkombëtare, shërbimet doganore dhe ato kufitare shqiptare duhet të njoftohen dhe të këshillohen menjëherë. Lehtësimi i procedurave të hyrjes së personelit të ndihmës në territorin shqiptar përbën një nga përparësitë e domosdoshme. Në veçanti, hyrja e shpejtë me procedura të lehtësuara e grupeve të kërkim-shpëtimimit, e pajisjeve të

tyre të shpëtimit dhe e qenve të kërkimit duhet të përbëjë përparësi. Përveç kësaj, sistemi i taksave dhe heqja e disa tarifave doganore duhet të aplikohen për të gjithë ndihmën e vendosur me shenjë “ Ndhimë humanitare” ose e marrë ”Për qëllim lehtësimin e fatkeqësisë”.

DQO/ekipi i menaxhimit të emergjencave është përgjegjës për sigurimin e informacionit në lidhje me ndihmën ndërkombëtare në pritje për trajtimin në dogana dhe kalimin e kufirit, për të bërë të mundur lehtësimin e këtij procesi. Informacioni do të përmbajë sa më shumë detaje që të jetë e mundur, për llojin, sasinë, burimin, mjetet/mënyrat e transportit, pikat e hyrjes dhe kohën e mundshme të arritjes. Në rast se nga Shqipëria është kërkuar ardhja dhe ka mbërritur grupi i UNDAC-ut, duhet të jepet ndihmë shtesë në këtë fushë.

Në rast emergjence në vendet fqinjë mund të kemi një dyndje të shpërngulurish nga trojet e tyre, për këtë arsye shërbimi doganor, kufitar, i karantinës dhe i emigracionit (nëse lejohen për të hyrë) duhet të jenë të përgatitur për të pritur/përcjellë njerëzit dhe gjënë e gjallë të tyre në territorin shqiptar.

6.10 Çështjet financiare

Situatat e EC-së sjellin edhe ndërlikime financiare afatgjata e afatshkurtra, të cilat duhet të zgjidhen në mënyrë që një përgjigje të konsiderohet efektive. Për këtë arsye, kostot e mundshme duhet të planifikohen paraprakisht me kujdes në të gjitha nivelet. Problemet financiare të fazës së përgjigjes mund të renditen si vijon:

- *Problemet e menjëhershme financiare:*

Në mënyrë që të kenë pavarësi në veprime, të gjitha strukturat të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrime për situatat e emergjencave civile, duhet të jenë në gjendje të veprojnë menjëherë dhe në çdo kohë. Është absolutisht e nevojshme që strukturat të kenë mundësi për të siguruar kesh (monedha) të mjaftueshme për të ndërmarrë vlerësimin dhe përgjigjen e parë. Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta dhe kostot e komunikimit që parashikohen të nevojshme, të jenë të disponueshme dhe të bëhen paraprakisht të përdorshme nga të gjitha strukturat e përfshira në emergjencat civile, në mënyrë që të lejojnë personelin e tyre të lëvizë në rajonin e prekur dhe të fillojë menjëherë punë.

- *Problemet financiare dytësore:*

Ndërkohë që situata e emergjencës civile zhvillohet, problemet financiare rriten dhe bëhen afatgjata. Këto përfshijnë kostot për orët shtesë të personelit, kostot për sigurimin dhe vënien në funksionim të pajisjeve të specializuara dhe të mjeteve të transportit, si dhe kostot për sigurimin e vendstrehimeve të sigurta apo asistencën mjekësore dhe atë humanitare në përgjithësi, për ata që janë prekur nga situata e emergjencës civile. Këto shpenzime të konsiderueshme do të përbëjnë probleme afatgjata buxhetore dhe duhet të planifikohen nëpërmjet projekteve, preventivave, planeve dhe të vlerësohen së bashku nga niveli qendror e lokal.

- *Problemet financiare tretësore:*

Si shtesë e kostove, në përgjigje të nevojave për situatën e emergjencës civile, edhe pse ende në fazën e përgjigjes, fillojnë të dalin në pah ndërlikimet financiare tretësore. Në më të shumtën e rasteve këto janë të lidhura me përpjekjet për stabilizimin e situatës para fillimit të fazës së rikthimit në gjendjen normale. Këto mund të përfshijnë kostot për riparimin e ndërtesave të dëmtuara apo të infrastrukturës, rikonstruksionin e shërbimeve bazë, si: të ujit të pijshëm, të energjisë elektrike dhe sigurimin e strehimeve të sigurta për një periudhë afatgjatë për ata të cilët mund të mos jenë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre.

Gjatë fazës së përgjigjes, masat në vijim duhet të jenë planifikuar paraprakisht dhe të jenë të aplikueshme për të gjitha strukturat dhe shërbimet e përfshira në zgjidhjen e çështjeve të emergjencave civile:

- Mbajtja e një rezerve të mjaftueshme në kesh për t'u përdorur për vlerësimet e menjëhershme të situatës dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj situatës emergjente.
- Në të gjitha strukturat përgjegjëse duhet të ekzistojnë plane dhe marrëveshje në mënyrë që të

mbulojnë automatikisht kostot për marrjen e mjeteve të transportit, shoferëve dhe karburantit, për të mundësuar vlerësimet e menjëhershme të situatës dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj situatës emergjente.

- Duhet të ekzistojnë lehtësira, në mënyrë që personeli i emergjencave civile të jetë në gjendje të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve, për të mbuluar shpenzimet e bëra në fazën e parë të përgjigjes së menjëhershme.
- Kontrata të lidhura paraprakisht ose marrëveshje duhet të jenë bërë që në kohë të qetë dhe të vihen në veprim në kohën e emergjencave civile. Këto marrëveshje bëjnë të mundur lejimin e shërbimeve, si për shembull, atë të makinerive të rënda që të kërkohen urgjentisht tek kontraktorët dhe pagesa të bëhet në një fazë të mëvonshme, siç parashikohet në marrëveshje.
- Është e nevojshme të parashikohen kostot e mundshme të përgjigjes ndaj emergjencës civile, duke marrë për bazë përvojat e kaluara dhe stërvitjet simuluese dhe të përfshihen në planifikimet e buxhetit të strukturave dhe të shërbimeve të interesuara, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Duke u bazuar në këto vlerësime, një përqindje e buxhetit vjetor duhet të veçohet për përgjigjen ndaj emergjencave civile për secilën nga strukturat apo shërbimet e interesuara. Akses i shpejtë/ i lehtësuar në këto burime financiare buxhetore duhet të garantohet nëpërmjet procedurave të brendshme, duke krijuar mekanizma lehtësues të çeljes së fondit të emergjencës, për përdorimin në mënyrë sa më fleksibël në kohë emergjence.

6.11 Raportimet dhe vlerësimet

Raportimet për situatën merren nga institucionet dhe strukturat e ndryshme dhe, për t'u njësuar, në mënyrë që ato të pasqyrojnë të gjithë informacionin që kërkohet, formularët standardë të raporteve për situatën, dëmet dhe nevojat janë paraqitur në manualët që ka publikuar MPVD-ja, si:

- Formulari i njoftimit të parë.
- Raporti i të dhënave të para për fatkeqësinë.
- Raporti i situatës për organizmat ndërkombëtarë.
- Kërkesë për ministritë e linjës në rast emergjence.

Formularët e vlerësimit të menjëhershëm të nevojave dhe dëmeve që jepen në manualët e emergjencave civile, janë mjete praktike, nëpërmjet të cilave merret informacion për nevojat e menjëhershme dhe dëmet e shkaktuara, për plotësimin e të cilit duhet të kontribuojnë në mënyrë aktive të gjitha autoritetet përkatëse. Formulari i raportit të të dhënave të para për fatkeqësinë duhet të përgatitet nga grupet e përbashkëta të vlerësimit. Sidoqoftë, para kësaj, çdo kontribut i mundshëm i mëparshëm i prefektit dhe i autoriteteve të komunës dhe të bashkisë, duke përdorur të njëjtin format, është i mjaft i rëndësishëm. Në situata të tejskajshme, mund të bëhen ndërhyrje të menjëhershme paraprake (si: evakuim në masë i popullsisë, operacione kërkim-shpëtimi, dhënie e ndihmës mjekësore dhe aktivitete të tjera parësore) përpara ose gjatë bërjes së vlerësimit të nevojave.

Vlerësime të tjera pasuese do të bëhen duke përdorur të njëjtën metodologji dhe mënyrë pune, por më të detajuar në bazë të informacioneve të grumbulluara.

6.12 Burimet dhe kapacitetet kombëtare për Përgjigjen në rastet e Emergjencave Civile

Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera shtetërore zotërojnë kapacitete të ndryshme, të cilat duhet të vihen në eficiencë nëse ndodh një emergjencë civile. Më poshtë paraqitet një listë e detajuar pikërisht me këto kapacitete, të cilat mund edhe të plotësohen nga të tjera burime, qofshin këto shtetërore apo private, në nivel kombëtar apo lokal. Planet e emergjencave në qarqe, komuna dhe bashki, i paraqesin këto kapacitete në mënyrë më të detajuar dhe konkrete me të dhënat e fundit.

Në vijim është lista me kapacitetet më të rëndësishme kombëtare:

INSTITUCIONI	SPECIALITETI	KAPACITETI
<i>Ekipe apo grupet speciale për fazën e përgjigjes ndaj Emergjencave Civile</i>		
Baza e Mbrojtjes Civile Ministria e Mbrojtjes-Tiranë.	Per kërkim-shpëtimin për tërmetet.	2 grupe
	Per kërkim-shpëtimin për përmytjet.	2 grupe
	Per kërkim-shpëtimin për zjarret.	2 grupe
	Për ndotjet kimike.	2 grupe
	Për kërkim-shpëtimin për terrene malore.	2 grupe
	Për hapjen e rrugëve nga bora dhe rrëshqitjet e dherave.	3 grupe
Shërbimi i kërkim-shpëtimin i Forcave Ajrore Ministria e Mbrojtjes-Tiranë	Shërbimi kombëtar i kërkim-shpëtimin për transportin ajror.	56 persona dhe 7 helikoptere. 2 AB-205 dhe 5 AB-206 me një kapacitet transportues 30 veta
Batalioni i Operacioneve Speciale FLD Ministria e Mbrojtjes-Tiranë	Për kërkim-shpëtimin për aksidentet detare dhe ajrore.	1 grup
	Kërkim- shpëtim në det dhe ujrat e brendshme	6 motovedeta 2 polumbare
Batalioni i mbrojtjes kunder-kimike, bakteorologjike dhe nukleare. Ministria e Mbrojtjes Tiranë	Për shpëtimin në raste të mundëshme të fatkeqësive kimike, bakteorologjike dhe nukleare.	1 grup prej 25 specialistësh.
Spitali Ushtarak. Ministria e Mbrojtjes -Tiranë	Për urgjencë kirurgjikale (secili i përbërë nga një kirurg, një traumatolog, një reanimator dhe tre ndihmësa të tyre)	2 grupe
	Për sëmundjet infektive (përbërë nga një infeksionist, një epideomologist, një higjenist dhe dy ndihmësa).	1 grup
Brigada e Reagimit të Shpejtë Regjimenti Komando Ministria e Mbrojtjes Tiranë	Për kërkim-shpëtim jo të specializuar.	200 persona
	Per kërkim-shpëtim jo të specializuar.	200 persona
Instituti i Fizikes Berthamore.	Për zbulimin e radioaktivitetit.	2 grupe
<i>Shërbime teknike të specializuara</i>		
Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.	Inspektoriati i ushqimit në të gjithë vendin.	114 Specialiste
Ministria e Industrisë dhe e Energjitikës.	Për sigurinë e mjedisit.	2 Specialiste
	Për Inspektim në miniera.	52 Specialiste
	Për rehabilitim dhe mbrojtje mjedisi.	55 Specialiste
	Për përgjigjen në raste të emergjencave në furnizimin me energji elektrike.	60 Specialiste (KESH)
	Për inspektimin e karburanteve.	22 Specialiste
Spitali Ushtarak, Tiranë (MM)	Për Laborator kimik të specializuar.	20 Specialiste
<i>Kapacitete transporti dhe pajisesh speciale</i>		
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit.	Kapacitete transporti hekurudhor.	25 lokomotiva, 64vagona pasagjerësh, 220 vagona mallrash.
Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit.	Transport uji.	6 autobote
	Transport mbeturinash (fekalesh).	5 autobote
	Për saldim dhe prerje.	5 mjete
	Për levizje dherash.	1 copë fadrome

Baza e Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes Tiranë.	Për transportues (për njerëz).	16 kamiona (gjithsejt 469 persona).
	Për transportues (për mallra).	27 kamiona (gjithsejt 134 t)
	Për transport inertesh, mallrash.	2 copë me 32 t secili.
	Për transport inertesh, mallrash (vetëshkarkues).	8 copë (gjithsejt 100 t).
	Për levizje, shtyrje, materialesh, dherash në distancë të shkurtër.	5 copë (gjithësejt 250 m ³) dhe 6 buldozera me zinxhirë (gjithsejt 200 m ³).
	Për pastrimin e rrugeve nga debora.	3 copë
	Moto-barka	6 copë gjithsej 80 persona 14 copë për mallra
	Për MNZ.	2 copë
	Për prodhim energji elektrike.	8 copë, gjithsej 396 kw
	Për de-gazim.	1 copë
	Për saldimit dhe prerje.	3 copë
Brigada e Xhenios, Ministria e Mbrojtjes Tiranë	Për ndertim riparime etj.	50 specialiste
	Transport materialesh (vetëshkarkues).	5 copë
	Për ngarkim materialesh, lëvizje dherash.	8 copë eskavatorë. 5 copë buldozerë me zinxhira.
	Për ngarkim shkarkim.	1 copë me kapacitet 15 Ton.
Brigada e Reagimit të Shpejtë Ministria e Mbrojtjes Tiranë.	Për transport njerzish/ mallrash.	8 copë
Batalioni i mbrojtjes k/kimike, bakteorologjike dhe nukleare, Ministria e Mbrojtjes Tiranë.	Për degazim.	6 automjete
Rezervat e Shtetit, MPV&D	Transport materialesh	20 kamione nga 10 ton secili.
Kryqi i Kuq Shqiptar	Transport.	4 kamione me tonazh të lartë, makina të lehta në 12 deget në qarqe.
Shërbime ndihme		
Baza e Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes Tiranë.	Për operacione të ndryshme.	170 persona
	Për trajtim shëndetësor.	1 spital fushor me 50 shtretër, 4 dhoma trajtimi.
	Për furnizim me ujë të pijshëm.	7 autobote (gjithsejt 67 mt) dhe 11 pompa (kapaciteti gjithsejt 12 m ³ /orë).
	Për pastrim uji.	2 copë (gjithsej 6.000 L /orë).
	Për prodhim buke.	2 copë (gjithsejt 2,400 kg/ditë).
	Për gatim ushqimi.	12 guzhina fushore (gjithsejt 3,000 racione /ditore) dhe 1 automjet-guzhinë me kapacitet 300 racione në ditë
	Për strehim masiv.	Çadra për 17,000 persona.
	Për higjenë personale	2 dushe fushore (gjithsejt 200 persona/ditë)
Ministria e Shëndetësisë	Transport me Helikopter	2 helikopter
	Per nderhyrje kirurgjikale	2 - 3 grupe
	Per transport me autoambulance (Tirana)	6 autoambulanca dhe personel shoqerues
	Per shtrime ne rast emergjence	50% e kapaciteteve te QU "Nene Tereza"

PMNZSH	Per fikjen e zjarrit	80 mjete zjarrfikese
	Per ngjitje ne lartesi	6 autoskalla
	Per kerkim shpetim	2 mjete shpetimi
	Per transport te demtuarish	2 autoambulanca
	Personel zjarrfikes	670 persona
Rezervat e Shtetit, MPV&D.	Për strehim të përkohshëm në objekte të perhershme	28. 000 m ² per rreth 6000 njerëz
	Çadra	Për 30. 000 persona
	Hapsira për magazinime për materiale të ngurta.	43 .000 m ²
	Hapsira për magazinime karburante.	14 000 ton
Kryqi i Kuq Shqiptar.	Racione Ushqimore	Për 8 000 persona, për 1 muaj
	Mbeshtetje per strehim të përkohshem.	Për 2 000 persona.
	Mundësi për kontakte familjare.	Nëpërmjet shërbimit dhe sistemit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq Nderkombetar.

7. RIKTHIMI NË GJENDJEN NORMALE

7.1 Hyrje dhe përkufizimet

Faza e katërt dhe e fundit e ciklit të emergjencave, përshkruar në PKEC, është ajo e rikthimit në gjendjen normale.

Në kuptimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile:

Rikthimi në gjendjen normale përkufizohet, si: Tërësia e të gjitha masave për të siguruar që jeta dhe prona e komunitetit të prekur të rivendoset në të njëjtin nivel si edhe përpara situatës së emergjencës civile.

Çështjet e rikthimit në gjendjen normale trajtohen në ligjin nr. 8756, datë 26 mars 2001, në të cilin kjo fazë cilësohet me termin “riaftësim” dhe nënkupton masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme të rajonit (territorit) të prekur nga fatkeqësia.

Megjithëse faza e rikthimit në gjendjen normale vjen pas fazës së përgjigjes, ajo është gjithashtu e lidhur ngushtë me fazën tjetër të ciklit të emergjencave, parandalimin dhe lehtësimin dhe, në këtë mënyrë mbyllet cikli i menaxhimit të emergjencave.

Faza e rikthimit në gjendjen normale është zakonisht koha për të promovuar veprimet e lehtësimit, për të kërkuar në mënyrë aktive mbështetjen për aktivitetet e këtij procesi në të ardhmen, sepse kujtesa e pasojave të emergjencës është ende e freskët për të gjithë komunitetin e prekur dhe strukturat e përfshira.

Rikthimi në gjendjen normale është, gjithashtu, edhe një kohë për të vlerësuar efektivitetin e planeve të emergjencave/gatishmërisë dhe të veprimeve të ndërmarra në kuadër të përgjigjes. Si rezultat, një pjesë përbërëse e fazës së rikthimit në gjendjen normale është rishikimi i situatës së emergjencës civile i cili përshkruhet në mënyrë të plotë në seksionin 8.

Ndërkohë që rikthimi në gjendjen normale fillon nga çasti i deklarimit të përfundimit të situatës së emergjencës civile, mund të duhen ditë, muaj ose vite për të realizuar rikthimin e plotë në normalitet. Ka raste negative kur rikthimi i plotë në gjendjen normale nuk mund të bëhet kurrë, si rezultat i humbjes së jetëve të njerëzve, gjësë së gjallë ose kur objektet e banimit dhe infrastruktura e shkatërruar nuk mund të ndërtohen më. Për këtë arsye, çështjet e rikthimit në gjendjen normale kanë nevojë për angazhime afatshkurtra dhe afatgjata zhvillimi.

7.2 Rolet dhe përgjegjësitë

Faza e rikthimit në gjendjen normale rrjedh drejtpërdrejt nga faza e përgjigjes që përkon me etapën 4: “dalja nga situata e emergjencës”. Si rezultat, rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të përfshira mbeten të njëjta me ato të dhëna me hollësi në seksionin 6.6, për aq kohë sa të ndërmerren dhe të realizohen detyra të tjera nga institucionet dhe strukturat përkatëse. Gjatë fazës së përgjigjes, grupe të specializuara bëjnë vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave jo vetëm të atyre imediate, jetësore, por edhe të nevojave për t’u kthyer në normalitet. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për të përgatitur projekte dhe plane riaftësimi dhe zhvillimi. Duke e konsideruar fazën e rikthimit në gjendjen normale, si mundësi që planet, projektet dhe investimet të jenë perspektive, ka të ngjarë të arrihet ridimensionimi i masave mbrojtëse në zonën e dëmtuar. Kjo nënkupton që infrastruktura, masat mbrojtëse dhe parandaluese të zhvillohen dhe të rikonceptohen në mënyrë të tillë, që në rast përsëritjeje të një emergjence me të njëjtët parametra, të mos shkaktojnë të njëjtat dëme në të ardhmen.

Për këtë arsye, të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet për drejtimet që ato mbulojnë, janë përgjegjëse dhe kanë detyra në këtë fazë.

7.3 Bashkërendimi dhe informacioni

Faza e rikthimit në gjendjen normale fillon menjëherë pas deklarimit të përfundimit të situatës së emergjencës civile dhe në varësi të faktorëve të sigurisë. Me fillimin e kësaj faze, publiku dhe strukturat e prekura orvaten të kthehen sa ma parë në situatën e tyre normale. Vlerësimet dhe informacionet për fillimin e fazës së rikthimit në normalitet jepen nga MPVD-ja në nivel qendror, nga prefekti në nivel qarku dhe nga drejtuesit e njësive vendore në nivel komune dhe bashkie.

Seksionet e mëposhtme evidentojnë çështjet parësore, që duhet të trajtohen nëpërmjet një bashkërendimi efektiv dhe rrjedhjes së informacionit në planin afatshkurtër dhe afatgjatë të rikthimit në gjendjen normale.

7.4 Largimi ose zvogëlimi i rreziqeve direkte

Vlerësimi teknik dhe informacioni i saktë është i domosdoshëm për t'u siguruar që rreziku i ardhur si rezultat i shfaqjes së dukurive që shkaktuan situatën e emergjencës civile, nuk është më evident ose intensiteti i tij është zvogëluar deri në nivele të pranueshme dhe të sigurta. Gjithashtu, vlerësimi dhe informacioni janë me rëndësi të veçantë për konstatimin se nuk ka tregues të kthimit të menjëhershëm në nivelet e intensitetit të mëparshëm të rrezikut. Në varësi të dukurisë së mundshme të rrezikut në fjalë, strukturat monitoruese, si IS dhe IH etj., luajnë role të rëndësishme në vlerësimin e rreziqeve, për të bërë analizën, për të mbajtur dhe për të ruajtur lidhjet e tyre me institucionet rajonale shkencore etj.

Këto informacione duhet të plotësohen dhe të krahasohen nga vëzhgimet dhe të dhënat e mbledhura e të analizuar nga strukturat e emergjencave civile në zonat e prekura.

Këtu përfshihet informacion rreth:

- Nivelit të ujërave në lumenj, kanale dhe në zonën e përmbytur.
- Treguesve për reshjet dhe prurjet.
- Shpejtësisë së erës lokale/llojeve dhe drejtimit.
- Ndryshimeve lokale të temperaturës.
- Monitorimit të objekteve dhe të terreneve të cilat përbëjnë rrezik potencial etj.

7.5 Stabilizimi i pasojave që vijnë nga burime dytësore rreziku

Stabilizimi i dukurive dytësore të rrezikut të mundshëm është thelbësor për të siguruar rikthimin në gjendjen normale. Vlerësimet e veçanta teknike si dhe konsultat janë të nevojshme për t'u bërë nga strukturat që kanë ekspertizë dhe kompetenca të veçanta, për të arritur rezultate në vlerësimin e dukurive dytësore të rrezikut.

Strukturat e specializuara përfshijnë:

- MBU-në (pyjet dhe kullotat, menaxhimin e ujit dhe sistemin e kanalizimeve, kontrollin e ushqimeve, bimëve dhe zooveterinare).
- MTT-në (rrugët, hekurudhat, aviacionin civil, transportin detar dhe telekomunikacionin).
- MSH-në (kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalor, Institutin e Shëndetit Publik, shërbimin farmaceutik etj.).
- MRP-në (sektorin e informacionit dhe të evakuimeve, policinë kufitare dhe policinë rrugore, forcat e ndërhyrjes së shpejtë).
- MMj-në (inspektoratin e mjedisit dhe Institutin e Mjedisit).
- MIE-në (sektorin e minierave, të industrisë, të elektroenergjetikës, të hidrokarbureve etj.).
- MRRTT-në (sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Digave të Larta, Sekretariatit Kombëtar Teknik të Ujit, policinë e ndërtimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, Institutin e Teknologjisë së Ndërtimit).
- MASH-in (Fakultetin e Shkencave Inxhinierike).

- ASH-në (institutet e Hidrometeorologjisë, të Sizmologjisë, të Fizikës Bërthamore).

Kur rreziku i dukurive dytësore të mundshme vlerësohet se është ulur, atëherë mund të ndërmerren procedura për kthimin e sigurt dhe të rregullt të popullsisë në zonat e prekura, megjithëse masat shpesh të mëposhtme do të duhet të ndërmerren përpara deklarimeve publike, për të udhëzuar popullsinë për kohën e kthimit në vendbanimet e tyre.

7.6 Proçedurat për kthimin e sigurt dhe aktivitetin normal

Bashkërendimi i aktiviteteve të autoriteteve të emergjencave civile në nivel qarku, komune dhe bashkie, të ndihmuara dhe të mbështetura nga DPPEC-ja, kërkon ndërmarrjen e një sërë veprimesh në mënyrë që popullsisë t'i kthehet siguria për rifillimin e aktiviteteve normale. Këto veprime janë:

- *Kontrollet e parametrave të sigurisë.* Përpara kthimit të popullsisë në zonën e prekur nga fatkeqësia, ndërmerren veprime për kontrollin e çdo pjese të kësaj zone. Këtu përfshihen kontrollet e: rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm, rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, zonave me çarje tektonike, sistemeve të tubacioneve dhe të kanaleve të ujërave të zeza, gjendjes së materialeve të rrezikshme, nivelit dhe shpejtësisë së rrjedhjes së ujërave, vatrave dhe burimeve të rrezikshme e të mundshme zjarri dhe çështje të tjera të lidhura me sigurinë.
- *Hyrje-dalje të sigurta.* Kjo nënkupton garantimin e hyrjeve dhe të daljeve të sigurta për qytetarët në zonat e prekura. Këtu përfshihet; rrethimi, bllokimi dhe vendosja e sinjaleve lajmëruese në drejtimet dhe zonat e rrezikshme dhe klasifikimi i qëndrueshmërisë së ndërtesave të prekura.
- *Sigurimi i zonave të sigurta për kthimin e popullsisë.* Sa më shpejt të jetë e mundur duhet të bëhet largimi në kohë i mbeturinave, i materialeve të rrezikshme ose të dëmshme, zhbllokimi i rrugëve si dhe heqja e çdo materiali që mund të bëhet shkak për lindjen e një rreziku dytësor ose të një dukurie tjetër rreziku.
- *Sigurimi i strehimeve provizore.* Sigurimi i strehimeve të përkohshme, të sigurta (mundësisht disa alternativa) për ata që nuk janë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre brenda një periudhe të shkurtër.
- *Informimi publik.* Shpërndarja e udhëzimeve të qarta për publikun në lidhje me kthimin në vendbanimet e përhershme, duke përfshirë edhe udhëzime specifike për grupet e popullsisë të cilat cilësohen si parësore. Dhënia e udhëzimeve për zonat dhe rrugët e kthimit dhe, nëse është e mundur, për mënyrat e kthimit.
- *Informacion paralajmërues.* Shpërndarja e paralajmërimeve institucionale për publikun, duke përfshirë informacionin rreth rreziqeve të shkallës së vogël që mbeten ende evidente, për instalimet e riparuar, pengesat në rrugë, praninë e materialeve të rrezikshme, rrezikun nga rrjedhjet e ujërave, burimet dhe rreziqet e mundshme nga zjarri dhe çështje të tjera të sigurisë.
- *Shëndeti publik.* Dhënia e këshillave të nevojshme për publikun në lidhje me çështjet e shëndetit, burimet dhe cilësinë e ujit të pijshëm, gatishmërinë e ndërtesave të shërbimit shëndetësor parësor etj.
- *Grupet më të prekshme/të cenueshme.* Dhënia e ndihmës për grupet më të prekshme, p.sh., për të moshuarit, familjet me një prind ose familjet e mëdha, njerëzit me aftësi të kufizuara, në nevojë ose ata që janë larg shtëpisë ose familjes së tyre.
- *Shërbimet publike.* Ndërgjegjësimi për informimin publik, ndihmën, vendet e regjistrimit dhe të shpërndarjes së ndihmës, informacionin në lidhje me ndihmën humanitare.
- *Lidhjet familjare.* Sigurimi i informacionit për të mbështetur autoritetet vendore dhe KSSH-në në lidhje me gjetjen e personave që mungojnë dhe rivendosja e lidhjeve familjare.

7.7 Rivendosja e shërbimeve publike bazë

Është përgjegjësi e strukturave shtetërore në nivel kombëtar dhe lokal, të cilat, duke u bazuar në vlerësimin e dëmeve, të ndërmarrë gjatë fazës së përgjigjes, të sigurojnë rivendosjen e plotë të të gjitha shërbimeve kryesore publike.

Kjo kërkon kthimin sa më të shpejtë në funksionim të:

- furnizimit me ujë nëpërmjet rrjetit, depove të ujit, pajisjeve të trajtimit, pastrimit dhe tubacioneve të shpërndarjes së ujit të pijshëm;
- furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e thjeshtë dhe industrialë;
- rivendosjes së telekomunikimit.
- lëvizjes së lirë në magjistralet kryesore.

7.8 Strukturat e dëmtuara dhe të shkatërruara

Pajisjet dhe strukturat ndërtimore, infrastrukturore të shkatërruara, si dhe ato të dëmtuara, që janë përtej mundësive për t'u riparuar menjëherë, janë sfida të pashmangshme në fazën e rikthimit në gjendjen normale. Kjo do të thotë që një pjesë e popullsisë nuk do të mund t'u kthehet menjëherë kushteve normale të jetës ose punës. Zonat mjedisore të shkatërruara paraqesin kufizime për kthimin në normalitet. Këtu mund të përmendim zonat e shkatërruara nga zjarret ose tokat bujqësore të përfshira nga përmytjet apo të mbushura me aluvione. Niveli i ulët i sigurimit të banesave pranë institucioneve përkatës, nënkupton që, pas ndodhjes së një emergjence civile, si rezultat i së cilës dëmtohen një numër i madh banesash, banorët e dëmtuar janë në varësi vetëm të asistencës shtetërore ose të asaj humanitare.

Për rikthimin në gjendjen normale, krahas bashkërendimit të përgjithshëm të ndërmarrë nga punonjësit e emergjencave civile ose persona të tjerë të caktuar për menaxhimin e situatës në nivele të ndryshme, kërkohet marrja e masave si më poshtë:

- *Këshillimi*. Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe këshilla për banorët që e kanë të pamundur kthimin në shtëpitë apo në zonat e tyre të banimit.
- *Strehimi*. Sigurimi i burimeve të nevojshme për strehimin e menjëhershëm dhe në vazhdimësi të popullsisë, derisa të gjendet një strehim i përhershëm.
- *Asistenca*. Sigurimi i asistencës së vazhdueshme derisa banorët, grupet apo komuniteti i prekur të jenë në gjendje të fitojnë një masë sigurie dhe besimi në vetvete.
- *Rindërtimi*. Sigurimi i të gjitha hapësirave të mundshme për gjetjen e materialeve të ndërtimit dhe të shërbimeve, atje ku rindërtimi ose ndërtimi i pjesshëm është i mundur.
- *Shembja*. Sigurimi i kushteve të tilla që ndërtesat e dëmtuara apo pjesërisht të shkatërruara që përbëjnë rrezik, të mund të bëhen të sigurta apo të shemben fare, nëse është e nevojshme.
- *Zhvendosja*. Atje ku kthimi nuk është i mundur të sigurohet, dhënia e të gjitha mjeteve të mundshme për të zhvendosur banorët në një vendbanim më të përshtatshëm, të sigurt, nga të njëjtat shkaqe rreziku ose rreziqe që mund të shkaktojnë emergjencë civile të ngjashme me to.
- *Kompensimi*. Sigurimi i kushteve të barabarta për qytetarët, grupet apo komunitetin e prekur, për të ndihmuar dhe për të bërë të mundur përfaqësimin me efektivitet gjatë kërkesave të tyre për ndihmë humanitare apo kompensime nga shteti, nëse një gjë e tillë aplikohet.

8. RISHIKIMI DHE VLERËSIMI

8.1 Hyrje

Për qëllimet e PKEC-së, rishikimi është parë si analizë e brendshme e veprimeve të marra menjëherë pas një emergjence civile dhe gjatë menaxhimit të saj. Qëllimi dhe objektivi i një rishikimi është të mbledhë së bashku të gjitha informacionet dhe vlerësimet përkatëse dhe prej tyre të nxjerrë në pah aspektet pozitive dhe negative të veprimeve të strukturave në mënyrë që të bëhen përmirësimet që nevojiten për të fuqizuar masat për emergjencat civile në të ardhmen.

Vlerësimi ka qëllime dhe objektiva të ngjashëm me rishikimin, por është më i detajuar dhe mund të trajtojë një aspekt specifik të funksioneve të emergjencave civile, si për shembull, bashkërendimin dhe mund të ndërmerret nga vlerësues ekspertë profesionistë të jashtëm (që nuk kanë qenë të përfshirë në menaxhimin e situatës) dhe që punojnë sipas termave të veçantë reference.

8.2 Përmbledhje e shkurtër mbi momentet kryesore të operacionit

Përmbledhja e shkurtër për momentet kryesore të operacionit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur pas një situatë emergjente. Është e rëndësishme të shkëmbehen pikëpamje kur detajet e ngjarjes dhe të përgjigjes janë ende të freskëta dhe të gjithë protagonistët janë në të njëjtin pozicion. Është përgjegjësia e DPPEC-së të organizojë dhe të bëjë një përmbledhje të shkurtër të operacionit pas një ngjarjeje emergjence dhe të nxjerrë përfundime mbi të. Përfundimet e kësaj përmbledhjeje do të formojnë bazën e një rishikimi ose vlerësimi pas fatkeqësisë. Përmbledhja e bërë mbi operacionin duhet të jetë e hapur dhe të përfshijë:

- Diskutimin dhe analizën e procedurave operacionale në DPPEC, duke përfshirë dhe QKOEK-në.
- Rishikimin e procedurave të komunikimit, efektivitetin dhe shpejtësinë e përgjigjes në bashkëpunim me aktorë të tjerë dhe përfaqësues të strukturave të emergjencave civile në nivel kombëtar, nivel qarku, komune dhe bashkie.
- Vlerësimin e ndikimit të masave të ndërmarra gjatë përgjigjes dhe komunikimit me institucione dhe struktura të tjera të emergjencave civile.
- Identifikimin e mangësive të burimeve dhe të kapaciteteve dhe evidentimin e çështjeve me përparësi, në mënyrë që ato të trajtohen përpara se të ndodhë një situatë tjetër emergjence.
- Evidentimin e arritjeve të deritanishme dhe përmirësimet që mund të bëhen në fazën e bashkërendimit, të komunikimit dhe të përgjigjes.
- Dokumentimin dhe publikimin e përfundimeve tek të gjitha strukturat e përfshira.

8.3 Rishikimi

DPPEC, KPPECQ, KVPPEC dhe komisionet e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile në ministritë e linjës janë përgjegjës për të bërë rishikimin e plotë të veprimeve të planizuara dhe të realizuara në fund të çdo situatë emergjence civile serioze. Rishikimi duhet të përfshijë kontributet e të gjithë protagonistëve duke përfshirë popullsinë e prekur dhe organizatat e ndryshme aktive dhe të interesuara. Aspekt i rëndësishëm i rishikimit është të parashikojë në mënyrë të saktë veprimet që duhen ndërmarrë për t'u realizuar në të ardhmen. Rishikimi mund të nxjerrë probleme të qarta si duhet vepruar dhe hapat që duhet të ndërmerren nga strukturat përkatëse për të parandaluar dhe për të lehtësuar pasojat në ngjarje të tilla në të ardhmen dhe për të përmirësuar fazën e përgatitjes dhe të mbrojtjes.

Rishikimi mund të ndjekë një format të përshtatshëm për raportim, të jetë sa më i kuptueshëm dhe të marrë parasysh këto çështje:

- Planet e parandalimit dhe të lehtësimit përpara ngjarjes. Ndikimin dhe përshtatshmërinë e çdo

- mase parandaluese dhe lehtësuese që është ndërmarrë.
- Efektivitetin e planeve të parapërgatitjes, të mbrojtjes dhe të përgjigjes gjatë ngjarjes.
- Efektivitetin e procedurave të komunikimit.
- Veprimet dhe efektivitetin e aktivizimit të Sistemit Kombëtar (seksioni 6).
- Efektivitetin e procedurave të njoftimit të hershëm dhe të informimit publik.
- Efektivitetin e masave për bashkërendimin e strukturave të emergjencave civile në nivel kombëtar dhe lokal, duke përfshirë marrjen dhe analizimin e informacionit, vendimmarrjen, dhënien dhe shpërndarjen e informacionit me strukturat/institucionet e interesuara dhe publikun e gjerë.
- Kryerjen efektive të roleve dhe të përgjegjësi të identifikuara nga strukturat përkatëse (seksioni 6).
- Mbledhjen efektive të kapaciteteve lokale dhe përdorimin e tyre gjatë fazës së përgjigjes.
- Rrjedhën e informacionit dhe efektivitetin e bashkërendimit në nivel kombëtar apo/dhe lokal.
- Shpejtësinë dhe efektivitetin e operacioneve të përgjigjes për: kërkim-shpëtim, menaxhimin e viktimave në masë, evakuimin, sigurimin e akteve rrugore të sigurta, pastrimin e rrugëve dhe transportin, sigurimin e shërbimeve publike bazë.
- Efektivitetin e veprimeve për dhënien e ndihmës shëndetësore në rastet e emergjencave civile, për vendstrehimet e përkohshme të sigurta, asistencën ushqimore dhe joushqimore.
- Efektivitetin e veprimeve në sigurimin dhe marrjen e asistencës ndërkombëtare dhe marrëdhëniet me organizmat ndërkombëtarë.
- Ndikimin dhe vlerësimin e programeve të trajnimit në forcimin e kapaciteteve të përgjigjes ndaj emergjencës.
- Vlerësimet dhe informacionin si dhe sigurimin e burimeve për rikthimin në gjendje normale.
- Faktorë të tjerë shtesë, të ardhur si rezultat i situatës së emergjencës civile.
- Prezantimin e rishikimit të planit të veprimeve në KTKSEC.

8.4 Vlerësimi

Vlerësimi i jashtëm ose i brendshëm duhet të marrë parasysh të njëjtat çështje si dhe rishikimi i brendshëm, por mund të kërkohet që vlerësimi të japë një analizë më të hollësishme të ndërmarrë nga vlerësues, të specializuar në fushën e planifikimit të emergjencave, por që, domosdoshmërisht, të mos kenë qenë drejtpërdrejt të përfshirë në operacionet e përgjigjes konkrete që po vlerësohet. Grupi i vlerësimit do të punojë sipas termave të veçantë të referencës së miratuar dhe do t'u raportojë instancave përkatëse të cilat kanë nisur vlerësimin.

8.5 Faza vijuese

Çështjet ose rekomandimet mbi të cilat është rënë dakord gjatë rishikimit, vlerësimit të një situatë emergjente, ndiqen në vazhdimësi nga DPPEC-ja dhe strukturat e tjera të Sistemit Kombëtar të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, nëpërmjet hapave në vazhdim:

- Shtesa apo ndryshime, rishikime ose përgjithësime të PKEC-së si dhe në planet e emergjencave/gatishmërisë së niveleve të ndryshme.
- Shtesa apo ndryshime për masat ekzistuese dhe masat e reja që do të përfshihen në:
 - o parandalim dhe lehtësim,
 - o parapërgatitje dhe mbrojtje,
 - o përgjigje,
 - o rikthim në gjendjen normale.
- Ndryshime në strukturën e forcave operacionale të sistemit të emergjencave civile.
- Rishikim i çështjeve të veçanta brenda sistemit të menaxhimit të emergjencave civile, si për shembull: njoftimi i hershëm (paralajmërimi), ndërgjegjësimi publik, rolet dhe përgjegjësitë parësore, mekanizmat e bashkërendimit, lidhjet me mekanizmat e përgjigjes ndërkombëtare dhe aktivitetet trajnuese.
- Faktorë të veçantë për t'u përfshirë në planet e zhvillimit në nivel kombëtar dhe lokal, duke përfshirë dhe ata faktorë që kanë mbështetjen ndërkombëtare.

9. PERGATITJA E STRUKTURAVE/TRAJNIMI

9.1 Parathënie

Trajnimet, stërvitjet e ndryshme janë aspekte mjaft të rëndësishme për ngritjen dhe për forcimin e SSHKEC-së. Këto aktivitete janë të domosdoshme për të përpunuar në mënyrë efektive të katër fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave, sidomos në lidhje me aktivitetet më kritike të zhvilluara si para, ashtu edhe pas ndodhjes së emergjencës. Aktivitetet e trajnimit/stërvitjet bëjnë të mundur që parapërgatitja, lehtësimi, përgjigja dhe aktivitetet e rikthimit në gjendjen normale të jenë sa më eficiente. Niveli i njohurive dhe kapacitetet që zotërohen vazhdimisht kanë nevojë të testohen dhe të forcohen nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, për të arritur maksimumin e njohurive dhe mundësive për përballimin e situatave reale të emergjencave.

Studimet për vlerësimin e rreziqeve në Shqipëri, për vlerësimin e prekshmërisë dhe kapaciteteve në nivel lokal si dhe PKEC-ja janë të lidhura ngushtë me strategjinë kombëtare të trajnimit për emergjencat civile. Strategjia e trajnimit do të vazhdojë të zhvillohet dhe të plotësohet duke marrë për bazë si përvojat reale, ashtu edhe nevojat e strukturave të emergjencave, të dhëna këto që identifikohen nga vetë sistemi i shërbimit kombëtar të emergjencave civile. Nga ana tjetër, strategjia e trajnimeve do të vazhdojë në mënyrë progresive të ndikojë në forcimin e SSHKEC-së, njëkohësisht, do të shërbejë si mjet mjaft i rëndësishëm për përmirësimin e planeve të emergjencave në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

9.2 Qëllimi i programit të trajnimit për Emergjencat Civile

Trajnimi ka si qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare, rajonale, lokale dhe institucionale, për një menaxhim sa më efektiv të situatave emergjente. Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet zbatimit të kurrikulës kombëtare të trajnimit dhe të aktiviteteve mbështetëse, të zhvilluara nga MPVD-ja, e cila pasqyron nevojat, strukturat dhe realitetin shqiptar. Aktivitetet e kurrikulës së trajnimit do të përmirësohen dhe do të përshtaten në mënyrë të vazhdueshme, si dhe do të përfshihen në strategjinë kombëtare të trajnimeve për emergjencat civile.

9.3 Zhvillimet në fushën e trajnimeve

9.3.1 Zhvillimet aktuale të Fushës të Trajnimit

MPVD-ja, në përputhje me ligjin nr. 8756 “Për emergjencat civile”(neni 8.2(e, f)): “Përpunon dhe koordinon programet e arsimit dhe të trajnimit në fushën e mbrojtjes civile”.

Në përmbushje të kësaj detyre, është hartuar dhe është vënë në zbatim “Kurrikula kombëtare e trajnimit për emergjencat civile”, baza teorike e së cilës përbëhet nga tetë manuale.

Manualet e trajnimit janë:

- “Bazat e menaxhimit të fatkeqësive në Shqipëri” (që përfshin edhe “Fjalorin e termave të fushës së emergjencave”).
- “Planifikimi për përballimin e emergjencave”.
- “Parapërgatitja në nivel lokal për përballimin e emergjencave”.
- “Vlerësimi i dëmeve dhe i nevojave, shkaktuar nga emergjencat”.
- “Bashkërendimi i operacioneve për përballimin e emergjencave”.
- “Logjistika dhe shpërndarja e ndihmave”.
- “Udhëzuesi për trajnerët e menaxhimit të emergjencave”.
- “Udhëzuesi për parapërgatitjen për emergjencat”.

Tetë manualët janë hartuar nëpërmjet një procesi të gjatë dhe të plotë konsultimesh me shumë institucione në Shqipëri dhe janë testuar e përmirësuar nëpërmjet një numri të madh aktivitetesh trajnimi. Manualët përmbajnë standarde dhe udhëzime kombëtare dhe ndërkombëtare të emergjencave civile dhe pasqyrojnë gjerësisht përvojën dhe rastet studimore nga realiteti shqiptar.

Nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit të trajnerëve, Shqipëria tashmë ka grupin e vet të specializuar të trajnerëve të menaxhimit të emergjencave. Ata janë aftësuar dhe kanë kapacitete për përgatitjen dhe organizimin e aktiviteteve të trajnimit për grupe të caktuara në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Në seksionin 10, “Masat për zbatimin e PKEC-së”, janë dhënë disa nga përparësitë e strukturave të SHKEC-së në fushën e trajnimeve.

9.3.2 Strategjia e Trajnimit në të ardhmen/perspektiva

Me gjithë progresin e bërë deri më sot në forcimin e kapaciteteve të strukturave të emergjencave civile në vend, mbetet ende mjaft punë për t'u bërë në të ardhmen. PKEC-ja është pika referuese për fillimin e etapës së dytë të zhvillimeve në fushën e trajnimit, atë të pasurimit të strategjisë kombëtare të trajnimit për emergjencat civile. Kjo strategji do të bëjë të mundur institucionalizimin dhe standardizimin e menaxhimit të emergjencave civile në vend. Ajo do të udhëheqë, gjithashtu, zhvillimet drejt forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve, të stafit, të forcave operacionale dhe të planifikim-bashkërendimit në përgjithësi, duke mundësuar përgjigjen më efektive ndaj emergjencave në të ardhmen.

Përparësitë aktuale në fushën e trajnimit janë:

- Krijimi i Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për Mbrojtjen Civile.
- Investimet në fushën e trajnimit duhet të vendosen ndër përparësitë e politikave dhe të buxhetit të MPVD-së.
- Institucionalizimi i kurrikulës së trajnimit për emergjencat civile.
- Testimi dhe përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme të kurrikulës në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duke përdorur mjetet dhe metodat e duhura.
- Zhvillimi i mëtejshëm i strategjisë së trajnimeve për emergjencat civile nga MPVD-ja nëpërmjet përgatitjes së planeve vjetore të trajnimit, të cilat duhet të freskohen me informacion periodik, duke u bazuar në: përparësitë, nevojat e grupeve përfutuese të trajnimit dhe zhvillimet rajonale.
- Të gjitha strukturat (qeveritare dhe joqeveritare) e lidhura me menaxhimin e emergjencave, të marrin në konsideratë kurrikulën e trajnimit të emergjencave civile dhe të trajnohen si pjesë përbërëse e sistemit kombëtar të emergjencave civile në Shqipëri. Trajnimi është vendimtar për fazën e përgatitjes para ndodhjes së situatave të emergjencës dhe do të jetë një nga kërkesat kryesore për promovimin e profesionalizmit të personelit operacional dhe të menaxhimit të emergjencave civile në vend.
- Stafi i përfshirë në aktivitetet e menaxhimit të emergjencave (me detyra planifikuese dhe operacionale), duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe vullnetarët, do të aftësohet nëpërmjet kurseve të trajnimit për emergjencat civile. Trajnimi duhet të promovojë aplikimin e kriterëve standarde në fushën e operacioneve dhe të ketë si qëllim përafrimin me standardet e BE-së.
- Duhet të organizohen aktivitete të përbashkëta trajnimi me të gjitha strukturat shtetërore dhe joshetërore përkatëse të të gjitha niveleve, duke përfshirë edhe aktivitete me partnerët në vendet e Europës Juglindore dhe Qendrore.

9.4 Planet e emergjencave dhe testimi i tyre

Testimi më efektiv i PKEC-së, i planeve të gatishmërisë dhe të emergjencave në nivele të ndryshme bëhet gjatë situatave reale të emergjencave civile, megjithatë, kjo nuk nënkupton faktin që këto plane nuk mund të testohen në situatë të qetë. Testimi përdoret si mjet i vlerësimit të efektivitetit dhe zbatueshmërisë të seksioneve të veçanta të një plani ose të planit në përgjithësi. Objektivi kryesor i testimit, i rishikimit dhe i vlerësimit është mbledhja e të gjithë informacionit të nevojshëm rreth aspekteve negative dhe pozitive të veprimeve të kryera dhe masat për përmirësimin e trajnimit

të çështjeve të caktuara të menaxhimit të emergjencave civile në të ardhmen. Testimi, rishikimi dhe vlerësimi, në pjesën më të madhe të rasteve, bëhet nëpërmjet trajnimeve dhe stërvitjeve. Vlerësimi i aspekteve të veçanta të funksioneve, si për shembull, i çështjeve të bashkërendimit, mund të bëjë të mundur zgjidhjet dhe përmirësimet në të ardhmen, të cilat do të ndikojnë në rritjen e efektivitetit në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave.

Në varësi të ndryshimeve dhe kërkesave të realitetit, testimi dhe vlerësimi i planeve të emergjencave civile do të bëhet me këto mënyra:

- Testimi dhe vlerësimi i elementeve të veçanta të planeve të emergjencave. Për shembull, testimi i fazës së përgjigjes mund të bëhet për çështje të bashkërendimit të aktiviteteve dhe të përcaktimit të përgjegjësive për të gjithë protagonistët.
- Testimi i planeve të emergjencave civile, bazuar në rreziqet e mundshme nga të cilat Shqipëria është e prekshme, si për shembull, tërmetet apo përmytjet.

Trajnimet dhe stërvitjet konsiderohen si mjete ndihmëse dhe të domosdoshme për testimin e të gjitha fazave të ciklit të menaxhimit të emergjencave dhe të planeve të emergjencave në të gjitha nivelet, duke përfshirë dhe planet sektoriale të institucioneve të specializuara.

9.5 Metodologjia e trajnimit dhe grupet përfituese

Metodologjia e trajnimit përzgjidhet në bazë të një sërë faktorësh, si: situata reale, niveli i audiencës, nevojat e komunitetit në zonat me rrezik të lartë, çështjet përparësore të emergjencave civile, të cilat mund të zhvillohen nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- seancave teorike,
- seancave plenare,
- punës me grupe,
- stërvitjeve në tryezë,
- stërvitjeve simuluese;
- stërvitjeve në terren me pjesëmarrjen e forcave operacionale dhe të komunitetit.

Grupet përfituese të këtyre aktiviteteve përfshijnë: forcat operacionale dhe personelin e planifikimit dhe të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të gjithë personelin e institucioneve shtetërore dhe të organizatave të shoqërisë civile të lidhur me çështjet e emergjencave civile.

9.6 Stërvitjet në tryezë dhe stërvitjet në terren

9.6.1 Stërvitjet në Tryezë

Stërvitja në tryezë është një ushtrim i thjeshtë, i cili kërkon përgatitje dhe shpenzime minimale. Është aktivitet i mirë për trajnimin e stafeve të të gjitha niveleve, si operacional, ashtu edhe vendmimarrës, në fusha të caktuara, si për shembull, në bashkërendim, ndarjen e përgjegjësive, përparësitë e lehtësimit pas situatës së emergjencës dhe çështje të tjera të ngjashme.

Stërvitja në tryezë zbatohet në një mjedis ku lejohen gabimet, pra jo në terren dhe vërejtjet dhe korrigjimet bëhen më lehtë. Qëllimi i saj është të nxjerrë në pah problemet ekzistuese në bashkërendim, të zhvillojë fantazinë për zgjidhjen e skenarëve të ndryshëm, shpërndarjen e detyrave dhe të përgjegjësive specifike, identifikimin e problemeve në zbatimin e procedurave të cilat paraqiten më pas si nevojë për trajnime për rishikimin e planeve konkrete dhe përgatitjen e stërvitjeve të tjera në tryezë ose në terren.

9.6.2 Stërvitje në terren me pjesëmarrjen e forcave operacionale dhe të komunitetit

Stërvitjet në shkallë të gjerë janë niveli më i lartë i stërvitjeve dhe shkalla më e lartë e një programi të përgjithshëm trajnimi. Kjo kërkon planifikimin më të mirë, burime dhe kapacitete më të shumta si

dhe kohë e vullnet për ta përgatitur dhe për ta zhvilluar. Në këto stërvitje bëhet testimi i planeve të miratuara si dhe i elementeve bazë organizative në një situatë pothuajse pranë asaj reale dhe në një mjedis tejet të rënduar. Mobilizimi fizik dhe lëvizja e personelit dhe e kapaciteteve janë të nevojshme për të demonstruar aftësitë e bashkërendimit, të përgjigjes dhe të rikthimit në normalitet pas situatës së emergjencës.

10. MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË EMERGJENCAVE CIVILE

PKEC-ja prezanton një tjetër hap domethënës në zhvillimin e SKSHEC-së në Shqipëri.

Masat e planifikuara për ndjekjen e zbatimit të planit kombëtar do të sigurojnë rrugën për ngritjen e nivelit të bashkërendimit, investimet në sistemin e emergjencave civile dhe do të kontribuojnë në parandalimin dhe reduktimin e rreziqeve në vend. Hapat për ndjekjen dhe zbatimin e planit nuk mund të shikohen përgjithmonë të vetmuara. Ato janë pjesë e një fushe të gjerë përgjegjësish të cilat janë identifikuar si “Përparësi të sistemit të shërbimit të emergjencave civile në Shqipëri”.

Këto përparësi janë pikat kyçe për ta bërë sistemin e menaxhimit të emergjencave në Shqipëri sa më efektiv, nëpërmjet të cilave plani kombëtar do të vazhdojë të udhëheqë institucionet dhe strukturat kryesore të përfshira në këtë proces.

Përparësitë përmbledhen në këto masa:

- Masa për fuqizimin e SKSHEC-së në Shqipëri.
- Masa për parandalimin, lehtësimin, përgatitjen dhe mbrojtjen.
- Masa për zbatimin e PKEC-së.

Matrica e Masave Prioritare për Emergjencat Civile në Shqipëri

Detyrat	Përgjegjësitë	Afati kohor	Komente
a. Masa për Fuqizimin e Sistemit Kombëtar të Shërbimit të Emergjencave Civile			
1. Ngritja dhe vënia në funksion e Strukturave të Emergjencave Civile në të gjitha Ministrinë e Linjës dhe institucionet e tjera në Zbatim të VKM Nr. 655 dt.18.12.2002.	Ministrinë, Institucionet përkatëse, Departamenti i Administratës Publike.	Janar 2004	
2. Krijimi dhe vënia në funksion e Qendrës Kombëtare të Trajnimit për Mbrojtjen Civile	MPVD, MM, MASH, MF, DAP	2005-2006	
3. Krijimi i Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes Civile	MPVD, MF, DAP	Gjashtëmuaji i dytë, 2005	
4. Rishikimi dhe nevojat për plotësimin e kuadrit ligjor në fushat përkatëse, në përshtatje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.	Ministrinë e linjës, Institucionet Qendrore	Dhjetor 2004	
5. Rishikimi i bazës ligjore për ndërhyrjen e shtetit në mbulimin e dëmeve të shkaktuar nga emergjencat.	MPVD, MF	Gjashtëmuaji i parë, 2005	
6. Rishikimi i bazës ligjore për lehtësimin e procedurave të kalimit të kufirit tokësor, portet, aeroportet për ndihmave humanitare, ekipet e ndihmes dhe emigranteve të përkohshëm në raste të emergjencave civile.	MF, MRP, MPJ, MB&U, ME, MPV&D	Shkurt 2005	
7. Rishikimi i bazës ligjore për krijimin e lehtësirave në përdorimin e fondeve financiare për përballimin e emergjencave civile	MF, ME, MPVD,	Qershor 2005	
8. Krijimi dhe freskimi i Sistemit të të Dhënave të Departamentit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, duke përfshirë sistemin GIS dhe shkëmbimi i të dhënave të freskuara në mënyrë periodike me Ministrinë dhe institucionet e tjera.	MPVD (DP&PEC), Ministrinë e linjës dhe Institucionet e tjera	Në mënyrë periodike, dhe rast pas rasti.	

9.	Organizimi i Sesioneve Trajnuese Ndërkombëtare të Grupeve të Kërkim-Shpëtimit Shqiptare në kursin e INSARAG.	MPVD (DPPEC), MM, MIE, MSH, MRP,	Duke filluar nga muaji Janar 2005	
10.	Dërgimi për bashkërendimin dhe informim në MPV&D (DP&PEC) i planeve dhe programeve të stervitjeve në fushën e emergjencave civile.	Ministritë dhe Institucionet	Muaji dhjetor te çdo viti	
11.	Vendosja e kontakteve dhe krijimi i marrëdhënieve të partneritetit për çështjet e emergjencave civile në fusha specifike nga secila Ministri e Linjës dhe institucion qendror me të paktën një partner respektiv nderkombetar.	Ministritë e linjës, Institucionet qendrore	Gjatë 2005	
12.	Përgatitja, dhe zbatimi i Projektit të Sistemit të Integruar të Komunikimit 112 ne baze te VKM nr. 663.	MPV&D, MRP, MSh KTKSEC, MF	2006-2007	
13.	Rishikimi dhe marrja e masave nga institucionet dhe strukturat përgjegjëse për ngritjen, forcimin dhe zhvillimin e sistemeve të monitorimit, alarmit, lajmërimit dhe evakuimit për: a. Rrjetin sizmiologjik b. Rrjetin hidrometeorologjik c. Fenomenet e rrëshqitje së tokës. d. Gjendjen e digave dhe dambave. e. Nivelin e ndotjes në zona të nxehta.	I Sizmiologjisë I Hidrometereologjisë MIE (DPSHGJSH) MRRTT, (I Digave dhe Dambave) MMj, (Inspektorati i Mjedisit).	Gjate vitit 2005	Nga institucionet përkatëse kërkohet përgatitja e projekteve dhe ndërmarrja e inisiativave ligjore për gjetjen e fondeve për ngritjen dhe paisjen e strukturave përkatëse.

b. Masat për Parandalimin, Lehtësimin, Përgatitjen dhe Mbrojtjen

14.	Dërgimi pranë MPV&D, (DPPEC) i ndryshimeve për të gjitha kapacitetet e sektorit publik dhe privat, që lidhen me përgjigjen ndaj emergjencave civile.	Ministritë e Linjës Prefektet e Qarqeve	Muaji Dhjetor të çdo viti	
15.	Ndjekja e detyrave dhe marrja e informacionit nga Ministritë e linjës dhe Institucionet e tjera, për zbatimin e Matricës së Planit Kombëtar dhe informimi në Keshillin e Ministrave.	MPV&D (DP&PEC)	Muaj Nëndor i çdo viti	Të pasqyrojë në vijimësi, ndryshimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.
16.	Vlerësimi i zonave dhe i fenomeneve që paraqesin rrezik sipas fushës së veprimit dhe territorit nën përgjegjësi, marrja e masave për monitorim dhe organizimi i sistemit të lajmërimit, të informimit të publikut dhe të instancave përkatëse.	Ministritë e linjës, Institucionet qendrore, Prefektet, Këshillat e Qarqeve, Bashkitë, Komunat.	Janar 2005	
17.	Vlerësime dhe raporte në MPV&D për gjendjen e: a. Kanaleve të të gjitha niveleve. b. Digave, pritave, urave dhe argjinaturave. c. Sistemit të furnizimit, transmetimit me energji elektrike dhe sigurimin e furnizimit me energji nëpërmjet linjave dytësore shtesë për hidrovolet si dhe objektet te tjera te rëndësishme. d. Sigurisë rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore. e. Materialeve te rrezikshme dhe subjektet qe administrojne dhe perpunojne materiale te tilla.	MB&U, MI&E, MRR&T, MA, MMj, MRP Qarqet, Bashkitë dhe Komunat përkatëse	Muaj Gusht i çdo viti.	
18.	Raporte/Informacione ne MPV&D per vlerësimet periodike dhe sipas rasti, ne lidhje me kontrollin e masave parandaluese në fushën e veprimtarisë dhe zonën e përgjegjësisë te institucioneve perkatese.	Institucionet dhe Sekretariatet e listuara në seksionin Nr 4, strukturat e niveleve të ndryshme.	Muajin Dhjetor te çdo viti ose rast pas rasti	

19. Hartimi i kodeve/standarteve dhe i normave ne përputhje me standartet e KE.	Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera sipas fushës së veprimtarisë.	2005	
c. Masat për zbatimin e Planit Kombëtar dhe Planeve të tjera.			
20. Hartimi i Planeve të Emergjencave Civile nga Ministritë e linjës, Institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore, bazuar në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.	Ministritë e linjës, Institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore.	Mars 2005	
21. Bashkëndimi i planeve të emergjencave civile të përgatitura nga Ministritë e linjës, institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore.	MPV&D (DP&PEC)	Qershor 2005	
22. Testimi i Planeve të Emergjencave Civile, dhe te Gadishmërisë të Ministrive të linjës dhe Institucioneve qendrore.	Të gjitha Ministritë e linjës, Institucionet qendrore.	Shtator 2005	
23. Testimi i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile nëpërmjet stërvitjes simuluese në tryezë.	MPV&D, (DP&PEC) Ekipi i Menaxhimit te Emergjencave perfaqesuesit e Ministrive te linjes dhe institucioneve te tjera (EMEC)	Korrik 2005	
24. Testimi i Seksionit 6 të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile nëpërmjet stërvitjes në terren.	MPV&D, (DP&PEC) MM (BMC), Policia e Shtetit, Qarku i Shkodres, KKSH	Tetor 2005	
25. Rishikimi dhe Freskimi i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile	MPV&D, (DP&PEC), Ministritë e linjës dhe Institucionet e tjera të përfshira.	Dhjetor çdo viti.	Të dhëna nga të gjitha Ministritë dhe institucionet.
26. Testimi dhe Freskimi i Planeve të Emergjencave dhe te Gadishmërisë të Qarqeve.	Prefektet e Qarqeve KPPEC dhe Personeli i Emergjencave Civile ne Qarqe.	Qeshor 2005	
27. Hartimi i Planeve të Emergjencave, Gadishmërisë, në nivel Bashkie dhe Komune.	Kryetarët e bashkive dhe komunave, (Personeli i emergjencave në Qark, Bashki dhe Komunë).	Maj 2005	
28. Për Bashkinë e Tiranës: Hartimi i Planit te Emergjencave të Bashkisë, Planet të Emergjencave dhe të Gadishmerise të Njesive Bashkiake te Tiranës.	Bashkia Tiranë Njesitë Bashkiake të Tiranës.	Maj 2005	
29. Freskimi dhe rishikimi i Planeve të Gadishmërisë të Aeroportit dhe Porteve dhe unifikimi i tyre sipas standarteve ndërkombëtare të sigurisë.	MT&T Aeroporti "Nënë Tereza". Autoritetet portuale Durrës, Vlorë, Shengjin Sarande.	Maj 2005	Me të njëjtin rritëm, duke pasur parasysh rregullat ndërkombëtare.
30. Hartimi ose freskimi i Planeve specifike te Emergjencave dhe koordinimi i tyre.	MPVD, MASH, MSH, ASH, MTT, MRP, MM, MMj.	Qershor 2005	
31. Informacion në DP&PEC për hartimin dhe testimin e planeve të emergjencave ose gadishmërisë për objektet e rëndësishme, ndërmarrje dhe komplekse industriale shtetërore ose private.	Ministritë e linjës dhe të gjitha institucionet sipas fushës respektive.	Muaji Janar te cdo viti	

SHTOJCAT

A. RREZIQET, KARAKTERISTIKAT DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

A.1 Tërmetet

A.1-1 Vlerësimet e rreziqeve të mundëshme nga tërmetet

Shqipëria shtrihet në brezin sizmik alpin-mesdhetar, që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Eurazisë, e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut. Pjesa më aktive e saj është deti Egje dhe rajoni përreth. Në këtë rajon ($33-43^{\circ}\text{V}$, $18-30^{\circ}\text{L}$), që karakterizohet nga rënia pothuaj vjetore e një tërmeti me $M_s \geq 6,5$, ndodhen: Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M < 3.0$), nga shumë termite të vogla ($3.0 < M < 5.0$), nga termite të rralla me madhësi mesatare ($5.0 < M < 7$) dhe shumë rrallë nga termite të forta ($M > 7.0$). Përplasja e pllakës së Adrias dhe Albanideve është shkaku kryesor i tërmeteve në vendin tonë. Vatrë e tërmeteve të Shqipërisë përqendrohen kryesisht përgjatë shkëputjeve tektonike aktive.

Harta e shkëputjeve aktive në Shqipëri përcakton tri zona shkëputjeje aktive gjatësore dhe dy tërthore.

Në tabelën më poshtë jepen nxitimet e pritshme të truallit të tokës për skenarë të ndryshëm që përputhen me tërmetet e mundshme me periudha përsëritjeje si në tabelë.

Nxitimi maksimal i pritshëm i truallit (NMT- në % të g, $g=9.81 \text{ cm/s}^2$) sipas periudhës karakteristike të përsëritjes (Pk)

Skenari	Burimi sizmik	PP-50	PP-100	PP-200	PP-475	PP-1000	maxM _{exp}
TSk-01	Shkodër	9.8	15.8	23.5	36.0	49.3	6.8
TSk-02	Lezhë	10.5	16.1	22.6	32.0	41.4	6.2
TSk-03	Tiranë	8.3	13.1	19.2	29.2	39.0	6.0
TSk-04	Durrës	8.2	16.1	26.6	44.5	65.0	6.8
TSk-05	Berat	10.6	16.1	23.4	35.4	48.8	6.8
TSk-06	Vlorë	10.8	18.8	28.3	44.5	62.5	6.8
TSk-07	Himarë	9.4	15.1	23.0	35.4	48.7	6.6
TSk-08	Tepelenë	12.5	18.5	26.6	39.8	54.0	6.8
TSk-09	Sarandë	13.0	18.9	26.7	39.7	53.6	6.6
TSk-10	Elbasan	13.9	20.5	29.7	44.5	59.9	6.8
TSk-11	Dibër	17.5	24.4	32.8	47.0	61.6	6.2
TSk-12	Pogradec	11.7	17.9	25.9	39.6	54.4	6.9
TSk-13	Kukës	14.0	20.3	28.2	39.9	52.8	5.7
TSk-14	Leskovik	6.4	9.3	13.4	19.1	25.5	6.3
TSk-15	Petrovac	4.0	6.8	10.8	18.0	26.6	7.2

Për njohjen e shkallës së veprimit sizmik, vlerësimi i rrezikut nga tërmetet është realizuar për periudha përsëritjeje 50, 100, 200, 475 dhe 1000 vjet. Periudha e përsëritjes prej 475 vjetësh (që është me +/- 10% probabilitet për një periudhe ekspozimi 50-vjeçar) është zgjedhur meqenëse kjo është periudha referuese që përdoret në Eurokodin nr. 8.

Përdorimi i hartës aktuale të zonimit sizmik është përcaktuar për projektimin e ndërtesave të zakonshme. Aktualisht, për vepra të rëndësishme dhe objekte të larta është detyrim ligjor të bëhen studime të detajuara inxhiniero-sizmologjike për të nxjerrë të dhëna konkrete në lidhje me rrezikun sizmik për sheshe konkrete ndërtimi.

Nëpërmjet studimit “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri” është realizuar për herë të parë vlerësimi tërësor i elementeve të domosdoshme për nevoja planifikimi dhe menaxhimi të emergjencave shkaktuar nga tërmetet.

Periudha e kthimit 50 vjet				Tërmeti i skenarit	Periudha e kthimit 100 vjet			
I1	I2+I3	M	Pa shtëpi		I1	I2+I3	M	Pa shtëpi
-	-	-	71	Shkodër	-	-	-	135
-	-	-	95	Lezhë	-	-	-	158
-	-	-	99	Tiranë	-	-	-	174
-	-	-	125	Durrës	0.01	0.04	0.01	322
-	-	-	153	Berat	-	0.01	-	272
-	-	-	145	Vlorë	0.04	0.17	0.06	324
-	-	-	41	Himarë	-	-	-	71
-	-	-	84	Tepelenë	0.01	0.04	0.02	152
-	-	-	20	Sarandë	-	0.01	-	37
-	-	-	195	Elbasan	0.06	0.25	0.09	347
-	-	-	111	Dibër	0.04	0.11	0.05	177
-	-	-	145	Pogradec	0.02	0.06	0.02	231
-	-	-	124	Kukës	0.03	0.14	0.05	196
-	-	-	21	Leskovik	-	-	-	33
-	-	-	86	Petrovac	-	-	-	97
Periudha e kthimit 200 vjet				Tërmeti i skenarit	Periudha e kthimit 475 vjet			
I1	I2+I3	M	Pa shtëpi		I1	I2+I3	M	Pa shtëpi
0.10	0.41	0.15	258	Shkodër	4.40	12.27	4.82	546
0.01	0.06	0.02	262	Lezhë	0.72	2.01	0.79	523
0.02	0.07	0.03	296	Tiranë	0.42	1.39	0.53	607
2.55	6.68	2.67	795	Durrës	29.26	74.46	29.98	1886
0.10	0.48	0.17	524	Berat	6.20	15.99	6.42	1162
2.23	5.71	2.3	713	Vlorë	23.17	58.99	23.73	1504
0.01	0.04	0.02	127	Himarë	1.09	3.28	1.26	266
0.30	0.88	0.34	289	Tepelenë	6.00	16.07	6.37	604
0.14	0.42	0.16	70	Sarandë	1.45	4.01	1.58	137
1.95	5.35	2.11	640	Elbasan	13.69	36.85	14.61	1243
1.47	2.38	1.1	279	Dibër	8.86	14.7	6.74	409
0.63	1.76	0.69	399	Pogradec	11.02	28.45	11.39	759
0.55	1.73	0.66	272	Kukës	3.45	10.53	4.05	427
-	-	-	45	Leskovik	-	-	-	69
-	-	-	151	Petrovac	-	0.02	0.01	252

I1 - lëndime të lehta ; I2+I3 - lëndime për shtrim në spital ; M - vdekje

A.1-2 Karakteristikat kryesore

Në përgjithësi, tërmetet bien pa paralajmërim, por mund të pasohen nga një seri lëkundjesh të tjera, shtrirja kohore e të cilave mund të zgjatë për orë, ditë ose javë të tëra.

- Lëkundjet pasuese (pasgoditjet) janë të një shkalle më të vogël se e para, por mund të shkaktojnë ndikim të madh, veçanërisht tek strukturat që janë dëmtuar tashmë.
- Tërmetet godasin nga thellësi të ndryshme dhe kanë kah lëvizjeje horizontal, vertikal ose të kombinuar.
- Në përgjithësi, e matur në shkallën Richter, madhësia e një tërmeti nuk tregon intensitetin (efektin sipërfaqësor) e tij në një vend të caktuar.
- Dëmtimet e shkaktuara nga tërmetet varen nga shumë faktorë. Këtu përfshihet në radhë të parë madhësia e tij e matur në shkallën Richter, thellësia e vatrës, karakteristikat e truallit ku mbështeten objektet, cilësia e strukturave të prekura, intensiteti dhe numri i pasgoditjeve që shoqërojnë goditjen kryesore, efektet dytësore që shfaqen në truall etj.
- Numri i viktimave nga tërmetet varet shumë nga aftësia që kanë objektet e ndërtimit për t'u rezistuar goditjeve sizmike si dhe nga koha lokale në të cilën ndodh goditja. Koha në të cilën ndodh tërmeti, dmth. të qenët ditë ose natë përcakton numrin e njerëzve brenda ose jashtë objekteve në atë çast dhe, si rezultat, përcakton dhe prekshmërinë ndaj efekteve të prishjes strukturale.
- Edhe efektet dytësore mund të çojnë në pasoja serioze. Këtu përfshihen: rrëshqitjet e tokës ose tipa të tjerë të mungesës së stabilitetit të tokës, dalja në sipërfaqe e thyerjeve tektonike, lëngëzimi i trojeve të shkrifëta të pakonsoliduara, përmbytjet që vijnë si rezultat i strukturave të dëmtuara ujëmbajtëse, shkarkimit të mbetjeve toksike dhe materialeve të rrezikshme nga zonat industriale etj.
- Shkatërrimi i papritur i një dige kryesore nga goditjet sizmike do të sillte pasoja katastrofike për komunitetet që jetojnë afër saj.

A.1-3 Faktorë që duhet të merren parasysh në Parandalimin dhe Lehtësimin

- Një tërmet ose dukuri tjetër sizmike është e pamundur të parandalohet, por në zonat me rrezik të lartë mund të merren masa për të kufizuar efektet më negative që lidhen me cenimin e jetës dhe të pasurisë.
- Investimet, bashkërendimi dhe fushatat e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe të publikut të gjerë inkurajojnë lehtësimin dhe uljen e rreziqeve.
- Përmirësimet, pranimi dhe zbatimimi i kodeve dhe i standardeve të ndërtimit për të përballuar lëkundjet sizmike ulin dëmet në njerëz dhe në pasurinë private dhe publike. Masat parandaluese dhe përgatitore ulin, gjithashtu, edhe dëmtimet e mundshme ndaj infrastrukturës mbështetëse (objekte shëndetësore, ndërtesat publike kryesore, rrugët, hekurudhat, aeroportet, sistemet e furnizimit me ujë, energji etj.), të cilat do të jenë shumë të rëndësishme për fazën e përballimit dhe të rimëkëmbjes nga një goditje sizmike.
- Ndërtimet e reja të një rëndësie të veçantë në zonat e rrezikuara nga goditjet sizmike duhet të bëhen në mënyrë të tillë që ato të përballojnë goditje më të forta sizmike sesa kërkohet nga kodet standarde dhe një gjë e tillë është investim që ia vlen. Ky investim është më i lirë se përmirësimi i strukturave ekzistuese.
- Sensibilizimi i strukturave në nivel lokal dhe kombëtar është i rëndësishëm për të sjellë së bashku aktorët e ndryshëm, për të ndërgjegjësuar dhe për të zhvilluar strategji për zbatimin e kodeve ekzistuese me synim përmirësimin e tyre.
- Objektet e rëndësishme që paraqesin rrezik, si diga, infrastruktura publike dhe private, është e rëndësishme të mirëmbahen të paktën në nivelin e standardeve origjinale duke kërkuar rrugë dhe mënyra për të siguruar kushtet më të larta të mirëmbajtjes tek to dhe, po të jetë e nevojshme, duke bërë edhe përmirësime pa vonesa të strukturave.

A.1-4 Faktorë për t'u marrë në konsideratë gjatë Përgatitjes dhe Mbrojtjes

- Në përgjithësi, në rastet e tërmeteve ose të goditjeve sizmike, paralajmërimi në kohë nuk është i mundur, por mund të bëhen përgatitje të veçanta në zonat e identifikuara si zona me rrezik të

lartë sizmik.

- Ndërgjegjësimi i publikut për atë çfarë duhet bërë në momentet e para të tërmeteve ose të goditjeve sizmike është shumë i rëndësishëm për shpëtimin e jetës. Për këtë qëllim duhen përdorur të gjitha mënyrat e mundshme për informimin e publikut dhe institucionet përkatëse. Shkollat, administrata publike, spitalet, industria private, media lokale dhe publike duhet të angazhohen për të shpërndarë mesazhe të thjeshta e të kuptueshme nëpërmjet të gjitha mjeteve të komunikimit.
- Planifikimi i përballimit të emergjencave në nivel lokal dhe kombëtar për çdo institucion si dhe autoriteti përkatës duhet të rriten, pasi një gjë e tillë është e lidhur drejtpërdrejt me bashkërendimin e përgjithshëm, me mobilizimin e burimeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Emergjencave Civile në Republikën e Shqipërisë.
- Planet e përballimit të emergjencave duhet të praktikohen nëpërmjet stërvitjeve simuluese dhe në terren.
- Të gjitha strukturat e emergjencave, linjat e komunikimit, rolet dhe përgjegjësitë duhet të qartësohen, të përgjithësohen dhe të testohen në bazë të planeve për të siguruar një përgjigje efektive të vazhdueshme.

A.1-5 Faktorët për t'u marrë parasysh në fazën e Përgjigjes ndaj Emergjencës

- Veprimet e menjëhershme të kërkim–shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komuniteti i prekur, ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjaret, të afërmit ose fqinjët.
- Trajtimi i menjëhershëm mjekësor i të plagosurve do të jetë mjaft i domosdoshëm në rast të një tërmeti. Një fatkeqësi e përmasave të mëdha do të kërkojë një plan për trajtimin e viktimave në masë, për të bërë të mundur trajtimin në zonën e prekur dhe, nëse është e nevojshme, edhe evakuimin për trajtim mjekësor jashtë saj.
- Vlerësimi i shpejtë rreth humbjeve, dëmtimeve dhe nevojave.
- Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të dëmtuara, duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur operacione profesionale kërkim-shpëtimit, duke pasur parasysh se 24-48 orët e para janë “orët e arta”, kohë gjatë së cilës mund të shpëtohen pjesa më e madhe e njerëzve.
- Në varësi të shumë faktorëve, duke përfshirë edhe temperaturat, operacionet e kërkim-shpëtimit mund të vazhdojnë në mënyrë të suksesshme për deri në 65 ose më shumë orë pas ngjarjes. Përveç shembujve ekstremë nga fatkeqësi të mëdha, numri i të mbijetuarve që shpëtohen pas katër ose pesë ditësh është jashtë mase i vogël, megjithëse shpëtimiti në këtë kohë mund të jetë ende i mundur.
- Nëse është shkaktuar një dëmtim struktural i konsiderueshëm dhe nëse një numër i madh njerëzish kanë mbetur brenda, mund të kërkohet edhe asistencë ndërkombëtare për operacionet e kërkim-shpëtimit.
- Ardhja e skuadrave të kërkim-shpëtimit do të shkaktojë një ngarkesë të konsiderueshme mbi infrastrukturën e transportit ajror dhe rrugor si dhe kërkon angazhime e përpjekje për t'i shpërndarë dhe për t'i dërguar ato në zonat e prekura sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Skuadrat ndërkombëtare për operacionet e kërkim-shpëtimit ndonjëherë vijnë të pajisura me spitale fushore. Spitalet fushore mund të ofrohen, gjithashtu, edhe si ndihmë ndërkombëtare. Ka çështje specifike që duhet të qartësohen përpara pranimit/kërkimit të një spitali të huaj fushor. Për përdorimin e spitaleve të huaja fushore në fatkeqësitë me ndikim të menjëhershëm referojuni udhëzuesit të PAHO-WHO. Këto udhëzime mund të gjenden dhe në faqen e internetit www.paho.org/disasters
- Rreziqet dytësore dhe dëmtimet strukturore të ndërtesave publike (si spitale, shkolla, ndërtesa administratash etj.) duhet të vlerësohen duke u siguruar se ato mund të funksionojnë pa pasur rreziqe.
- Vlerësimi dhe kujdesi i vazhdueshëm për nevojat për ujë të pijshëm, strehë të sigurt, furnizim me ushqime dhe artikuj të tjerë joushqimorë si dhe regjistrimin dhe kërkimin e personave që mungojnë.
- Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor, aeroporti, komunikimi dhe infrastruktura tjetër duhet të vihen në funksion sa më shpejt dhe sa më mirë të jetë e mundur.
- Gjatë ngjarjeve të rënda mund të ketë probleme specifike, si për shembull, problemi i qindra

ose edhe mijëra të vdekurve. Për këtë arsye mund të merren hapa specifike në mënyrë që të menaxhohet siç duhet një situatë e tillë, duke e lidhur atë edhe me planin e menaxhimit të viktimave në masë. Udhëzimet e PAHO-WHO për menaxhimin e trupave pa jetë në situata fatkeqësish mund të gjenden në www.paho.org/disasters

A.1-6 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Rikthimit në Gjendjen Normale

- Shërbimet publike bazë, që përfshijnë furnizimin me ujë të pijshëm, ujërat e zeza, akset kryesore të rrugëve dhe furnizimin me energji, duhet të jenë të sigurta.
- Vendime të shpejta duhet të merren, gjithashtu, në lidhje me ndërtesat kryesore të ndërmarrjeve publike (duke përfshirë ndërtesat e shëndetësive dhe shkollat), të cilat mund të jenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë. Ndërtesat që nuk mund të riparohen, duhet të prishen plotësisht dhe të merren në konsideratë zëvendësime të përkohshme ose të përhershme.
- Vendime të shpejta duhet të merren, gjithashtu, edhe në lidhje me strehimin e sigurt për popullsinë e prekur. Strehimi i përkohshëm, si për shembull, çadrat, mund të jenë të përshtatshme për një kohë të shkurtër, por nuk janë të përshtatshme në një kohë më të gjatë në klimë të ftohtë.
- Një emergjencë e përmasave të mëdha në përgjithësi shoqërohet nga asistenca ndërkombëtare dhe nga një mbështetje e mundshme financiare. Është shumë e rëndësishme të bashkërendohen në mënyrë efektive donacionet kundrejt nevojave parësore dhe që të ketë një informacion të plotë në mënyrë që të jemi në gjendje të refuzojmë donacione ose oferta jo të përshtatshme për mbështetje.
- Ndërtesat industriale dhe objektet bujqësore që janë dëmtuar ose shkatërruar. Restaurimi i këtyre burimeve është pjesë shumë e rëndësishme për rimëkëmbjen ekonomike dhe për punësimin e komunitetit.
- Një tërmet i fuqishëm i lë efektet e tija për një brez ose dhe për më tepër dhe rajoni i prekur do të ketë nevojë për mbështetjen ndërkombëtare për një afat më të gjatë derisa të vazhdojë të bazohet në forcat e tija. Planifikimi për riaftësim duhet ta reflektojë këtë gjë.
- Së fundmi, rikthimi në gjendjen normale është mundësi për lehtësimin dhe parandalimin. Përveç presioneve të mëdha për të siguruar strehim dhe shërbime sa më shpejt të jetë e mundur, duhet të merret parasysh edhe çdo mundësi për të ndërtuar instalime të reja të një standardi që të përballojë goditjen sizmike, duke bërë ndërtimin në një zonë të studiuar me kujdes, përfshirë këtu edhe shërbimet publike.

Mirëmbajtja e strukturave ekzistuese duhet të inkurajohet në rastet e riparimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndërtesa të përdorura nga një numër i konsiderueshëm njerëzish, si për shembull, shkolla dhe spitale. Në rastin e strukturave shëndetësore duhet të sigurohet një funksionim i plotë për gjatë të gjitha fazave, duke përfshirë instalimin e rrjetit afatshkurtër të furnizimit me ujë dhe mjete për t'u përdorur në rastet e nevojshme, si gjeneratorë dhe ndriçim në rastet e emergjencave.

A.2 Përmbytjet

A.2-1 Vlerësimi i rreziqeve të mundëshme nga përmbytjet

Tetë lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë, të grupuar në gjashtë pellgje ujëmbledhëse, e përshkojnë vendin nga lindja në perëndim. Përmbytjet zakonisht janë me prejardhje lumore dhe ndodhin në periudhën shtator-mars, kur në vend bien afër 80-85 për qind e reshjeve vjetore. Pasojat, të cilat dikur mund të zvogëloheshin deri në një nivel të përcaktuar nga investimet e bëra për parandalimin e përmbytjeve, sot stimulohen lehtë për shkak të degradimit të kushteve të sistemit të pritave, të kanaleve të kullimit, ndërtimeve pa kriter mbi objekte dhe zona me rrezik, gjendjes së stacioneve të pompimit dhe të pajisjeve të tjera për mbajtjen nën kontroll të përmbytjeve.

Përmbytja e ultësirës bregdetare perëndimore

Shqipëria ka një histori të gjatë të regjistrimit të përmbytjeve në ultësirën perëndimore.

Përmbytja e nëntorit 1962 – janarit 1963 mbahet historikisht si më e madhja.




Fig.1-P Harta e rrezikut të përmytjes të Ultësirës

Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore për periudhë perseritje 100 vjet sipas të lumenjve dhe zonave që përkrahin

Lumi Qarku	Rrethi	Sasia e fshatrave	Sasia e komunave	Sasia e ndërtesave	Sipërfaqja e ndërtimit (m ²)	Popullsia
BUNA		36	10	13,948	1,741,700	119,249
Shkodër	Shkodër	36	10	13,948	1,741,700	119,249
DRINI		78	23	23,733	2,433,840	171,956
Lezhë	Lezhë	35	10	7,227	503,420	39,044
Shkodër	Shkodër	43	13	16,506	1,930,420	132,912
ERZENI		11	4	3,762	374,620	25,789
Durrës	Durrës	6	2	1,736	175,300	12,083
Tiranë	Tiranë	5	2	2,026	199,320	13,706
ISHMI		24	7	8,107	687,320	49,653
Durrës	Durrës	4	1	1,413	149,200	10,623
Durrës	Krujë	13	3	4,233	358,640	26,287
Lezhë	Kurbini	7	3	2,461	179,480	12,743
MATI		28	8	7,512	537,820	41,528
Lezhë	Kurbini	7	2	2,461	179,480	12,743
Lezhë	Lezhë	13	5	2,844	199,020	16,204
SEMANI		20	7	4,305	278,500	28,947
Berat	Berat	10	4	996	74,040	4,942
Berat	Kuçovë	3	2	961	64,540	4,814
Fier	Fier	37	12	7,830	562,900	41,704
Fier	Lushnjë	40	12	5,729	446,060	32,369
SHKUMBINI		30	14	6,599	513,420	38,052
Elbasan	Peqin	2	1	294	22,620	1,433
Tiranë	Kavajë	4	4	1,550	97,880	8,105
Fier	Lushnjë	24	9	4,755	392,920	28,514
VJOSA		28	8	4,579	346,380	24,858
Fier	Fier	19	6	3,076	225,600	15,528
Fier	Mallakastër	1	1	7	400	29
Vlorë	Vlorë	8	1	1,496	120,380	9,301
GJITHSEJ		333	109	83,357	7,741,240	552,117

Më 31 dhjetor 1970 – 1 janar 1971 lumi i Vjosës përmbysi rreth 14.000 hektarë. Përmbytja shkaktoi pothuaj të njëjtat pasoja dhe dëmtime (dëmtime e shkatërrime të argjinaturave, kanaleve ujitore, urave, stacioneve të pompimit etj.), madje në disa zona të përmbytjes dëmet u llogaritën edhe më të mëdha se ato të shënuara nga përmbytja e Vjosës më 1962-1963.

Përmbytjet e fundit kanë ndodhur në shtator të vitit 2002, tetor 2003 dhe shkurt-mars 2004. Ato u shkakjuan nga prurjet e lumenjve Drin, Gjadër, Erzen, Osum, si dhe disa përrrenj e lumenj më të vegjël, si: përroi i Manatisë (në rajonin e Lezhës), përroi i Zezës (në Fushë-Krujë), Drinosi, Gjanica etj.

Ujërat përmbytën kryesisht zonën e Lezhës, të Shkodrës si dhe zona të tjera rurale e tokat bujqësore përgjatë brigjeve të lumenjve të mësipërm.

Paraqitja në hartë (fig. I-P) përfaqëson përmbytjet e pritshme me mundësi përsëritjeje një herë në 100 vjet. Me kapacitetet aktuale, plani kombëtar reflekton mundësinë për përballimin e një niveli përmbytjesh relativisht më të vogël se ai me përsëritje 100 vjet.

Sipas përmbledhjes në studimin “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”, përmbytja me mundësi përsëritjeje 100 vjet do të prekte 20 rrethe, 110 komuna, 341 fshatra, 85,500 godina me 7 900 000 m² sipërfaqe ndërtimi dhe 565,000 banorë.

Në tabelën më poshtë jepen pasojat e pritshme për kushtet aktuale nga përmbytjet e ultësirës perëndimore, të cilat mund të përsëriten një herë në 100 vjet.

Rreziku i përmbytjeve nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë

Përmbytjet e shkaktuara nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë shpesh prekin luginat e Shqipërisë Veriore, Qendrore dhe Jugore, duke dëmtuar rrjetin rrugor dhe toka bujqësore. Janë 19 lumenj të vegjël ose përrenj që përfaqësojnë rrezik të përhershëm për përmbytje. Karakteristika kryesore e tyre është se janë shumë të shpejtë dhe shpesh “të pabesë”, sjellin vëllime të mëdha aluvionesh dhe mund të shkaktojnë dëme të paparashikueshme në infrastrukturë, objekte banimi dhe bujqësi.

Digat dhe rreziqet

Ngritja e digave në Shqipëri ka nisur rreth viteve ‘50. Digat e para u ndërtuan për qëllime bujqësore. Sot ka 630 sisteme rezervuarësh me diga, prej të cilave 307 njihen si diga të larta (lartësia ≥ 15 m) ose sisteme rezervuarësh me diga të mëdha (Regjistri ndërkombëtar i digave, KNIDM (ICOLD), 1998). Sipas numrit të digave për 10.000 banorë, Shqipëria zë vend të parë ndër 82 anëtarë të ICOLD-it, ndërsa për numrin e digave të larta vjen në vendin e tetëmbëdhjetë. Diga e Fierzës, me lartësinë 167 m është diga më e lartë në Europë e tipit të saj. Të gjitha digat e larta në Shqipëri janë të tipit me mbushje dheu.

Kushtet ekzistuese

Projektimi dhe ndërtimi i digave mbështetet në një analizë të gjithanshme të të gjithë faktorëve që lidhen me të dhe që mund të prekin sigurinë e vetë digës si dhe të sistemit digë/rezervuar. Për të siguruar kufijtë e sigurisë së projektuar gjatë gjithë periudhës së ekzistencës, rëndësi të dorës së parë ka mirëmbajtja e sistemeve gjatë shfrytëzimit të tyre. Mirëmbajtja e rregullt dhe e frytshme, duke përfshirë rehabilitimin në kohën e duhur, janë në veçanti thelbësore për sistemet digë/rezervuar ndërtuar me dhe e gurë. Me vjetrimin e digave, siguria e punës së tyre është problem. Kjo kërkon më shumë vëmendje në formën e inspektimeve, vlerësimeve, modifikimeve dhe përmirësimit të digave të vjetruara, në mënyrë që të përballojnë standardet dhe rregullat e teknologjisë së kohës.

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha ka bërë një vëzhgim të digave dhe vlerësimin e gjendjes së digave në Shqipëri, në vitin 2001. Vëzhgimi, i kryer për 429 diga, jepet i përmbledhur si më poshtë:

- 246 diga mund të prekin një popullsi prej më shumë se 100 persona secila.
- 156 diga mund të prekin qendra të banuara me mbi 500 banorë secila.
- 57 diga mund të prekin qendra të banuara me mbi 2 500 banorë secila.
- 8 diga mund të prekin qytetet Elbasan, Divjakë, Lushnjë dhe komunën Gostimë.

Prej 157 digave me potencial të lartë dëmtimi, 70 janë vlerësuar si të dëmtuara, prej të cilave 13 janë të dëmtuara rëndë.

Migrimi i madh gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ka sjellë ngritjen e qendrave të reja të banuara, madje disa prej tyre janë ngritur nën digat ekzistuese. Një numër i konsiderueshëm digash të mëdha janë ndërtuar në rrethet e Tiranës e të Durrësit. Që të dyja këto rrethe janë të ekspozuara ndaj proceseve të migrimit. Ndërtimi i infrastrukturës (ujësjellësit, kanalet e ujërave të zeza dhe punime të tjera me gërmime dheu) si dhe veprimtaritë e tjera njerëzore që kryhen në zonën fundore të strukturave të digave ekzistuese, prekin rëndë qëndrueshmërinë e përgjithshme të digës dhe sigurinë e saj.

A.2-2 Karakteristikat bazë

- Përmbytjet e menjëhershme ndodhin në një kohë të shpejtë, ato janë shkatërruese dhe gjithçka

mund të ndodhë vetëm në pak orë.

- Viktimat në njerëz dhe dëmet në përmbytjet e menjëhershme shpesh lidhen më shumë me shpejtësinë e rrjedhës së ujit, masën e mbetjeve të ngurta dhe shkatërrimin e masave parandaluese, më tepër sesa nga thellësia e ujit të grumbulluar si rezultat i përmbytjeve.
- Sidoqoftë, nëse uji i grumbulluar nga përmbytjet mbulon një sipërfaqe më të madhe, ndikimi fillestar mund të jetë më i vogël, por një thellësi më e madhe e ujit mund të këtë ndikim shumë të madh mbi njerëzit që jetojnë në zonë, mbi pronën e tyre dhe do të marrë më shumë kohë për t'u rikuperuar.
- Edhe me plane të suksesshme evakuimi, ujërat e përmbytjeve që qëndrojnë për një kohë të gjatë i lënë njerëzit të shkëputur nga shtëpitë (në varësi të asistencës) dhe shkaktojnë humbje në gjënë e gjallë, dëme në të mbjella, si dhe sjellin dëmtime të konsiderueshme në infrastrukturë.
- Në rastin e digave ujëmbledhëse, sipas situatës, duhet të merren vendime për të hapur portat të cilat shoqërohen me përmbytje lokale, gjë që është më e lehtë se shkatërrimi katastrofik i strukturës ujëmbajtëse. Në këto raste monitorimi i kujdesshëm, analiza dhe marrja e masave në kohë janë shumë të rëndësishme.
- Përmbytjet e vazhdueshme shkaktojnë rënie ekonomike të popullsisë. Disa zona të tilla mund të bëhen të papërshtatshme për ndërtime të përhershme.
- Në vendin tonë sistemi i lumenjve përbën edhe kërcënimin më të madh për përmbytjet, ku përmbytjet janë përgjithësisht të një origjine pluviale.

A.2-3 Faktorët që duhet të merren në konsideratë në lidhje me Parandalimin dhe Lehtësimin

- Përmbytjet e menjëhershme shpesh lidhen me ndryshimin klimaterik, degradimin mjedisor dhe urbanizmin në rritje.
- Përmbytjet e menjëhershme mund të shkaktohen nga mosmirëmbajtja e kanaleve dytësore ose tretësore, nga mirëmbajtja jo ashtu siç duhet e digave, pritave, argjinaturave etj.
- Pritat kryesore ekzistuese si rezultat i prurjeve të mëdha mund të vendosen në një presion më të madh sesa ishte parashikuar, duke çuar në përmbytje, prishje dhe efekte më të mëdha që shkaktojnë probleme dytësore dhe tretësore në zonat që nuk kanë përvojë në mbrojtjen nga përmbytjet ose përballimin e tyre.
- Digat e larta përfaqësojnë rrezik specifik të përmbytjeve nëpërmjet prishjes. Veprime të kufizuara mund të ndërmerren për të parandaluar prishjen si rezultat i një tronditjeje të madhe sizmike nëpërmjet mirëmbajtjes dhe riparimit të strukturës dhe menaxhimit të rrjedhës së ujit të cilat ulin presionin mbi strukturën ekzistuese.
- Menaxhimi i derdhjeve të ujit, kanaleve, lumenjve dhe strukturave të lidhura me ujin shpesh ndahet ndërmjet shumë institucioneve dhe strukturave. Bashkërendimi dhe vendimmarrja kolegjiale në nivel lokal dhe kombëtar është e domosdoshme për të ofruar tregues të matshëm gjatë shfaqjes së problemeve dhe, nga ana tjetër, shkëmbimi i informacionit dhe njoftimi efektiv i hershëm, si dhe masat lajmëruese, luajnë rol shumë të rëndësishëm për të ulur ndikimin, madje edhe për të parandaluar përmbytjet nga ujërat e grumbulluara në nivele më të larta.
- Zonat pa përvojë në lidhje me problemet e përmbytjeve tani po bëhen më të rrezikshme. Planifikimi, përdorimi i tokës dhe sjellja e njerëzve duhet të reflektojnë në drejtimin e duhur për uljen e rrezikut të përmbytjes.

A.2-4 Faktorë për t'u marrë në konsideratë në fazën e Përgatitjes dhe të Mbrojtjes

- Informacioni i bashkërenduar, sistemi i paralajmërimit i vendosur më parë dhe plani i informimit publik janë shumë të rëndësishëm për të shpëtuar jetën dhe pronën në zonat me rrezikshmëri të lartë.
- Publiku dhe institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshëm për një plan evakuimi dhe për zonat e identifikuara të strehimit të sigurt, nëse do të jetë e nevojshme.
- Plane specifike për evakuimin e shpejtë të popullsisë që jeton në afërsi të digave të mëdha janë masa shumë të rëndësishme sigurie.
- Planifikimi duhet të përfshijë përparësi, si ofrimin e shërbimeve bazë publike duke përfshirë ujin dhe shërbimin shëndetësor parësor. Publiku duhet të këshillohet të konsumojë ujë të pastër

ose ta ziejë atë 10 minuta para përdorimit dhe të mos inkurajojë fëmijët të luajnë në ujërat e përmbytjes.

- Shërbimet dytësore dhe tretësore të kujdesit shëndetësor duhet të kenë plane gatishmërie duke marrë në konsideratë një numër të rritur pacientësh si rezultat i efekteve të përmbytjeve si dhe për sigurimin e sistemeve alternative të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm për një kohë të caktuar.
- Në varësi të kushteve dhe të situatave të paparashikuara, në nivel lokal duhet të mbahen inventarë për makina të larta, barka të përshtatshme shpëtimi dhe pajisje të tilla, si mushama shiu, pompa uji dhe rezervuarë, të cilët mund të përdoren gjatë situatave të përmbytjeve.
- Kontaktet me shërbimin më të afërt të kërkim-shpëtimit për zonat me rrezik dhe informacione të tjera duhet të jenë të përditshme.

A.2-5 Faktorët që duhet të merren parasysh gjatë fazës së Përgjigjes ndaj Emergjencës

- Nevoja e menjëhershme për evakuimin në kohë dhe të organizuar të popullsisë së prekur ose të kërcënuar për në zona të sigurta dhe, nëse është e nevojshme, dërgimi i tyre në streha të sigurta.
- Dhënia dhe marrja e informacionit për popullsinë e dëmtuar është mjaft e rëndësishme në këtë etapë. Personat që mungojnë duhet të identifikohen me emër dhe vendndodhja e tyre e fundit duhet të jetë e saktësuar. Nëse është e nevojshme, duhet të ndërmerren operacione kërkim-shpëtimi sa më shpejt të jetë e mundur.
- Furnizimi me pajisje për strehim, ujë të pijshëm, racione ushqimi, batanije dhe rroba të ngrohta do të nevojiten shumë shpejt për popullsinë e prekur. Në këtë kuadër duhet të përcaktohet një plan shpërndarjeje dhe kritere të qarta për të gjithë.
- Vlerësimi i mjedisit dhe ndikimi i tij mbi shëndetin duhet të bëhet menjëherë duke përfshirë zonat dhe burime të tjera të kontaminuara dhe publiku duhet të informohet sa më mirë të jetë e mundur për rreziqet dhe faktorët që duhet të mbahen parasysh gjatë procesit të kthimit të tyre në shtëpi.
- Në këtë periudhë mund të jetë ende e nevojshme të ofrohen furnizime të përkohshme me ujë (duke përfshirë dhe furnizimet me autobote e cisterna) për një periudhë afatshkurtër për popullsinë e prekur, edhe kur ata janë kthyer në shtëpi.

A.2-6 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë Rikthimit në Gjendjen Normale

- Dëmtimi fizik i ndërtesave dhe i infrastrukturës duhet të vlerësohet dhe të analizohet si bazë për rimëkëmbjen. Strukturat e dëmtuara të furnizimit me ujë dhe të mbrojtjes së tij duhet të riparohen dhe të rikthehen të paktën në të njëjtin standard si përpara përmbytjeve dhe mundësisht të zhvillohen për të përballuar një përmbytje edhe më të madhe në të ardhmen.
- Vetëm pasi zona të jetë konsideruar e mbrojtur dhe e sigurt, mund të fillojë rikonstruktimi dhe rehabilitimi i shtëpive dhe i ndërtesave publike.
- Rehabilitimi është një mundësi për të përmirësuar funksionet fizike dhe strukturore të ndërtesave. Ndërtimi i mureve dhe i argjinaturave pritëse mund të ulë rastet e përmbytjeve serioze.
- Përmbytjes duhet t'i bëhet një rishikim në nivelin lokal, duke nxjerrë në pah shkaqet, qofshin ato natyrore ose njerëzore, si dhe për mënyrën e drejtimit dhe të zhvillimit të operacioneve për përballimin e emergjencës.
- Përfundimet që do të dalin gjatë rishikimit, do të çojnë drejtpërdrejt në iniciativa për parandalimin dhe lehtësimin e situatave, duke përfshirë identifikimin më të mirë të përgjegjësive për mirëmbajtjen e kanaleve, të stacioneve të pompimit dhe, në përgjithësi, të masave mbrojtëse dhe parandaluese.

A.3 Bllokimet nga dëborë

A.3-1 Vlerësimet e rreziqeve të mundëshme nga dëborë e madhe

Reshjet e dëborës janë karakteristike për rajonet malore, d.m.th. Alpet e Shqipërisë dhe rajonet malore, verilindore dhe juglindore. Ato janë dukuri e rrallë në fushat e ultësirës perëndimore, sidomos në pjesën jugperëndimore të bregdetit shqiptar.

Në krahinat malore rënia e dëborës zakonisht nis në nëntor dhe vazhdon deri nga fundi i marsit, por në lartësi të mëdha të Alpeve të Shqipërisë dhe në shpatet me drejtim nga veriu është e pranishme edhe gjatë verës.

Disa tregues për rënien e dëborës në vendin tonë jepen në tabelën I.

Reshjet e dëborës, kur janë në sasi të mëdha, përveçse mund të shkaktojnë emergjencë për banorët e zonave që preken drejtpërdrejt për shkak të bllokimit për një kohë të gjatë të tyre, janë pengesë serioze edhe për komunikimin në përgjithësi. Sigurimi i lëvizjes së pandërprerë ka rëndësi jetike për një operacion emergjence.

Strukturat planifikuese, menaxhuese dhe vendimmarrëse kanë nevojë për këto informacione:

- zonat ku potencialisht pritet bllokimi dhe kushtet në të cilat ndodh bllokimi,
- nëse bllokimi ndodh, sa do të zgjatë ai.

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal dhe prek, madje pengon (në zonat malore), operacionet e emergjencës. Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25-30 cm e bllokon tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. Në rast se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, sidomos në zonat malore veriore të Shqipërisë, trafiku mund të bëhet vetëm me automjete të posaçme, të cilat, sot për sot, janë të kufizuara në vend.

Duke u mbështetur në regjistrimet për periudha të gjata, të marra nga rrjeti meteorologjik i Shqipërisë, i cili përbëhet prej 180 stacioneve, është përpiluar harta e rrezikut të mbulimit me dëborë për 5 ditë (fig. 2), që tregon krahinat që mbeten nën mbulesën e dëborës të paktën për 5 ditë.

Bllokimi i popullsisë – rreziku dhe elementët e parapërgatitjes

Mundësia e bllokimit të popullsisë nga dëborë, e llogaritur si popullsi banuese brenda konturit të hapësirës që mbulohet me dëborë, me lartësi të paktën 30 cm, shkon nga 11,6 për qind (~355.000 ±10%) deri në 51,3 për qind (~1. milion ±10%) në kushtet e klimës më të skajshme. Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive dhe të furnizimeve të tjera si dhe stoqet e tregut në vend, një periudhë bllokimi më e gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e parapërgatitjes për emergjencë.

Tabela 1. Vlerat mesatare të treguesve klimaterikë të lidhur me dëborën

Rajoni	NMDD (Ditë)	NMVDMD(Ditë)	ThMMD (cm)
Ultësira Perëndimore, Shqipëria jugperënd dhe bregdeti	0-5	<1 (4-5) ¹⁾	<25 ⁵⁾
Krahinat malore - drejtimi perëndimor (nga deti)	5-15	5-20	
Krahinat malore - drejtimi lindor (nga toka)	15-30	40-70 ²⁾ 70-100 ^{3), 4)}	
Alpet Shqiptare	30 - 50	Maximum, > 100	100 - 150 ⁶⁾




Fig. 2. Rreziku i mbulimit 5 ditë nga bora

Rreziku prej ortekëve

Shqipëria është vend që shquhet për pjerrësinë e madhe të shpateve malore dhe kodrinore (>30%), për bimësinë e paktë dhe pyjet e rralla në shumë krahina si dhe për reshjet e dendura të dëborës. Të ndërthurura bashkë, këto rrethana janë të përshtatshme për krijimin dhe aktivizimin e ortekëve, të cilët, për shkak të shpërndarjes demografike të popullsisë, shpesh shoqërohen me dëme.

Dëborë e madhe dhe ortekët e shpeshtë kanë shkaktuar dëme të ndjeshme në dimrat e viteve 1933/34, 1940/41, 1953/54, 1963/64 dhe 1972/73. Ortekët në Batër (rrethi i Matit, mars 1965) dhe në Feken (Mali me Gropa, mars 1981) kanë qenë me pasoja të rënda.

Në periudhën janar-shkurt të vitit 1985, në rrethet e Tropojës, Kukësit, Dibrës, Pukës, Shkodrës dhe Matit, si pasojë e dëborës së madhe, u shkëputën shumë ortekë. U vranë 68 veta, u plagosën 135 dhe u shkatërruan 1.604 shtëpi. Rrjeti rrugor kombëtar dhe rajonal si dhe linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike e të telefonisë u dëmtuan ndjeshëm.

Ortekët në Shqipëri ndodhin kur grumbullimet e dëborës në shpatet me bimësi të paktë kanë pjerrësi >30%, janë të ekspozuara nga ana veriore, verilindore e lindore dhe kur trashësia e dëborës është më madhe se 30 cm.

Rajonet ku ndodhin më shpesh ortekët jepen në tabelën e mëposhtme.

A.3-2 Karakteristikat bazë

- Dëborë e madhe ka të ngjarë të ndodhë në zona caktuara të vendit në bazë të stinës. Parashikimi afatshkurtër është përgjithësisht i mundur nëpërmjet raporteve standarde të parashikimit të motit dhe raporteve meteorologjike.
- Efektet parësore ndihen te rrugët dhe te mjetet e komunikimit, të cilat izolojnë në mënyrë të shpejtë komunitetet. Vetëm 10 cm dëborë mund të ndalojë trafikun normal dhe veçanërisht në rajonet malore ky bllokim pengon edhe shërbimet e emergjencës. Një depozitë prej 25 deri në 30 cm dëborë mund të bllokojë plotësisht trafikun normal. Linjat e energjisë elektrike dhe të telefonit, transmetuesit dhe lidhjet e tjera të komunikimit mund të preken në mënyrë po aq të shpejtë.
- Ndikimi është zakonisht afatshkurtër, pa pasoja të mëdha ekonomike mbi popullsinë. Sidoqoftë, kushtet atmosferike të ftohta dhe trashësia e dëborës mund të vazhdojnë për ditë, madje për javë të tëra, kështu që popullsia është e detyruar të qëndrojë brenda derisa të kalojë gjendja e rrezikshme. Një bllokim prej 30 ditësh konsiderohet kritik për planifikimin e emergjencave civile, kohë pas së cilës rezervat e komunitetit në ushqime janë në përfundim.
- Stuhitë e ftohta dhe temperaturat që shkaktojnë ngrica, mund të kenë efekt katastrofik mbi linjat

Tabela 2. Zonat ku ndodhin më shpesh orteqet

Rrethi	Zonat e rrezikshme
Tropojë	Luginat e lumenjve Valbona, Curraj, Nikaj-Merturi, Salca, Vrana dhe gjithë rruga ndërmjet Fierzës e Pukës.
Kukës	Shpati perëndimor i malit të Gjallicës, shpati perëndimor i malit të Kolesjanit, Gryka e Vanave dhe të dy anët e shpateve përgjatë rrugës Kukës-Peshkopi.
Dibër	Zonat e Krej-Lurës, Gjurë-Lurë, Gryka e Nokës, Lugina e Bulqizës, Gjur-Reç, shpati perëndimor i malit të Gramit dhe malit të Velivarit.
Pukë	Zonat e Iballës, Kabashit, Korjes së Merturit, pjesa e sipërme e lumit Fani i Madh, Kunora e Dardhës, përgjatë rrugës Pukë-Kukës.
Shkodër	Zona e Vermoshit, zona e Lëpushës, Vukli, qafa e Drenovës, Maja e Shnikut, zonat e Dukagjinit, Shoshi.
Mat	Zonat e Valit, Batër, Martanesh.

- e energjisë elektrike dhe mund t'i bëjnë rrugët të pakalueshme dhe/ose të rrezikshme.
- Temperaturat shumë të ulëta mund të shkaktojnë ngrirjen dhe dëmtimin e sistemeve të furnizimit me ujë, ngrirjen e ujërave të zeza dhe dëmtime të konsiderueshme në bujqësi dhe blegtori.
- Efektet dytësore lidhen me përmbytje të menjëhershme pas një shkrirjeje të shpejtë ose ngrirjeje të mëvonshme që rëndojnë kalueshmërinë në rrugë si dhe bllokimin e komunikimit.
- Kur trashësia e borës është më tepër se 30 cm, si dhe kur ekzistojnë edhe disa parametra të tjerë, ortekët përbëjnë rrezik specifik në anë të pjerrëta. Forca e tyre është e menjëhershme dhe është tej mase shkatërruese për jetën dhe pasurinë.

A.3-3 Faktorë për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Parandalimit dhe Lehtësimit

- Paralajmërimi në kohë është zakonisht i mundur dhe popullsia duhet të jetë menjëherë në gatishmëri nëpërmjet një sistemi standard dhe praktik.
- Ndërkohë që reshjet e mëdha të dëborës nuk mund të parandalohen, ortekët mund të parashikohen me një farë saktësie dhe të parandalohen. Një gjë e tillë kërkon një punë shumë të specializuar që përfshin monitorim të vazhdueshëm dhe mjete të tjera duke përfshirë shpërthime të kontrolluara për të ulur grumbullimin e dëborës në zonat e rrezikuara.
- Sensibilizimi i popullatës për rëndësinë e ruajtjes së një rezerve me artikuj ushqimorë që nuk prishen, sigurimin e ngrohjes dhe të strehimit, duke pasur rroba të ngrohta, batanije dhe ujë të pijshëm. Popullsia duhet t'i pritët hovi sa më shumë të jetë e mundur që të mos udhëtojë jashtë zonës gjatë reshjeve të shumta të dëborës.
- Në rastet e reshjeve të mëdha të dëborës duhet të mirëmbahet një burim informacioni, si për shembull, një stacion lokal radioje, për ta këshilluar popullsinë për situatën dhe për mënyrën si do të kërkohet asistencë nëse është e nevojshme.

A.3-4 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë Parapërgatitjes dhe Mbrojtjes

- Duhet të ketë plane specifike për mbylljen e shkollave dhe të shërbimeve të tjera jothelbësore.
- Duhet të bëhet paraprakisht, sa të jetë e mundur, identifikimi i njerëzve dhe i familjeve të cilat janë më të prekshme ndaj motit të keq, duke përfshirë familjet e të moshuarve dhe të të izoluarve.
- Duhet të përpilohen plane të veçanta për përforcimin e shërbimeve bazë, si për shembull të ndërtesave ku ofrohen shërbime mjekësore, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e këtyre shërbimeve në një situatë të tillë dhe të sigurohet ngrohje, furnizim i pavarur me energji, karburant, ndriçim, ushqime, ujë të pijshëm dhe persona të mjaftueshëm në punë dhe në gatishmëri.
- Në nivelin lokal duhet të bëhet dhe të mbahet një inventar i mjeteve të pastrimit të dëborës, i makinave të ndryshme që përdoren për transport në raste emergjente, dhe i pajisjeve të tjera të rëndësishme. Pikat e kontakteve duhet të jenë të njohura dhe të jenë bërë gati kontrata paraprake që mund të lidhen me subjekte private, nëse do të jetë e nevojshme.
- Kontaktet me shërbimin më të përshtatshëm të kërkim-shpëtimit, për familjarët në vendet më në rrezik duhet të mbahen të përditshme.
- Duhet të përgatiten, gjithashtu, edhe planet e gatishmërisë për të ofruar asistencë të një shkalle të gjerë nëse kushtet e vështira vazhdojnë. Këtu mund të përfshihen racionet ushqimore dhe lloje të tjera asistencë, strehim për ata që kanë lënë shtëpitë e tyre si rezultat i situatës së krijuar.

A.3-5 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Përgjigjes ndaj Emergjencës

- Nevoja e menjëhershme është dhënia e informacionit në kohën e duhur për t'u siguruar se e gjithë popullsia në rrezik është e ndërgjegjshme për situatën, e inkurajuar dhe e ndihmuar për të shkuar ose për të ndenjur në një objekt strehimi të sigurt. Në rastin e reshjeve të mëdha të dëborës së menjëhershme mund të jetë e nevojshme të planifikohen strehime të përkohshme të sigurta.
- Në këtë fazë, shkëmbimi i informacionit me popullsinë është shumë i rëndësishëm. Personat që mungojnë duhet të identifikohen me emra dhe të saktësohet, gjithashtu, vendndodhja e tyre e fundit dhe, nëse është e nevojshme, të ndërmerren operacionet e kërkim-shpëtimit sa më shpejt të jetë e mundur.

- Ekziston një rrezik specifik për njerëzit e bllokuar në makina, të cilët duhet të shpëtohen nga skuadra kompetente dhe të pajisura mirë të kërkim-shpëtimit, të cilët duhet të dërgohen në vende të sigurta, të identifikuara më parë, derisa shkalla e rrezikshmërisë të ulet.
- Lidhjet e shkëputura të transportit janë me përparësi për t'u rihapur. Mund të vendosen kufizime në llojet e makinave për të favorizuar makineritë për pastrimin e dëborës dhe makinat që përdoren për furnizimin me artikuj që nevojiten për situatën e emergjencës.
- Nëse reshjet vazhdojnë të shtrihen në kohë, furnizimi me ujë të pijshëm, racione ushqimore, batanije dhe mundësisht edhe me rroba të ngrohta, do të nevojitet menjëherë për popullsinë që është transferuar në vendstrehimet e përkohshme dhe, edhe më shumë, për familjet që janë izoluar në shtëpitë e tyre.
- Pas një kohe të shkurtër, institucionet që karakterizohen nga një densitet i lartë popullsie, si për shembull spitale dhe shtëpi kolektive, do të kërkojnë edhe asistencë shtesë, pasi funksionimi i tyre i plotë është shumë i rëndësishëm.
- Nëse sistemet e ngrohjes nuk funksionojnë, mungesa e energjisë elektrike, e karburantit dhe e lëndëve të tjera djegëse mund ta bëjë një pjesë të popullsisë tej mase të cenushme ndaj të ftohtit dhe izolimit. Situata duhet të jetë vazhdimisht nën monitorim dhe nën rishikim dhe, aty ku është e nevojshme, të merren veprime të shpejta.
- Shpesh është më e lehtë të evakohen dhe të asistohen njerëzit në një strehë të sigurt kolektive, kur mundësia për të arritur ato individuale bëhet problematike ose e paparashikuar.

A.3-6 Faktorët që do të merren parasysh në Rikthimin në Gjendjen Normale

- Dëmtimi fizik i ndërtesave dhe i strukturave të zakonshme zakonisht nuk është shumë serioz. Më të prekshme janë rrjetet e furnizimit me energji, instalimet e ujit të pijshëm, të ujërave të zeza dhe sipërfaqet e rrugëve të cilat mund të dëmtohen seriozisht nga veprimet e shpeshta të ngrirjes dhe të shkrirjes.
- Përmbytjet dytësore nga shkrirjet e shpeshta përbëjnë një faktor që duhet të merret në konsideratë menjëherë në fazën e rimëkëmbjes dhe mund të përfaqësojnë një ngjarje të dytë emergjente.
- Sigurimi i informacioni për popullsinë është shumë i nevojshëm nëpërmjet të njëjtave mjete, si radio lokale, që është përdorur edhe gjatë periudhës së përballimit.
- Rivendosja e lidhjeve ekzistuese të komunikimit dhe të transportit është përparësi absolute dhe një mundësi për të forcuar sistemet dhe për të lehtësuar efektet e reshjeve të mëdha në të ardhmen.
- Duhet të bëhet një rishikim i plotë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar në lidhje me situatën e reshjeve, planet dhe veprimet e strukturave si dhe cilësinë e operacioneve të ndërmarra në fazën e përballimit.

A.4 Rrëshqitjet e tokës


A.4-1 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga rrëshqitjet e tokës

Shqipëria ka si tipar paqëndrueshmëritë masive të tokës, që shkaktohen nga veprimi mekanik i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, reshjet, veprimi sizmik, ndërhyrjet ndërtimore në shpate, ndërtimi i digave dhe i ujëmbledhësve të mëdhenj, ndërtimi i rrugëve, i tuneleve dhe i instalimeve të tjera të infrastrukturës, lidhur me to, shpyllëzimet pa kriter etj.

Paqëndrueshmëritë e tokës në Shqipëri vijnë kryesisht pas shirave të rrëmbyeshme ose rënies masive të dëborës.

Sipas llojit të paqëndrueshmërisë së tokës, kemi këto veçori:

Rënia e shkëmbinjve është karakteristikë e rajoneve malore të Alpeve të Shqipërisë, e shpateve gëlqerore të zbuluara ndaj kushteve të klimës së ftohtë dhe e shirave të bollshme në rrëzë të malit të Melesinit, malit të Nemërçkës, luginave të thella të malit të Shalës, malit të Valbonës, masivit gëlqeror të malit të Gjallicës (Shtren-Kukës), rrugës Qafa e Llogorasë-Palasë-Vuno, si dhe



H.1 Harta Gjeoteknike e Shqipërisë

kështjellat e Krujës e të Gjirokastrës.

Shembjet janë karakteristike për rajonet malore të Shqipërisë. Një rast i tillë është shembja e menjëhershme e rreth 12 milionë m³ të gëlqerorit në Kapariel (Gjirokastrë, 1977).

Rrëshqitjet me rrokullisje janë karakteristike për shpatet e shkëmbinje rreshporë ose të molasës deltinore dhe shpatet prej konglomerati me pjerrësi mbi 45° dhe pjerrësi të shtresave në drejtim të kundërt (Currilat - Durrës, Kryevidh, kepi i Rodonit, Dukat, zona e Shënpal-Blinisht-Mashtërkorës, zona Libohovë-Dhoksat, blloku i madh gëlqeror në fushën e Vlorës, blloqet gëlqerore në bregun e majtë të lumit të Shkumbinit në sektorin Qukës-Librazhd).

Rrëshqitjet me zhvendosje janë rrëshqitjet më të dendura në Shqipëri. Ato janë karakteristike për bartjen e mbulesave relativisht të holla (~ 5m), të formuara mbi shpatet me shkëmbinj acidë, mesatarisht acidë dhe bazikë magmatikë, në zonat e thërrmuara tektonike ose në shkëmbinjtë rreshporë, në rreshpet e molasat e rajoneve të Krujës, detit Jon e sidomos në rajonin e Krastë-Cukalit. Në këtë grup futen edhe rrëshqitjet në luginën e lumit Curraj (afër fshatit Curraj i Epërm), në luginën e Cemit, Valbonës, në disa rajone të Kukësit, Elbasanit, Skraparit, Maliqit etj.

Rrjedhjet janë karakteristike për zonat rreshpore të Krastë-Cukalit, Krujës dhe molasat e gropave të brendshme malore. Rrjedhat në sipërfaqe, në trajtën e rrymave të baltës nga grimca të ngurta të paqëndrueshme të shpatit, që bëhen të rrjedhshme prej ujërave të përrenjve gjatë shtrëngatave të rënda me shi, mund të barten dhjetëra kilometra larg. Ato janë karakteristike për zonat malore të Shqipërisë me reshje vjetore që i kalojnë 200 cm dhe në luginat me përrenj me pjerrësi të madhe, si në Dukagjin, Lezhë, Elbasan, Përmet, Korçë, Ersekë dhe Mokër.

Më 1977-n, një rrjedhë e kësaj natyre, që barti depozitime flishi e dëbore të shkrirë, shkatërroi 120 shtëpi në fshatin Moglicë (rrethi i Korçës). Kjo rrjedhë, që lëvizte 4-5 m/orë, përfundoi në lumin e Devollit.

Zonimi gjeoteknik i territorit të Shqipërisë u krye më 1997-n. Harta gjeoteknike, e hartuar në shkallën 1:200.000, e ndan territorin e saj në tri zona të qëndrueshmërisë natyrore të shpateve (hartanr1):

- 1) terrene të qëndrueshme,
- 2) terrene relativisht të qëndrueshme,
- 3) terrene të paqëndrueshme.

Terrenet e qëndrueshme janë të përhapura gjerësisht. Ato mbulojnë rreth 56,6 për qind të vendit dhe përbëhen prej shkëmbinjsh të fortë.

Terrenet relativisht të qëndrueshme mbulojnë rreth 33,6 për qind të territorit të Shqipërisë. Ato shtrihen nga pjesa veriperëndimore në drejtim të Shqipërisë Qendrore dhe Jugore.

Ndërhyrja e dorës së njeriut në këto masa shkëmbore krijon probleme për qëndrueshmërinë e shpateve, sidomos nëse lartësia e shpatit i kalon 12 m. Një numër i madh fshatrash të Shqipërisë janë ngritur në këtë zonë.

Terrenet e paqëndrueshme nga ana natyrore mbulojnë afërsisht 9,8 për qind të territorit. Ato janë karakteristike për zonat e Bushtricës (Kukës), Qukësit dhe Okshunit (Librazhd), Vaut të Dejës, Kallmetit (Lezhë), Bishtit të Pallës (Durrës), Spillesë, Kryevidhit (Kavajë), Ndroq-Pezë-Baldushkut (Tiranë), Mokër-Opar-Leskovikut, Lenias-Moglicës, Tragjas-Dukatit dhe Ballsh-Tepelenës.

Shënim: Meqë rrëshqitjet e tokës në shumicën e rasteve janë pasojë e drejtpërdrejtë e tërmetejeve, përmbytjeve apo edhe shirave e dëborave të mëdha, atëherë edhe karakteristikat dhe faktorët që duhen marrë në konsideratë gjatë fazave të ndryshme të emergjencës, duhen parë gati si të njëjta me ato të përshkruara në kapitujt për tërmetet, përmbytjet, dëborën etj.

A.5 Zjarret në pyje

A.5-1 Vlerësimet e rreziqeve të mundëshme nga zjarret në pyje

Pyjet zënë 1,045 milionë ha, me vëllimin e pulpës së drurit më këmbë rreth 82-milionë m³ dhe rritje mesatare vjetore prej 1,4 m³ për ha. Pjesa më e madhe e sipërfaqes pyjore (77%) përbëhet prej pyjesh të degraduara me prodhimtari të paktë (pyje dushku, 31,8%, dhe shkorret, 25,6%).

Nga këto, rreth 900.000 ha = 86% të sipërfaqes janë pyje prodhimi dhe rreth 140.000 ha ose 14% janë pyje mbrojtëse. Llojet kryesore të drurëve janë: pisha, dushku, ah, bredhi dhe lloje të tjera gjethegjera.

Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, zjarret në pyje në Shqipëri janë shtuar si numër, por është rritur, gjithashtu, edhe përmasa e sipërfaqeve të prekura. Më 1999-2001-në, të dy treguesit janë mbi karakteristikat mesatare për vendet mesdhetare.

Shkaqet kryesore të zjarreve janë pakujdesia e njerëzve, djegia për kullota dhe natyrore (rrufetë). Shumica e dëmeve ndodhin në pyjet halore.

Rreth 65 për qind e popullsisë së Shqipërisë jeton në zona rurale dhe varet kryesisht prej veprimtarive të bujqësisë ekstensive dhe blegtorisë. Keqpërdorimi i pyjeve nga njerëzit (i shoqëruar me shpyllëzimet gjatë viteve të kaluara) dhe praktikat e kullotjes, pa dyshim, janë shkaktarët e pjesës më të madhe të shkatërrimit të pyjeve.

Kullotja e pakufizuar dhe zjarret e pakontrolluara, të shkaktuara aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllime pastrime kullotash, vijojnë të ndodhin në vend.

Për periudhën 1989/98, raporti ndërmjet sipërfaqes pyjore të djegur dhe sipërfaqes së vendit ishte rreth 2,19; për periudhën 1998/2001 është rritur në 5,66. Që nga viti 1992 në Shqipëri është rritur ndjeshëm rreziku i zjarreve në pyje, duke arritur kulmin në vitin 2000.

Dëmet e korijsive, të shkurreve e të kullotave dhe humbjet e lidhura me to janë dëme të fushës mjedisore. Megjithatë, dëmet për pyjet e larta dhe humbjet përkatëse, që për një vit arrijnë gjithsej rreth 360 milionë lekë, janë humbje të drejtpërdrejta ekonomike. Shkalla e këtyre humbjeve kërkon vëmendjen e të gjitha subjekteve të interesuara, duke përfshirë edhe shërbimet e emergjencës civile.

Denduria e zjarreve të pyjeve në Shqipëri ndryshon gjeografikisht (fig. 1), duke qenë më e lartë në rrethin e Vlorës (vjetore 50 zjarre/vit) dhe më e vogël në rrethin e Kuçovës (një rast/vit).

Masat për menaxhimin e zjarreve, që duhet të përforcohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, janë: vënia në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, vigjilencë për raste zjarri gjatë gjithë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarrit.

Llojet kryesore të drurëve pyjorë

Llojet e drurëve pyjorë	Sip.(ha)	(%)
Pishë (llojet Pinus)	142,000	15
Bredh (llojet Abies)	13,000	2
Ah (Fagus silvatica)	160,000	17
Dushk (llojet Quercus)	300,000	32
Lloje të tjera gjethegjera	510,000	34
Gjithsej	1,125,000	100

Burimi: IFFN Nr. 12, janar 1995/




Fig. 1 Ndodhite vjetore të zjarreve në pyje
(Periudha 1999 - 2001)

Duke u ballafaquar me këtë problem, kaq të mprehtë tashmë, ekziston një strategji e mbrojtjes së pyjeve e cila kërkon kontributin e të gjitha strukturave për t'u bërë efektive dhe për të arritur rezultatet e pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare, siç janë pyjet.

Në pyjet me rrezik zjarri është në dispozicion një rrjet vrojtim-sinjalizimi (me disa kulla vrojtimi zjarri për çdo rreth), që përdoret nga shërbimi pyjor gjatë stinës së zjarreve. Infrastruktura në dispozicion dhe pajisjet për shuarjen e zjarreve janë në zhvillim e sipër.

A.5-2 Karakteristikat bazë

- Zjarret në pyje dhe kullota shpesh janë ngjarje të një shkalle më të vogël, në krahasim me ato që kanë ndikim dramatik mbi jetën dhe pronën. Përjashtim bëjnë zjarret që mbulojnë sipërfaqe të mëdha shkurresh ose pyje ku përfshihen edhe zona të banuara, pasi këto të fundit mund të shkaktojnë shkatërrim në një zonë të gjerë.
- Shkaqet kryesore të zjarreve vijnë nga njerëzit, duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të kontrolluara jo ashtu siç duhet, si për shembull djegien e kullotave, aksidentet dhe vëniet e qëllimshme të zjarrit.
- Si rezultat, zonat specifike të rrezikut janë lehtësisht të identifikueshme, ndërkohë që parandalimi, lehtësimi, mbrojtja dhe parapërgatitja janë të mundura dhe mund të kenë efekte të ndjeshme për uljen e rrezikut.
- Në rastet e zjarreve që përfshijnë sipërfaqe të tëra, është shumë e vështirë për t'u kontrolluar, qofshin këto zjarre të shkaktuara nga njerëzit ose zjarre natyrore dhe drejtimi dhe forca e erës janë faktorë të veçantë në paparashikueshmërinë e tyre.
- Në vendin tonë, rreziku më i madh i zjarreve të pyjeve është evident në fund të pranverës dhe gjatë periudhave të verave të thata. Që prej 1992-së, rreziku i zjarreve të pyjeve në Shqipëri është rritur në mënyrë të konsiderueshme, si në shpeshësi, ashtu edhe në përmasa të zonave të prekura.

A.5-3 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parandalimit dhe Lehtësimit

- Faktorët e parandalimit, si fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe institucional, mund të kenë ndikim të rëndësishëm në uljen e rrezikut. Këto fushata mund të ndërmerren në nivel kombëtar, nivel rajonal dhe lokal, sipas nevojave specifike të rreziqeve në zonën përkatëse.
- Publiku dhe institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshëm për legjislacionin ekzistues, që ndalon ndezjen e zjarreve në zonat me rrezik të lartë dhe rregullat duhet të jepen si mesazhe të thjeshta.
- Një sistem serioz vëzhgimi dhe patrullimi ndihmon në ndërgjegjësimin, informimin dhe zbatimin e legjislacionit.
- Mund të nevojiten ndryshime në praktikën bujqësore për sa u përket rreziqeve në rritje. Alternativa, opsione dhe udhëzime mund të jenë të nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin për mosdjegien e kullotave në periudhat kur rrezikshmëria e përhapjes dhe e daljes jashtë kontrollit është e lartë.

A.5-4 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parapërgatitjes dhe Mbrojtjes

- Inkurajimi dhe zbatimi i masave ekzistuese të mbrojtjes, si për shembull, barrierat për parandalimin e zjarrit, kullat për monitorimin e pyjeve dhe një situatë patrullimi i përforcuar për pyjet, është çelësi për mbrojtjen e zonave të mëdha nga zjarret.
- Mbështetja dhe përforcimi i një rrjeti të përhershëm ekzistues të mbikëqyrje-sinjalizimit (me disa kulla vrojtimi) jep këtë përgjigje thelbësore të hershme.
- Investimet, fuqizimi dhe përdorimi racional i teknikës mund të çojnë në përballim të situatës përpara se kjo e fundit të mos mund të kontrollohet nga njeriu.

A.5-5 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Përgjigjes

- Shpejtësia e përgjigjes është faktori kryesor në parandalimin e përhapjes së zjarrit në një pyll të vogël ose të zjarrit në shkurre, për të mos marrë përmasat e një emergjence civile.
- Drejtimi i zjarrit është shumë i paparashikuar dhe e gjithë popullsia vendëse ose e përkohshme

në çdo rast duhet të përgatitet për t'u evakuar. Evakuimi duhet të bëhet mundësisht sipas planeve të gatishmërisë ekzistuese dhe të testuara.

- Duhet të identifikohen dhe të paracaktohen zonat e sigurta për evakuimin së bashku me rrugët e sigurta për të shkuar në ato zona që ekzistojnë ose që janë dhënë si mundësi.
- Publiku dhe institucionet duhet të mbahen të mirinformuara nëpërmjet mjeteve të nevojshme (si për shembull, stacioneve lokale të radiove) dhe duhet të lejohen ose të inkurajohen të kthehen në shtëpitë e tyre kur situata të jetë përsëri absolutisht e sigurt.
- Në emergjencat e zjarreve të një madhësie të konsiderueshme mund të kërkohet ndihmë ndërkombëtare për shuarjen e zjarrit, si për shembull zjarrfikës të fuqishëm, helikopterë dhe avionë të prodhuar posaçërisht për këtë qëllim, veçanërisht nga vendet fqinje.

A.5-6 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Rikthimit në Gjendjen Normale

- Dëmtimet në lidhjet e transportit, të energjisë elektrike dhe të telekomunikacioneve duhet të jenë me përparësi për t'u rregulluar, sapo situata të jetë e sigurt për të bërë një gjë të tillë.
- Situata duhet të monitorohet nga afër për shpërthime të papritura të vatrave të zjarrit fillestar ose të zjarreve dytësore, që ndodhin nga i njëjti shkak fillestar ose nga materialet djegëse që zhvendosen nga era.
- Kthimi i situatës në normalitet sjell mundësi për të mësuar nga një rishikim i plotë i shkaqeve dhe ndikimit të asaj çfarë ndodhi, duke analizuar rëndësinë e paralajmërimit në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme si dhe përgjigjen e duhur.
- Një rishikim i plotë siguron përmirësime të mundshme gjatë operacioneve të përballimit, të parandalimit dhe të lehtësimit të situatës së krijuar.
- Humbja ekonomike që vjen si rezultat i zjarrit, duhet të paraqitet me koston e mundshme të lehtësimit kundrejt një situatë të përsëritur, si mjet për të kërkuar investime për parandalimin.
- Etapa e menjëhershme e pasngjarjes, mund të paraqesë një mundësi për të aplikuar për burime shtesë për parandalimin, lehtësimin dhe mbrojtjen.

A.6 Emergjencat Industriale dhe Teknologjike

A.6-1 Karakteristikat bazë

- Situatat emergjente teknologjike (industriale) mund të vijnë nga shkaqe të ndryshme në objektet industriale, si për shembull: në miniera, rafineri, depozita të karburanteve dhe të materialeve të rrezikshme, në tubacione ose në instalime të ndryshme, në komplekse industriale ku përdoren lëndë të cilat, në gjendje të lirë ose në kombinim me njëra-tjetrën, mund të shkaktojnë zjarre, ndotje, eksplozione etj. ose nga një efekt dytësor i një fatkeqësie natyrore, si për shembull: një goditje sizmike, rrëshqitje dheu ose përmytje serioze.
- Rreziqet teknologjike janë shqetësime për emergjencat mjedisore dhe për emergjenca potenciale civile.
- Përfshirja e një rreziku teknologjik brenda një situatë ekzistuese të një fatkeqësie natyrore mund të krijojë mjedis shumë të papërshtatshëm për fazën e përballimit.
- Kërcënimi drejtpërdrejt mund të marrë formën e zjarreve, shpërthimeve, ujit të kontaminuar rëndë, rrëzimit të ndërtesave, prishjes së minierave ose ndërtesave të tjera të ngjashme dhe çlirimit të gazeve helmuese.
- Kufizimet ekonomike mund të mos lejojnë përshtatshmërinë dhe rritjen e sigurisë së objekteve ekzistuese industriale, por parapërgatitja dhe organizimi për mbrojtjen dhe përballimin mund të ulin në mënyrë të ndjeshme efektet e një emergjence të një natyre të tillë.
- Në vendin tonë, megjithëse prodhimi industrial i vendit ka rënë ndjeshëm që prej vitit 1991, ka masa të konsiderueshme materiale të rrezikshme që vazhdojnë të ruhen ende, si dhe lëndë e produkte që mbahen në kushte të papërshtatshme, sikundër ka edhe subjekte të reja, aktiviteti i të cilave përbën rrezik potencial.

A.6-2 Faktorët për t'u marrë në konsideratë në fazën e Parandalimit dhe të Lehtësimit

- Identifikimi i zonave të rrezikuara në nivel kombëtar dhe lokal është i rëndësishëm për të planifikuar masat e nevojshme.
- Planet e emergjencave civile dhe të gatishmërisë të niveleve të ndryshme, duke përfshirë edhe sistemin e lajmërimit-evakuimit të punonjësve brenda objekteve dhe komunitetit në afërsi të tyre, janë të dobishme në një situatë të tillë.
- Objektet industriale duhet të përfshihen edhe në skenarët e tjerë, si për goditjet sizmike, rrëshqitjet e tokës dhe përmblytjet, pasi mund të ketë efekte serioze dytësore të një natyre teknologjike të cilat nuk duhet të dalin si surpriza gjatë fazës së përballimit.
- Një plan kombëtar, rajonal ose lokal me kërkesa për instalime të sigurta ndihmon në caktimin e përparësive sipas rrezikut që paraqesin për popullsinë dhe mjedisin. Përveç burimeve të kufizuara, në këtë mënyrë, të paktën kërcënimet më të mëdha mund të reduktohen një nga një në varësi të fondeve të caktuara për këtë qëllim.

A.6-3 Faktorë për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Parapërgatitjes dhe Mbrojtjes

- Përballimi drejtpërdrejt i fatkeqësive teknologjike është një punë shumë e specializuar të cilën mund ta bëjnë vetëm njësi të kualifikuara ose me përvojë.
- Përveç evakuimit të planifikuar të popullsisë, mund të dalin dhe detyra të tjera që mund të mos jenë parashikuar. Parashikimi i efekteve dytësore të mundshme duhet të jetë bazë për planifikimin e ndikimit maksimal të fatkeqësisë. Mjaft struktura mund të përfshihen në sigurimin e popullsisë dhe të mjedisit. Në këtë drejtim, koordinimi i mirë i përgjigjes është shumë i rëndësishëm.
- Për skenarë ekstremë mund të kërkohet edhe asistencë e ekspertëve ndërkombëtarë nëpërmjet programit të Kombeve të Bashkuara "Për mjedisin".

A.6-4 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Përgjigjes

- Evakuimi i menjëhershëm i popullsisë së prekur dhe i popullsisë që ka mundësi të preket, është shumë i rëndësishëm. Sistemet e paralajmërimit dhe të informacionit publik duhet të mirëmbahen dhe të funksionojnë gjatë gjithë kohës.
- Inspektoratet dhe policitë përkatëse duhet të jenë të pranishme gjatë vlerësimit dhe përballimit të situatës së krijuar.
- Sipas situatës, mund të kërkohet prania e skuadrave shumë të specializuara të kërkim-shpëtimit për të nxjerrë njerëzit e bllokuar nga fatkeqësia.
- Duhet të merret në konsideratë edhe evakuimi i shpejtë për në objektet shëndetësore i personave që kanë nevojë për trajtime të ndryshme, duke përfshirë djegiet ose komplikacione të tjera të cilat janë planifikuar në mënyrë specifike.
- Kërkohet vlerësim i menjëhershëm teknologjik për të përcaktuar efektet reale dhe potenciale, duke përfshirë edhe ndotjen e mjedisit.
- Shkaku fillestar i ngjarjes duhet të stabilizohet dhe të bëhet i sigurt ose më i sigurt se përpara ndodhjes së fatkeqësisë. Skenari i përsëritjes duhet të shmanget.
- Efektet dytësore duhet të minimizohen, duke synuar koordinimin më të mirë të mundshëm të strukturave dhe të institucioneve të përfshira.
- Shërbimi shëndetësor, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit mund të kërkojnë mbështetje shtesë të menjëhershme. Burimet e mundshme të mbështetjes duhet të jenë element kyç në planet e gatishmërisë në nivel lokal dhe kombëtar.

A.6-5 Faktorët që duhet të merren parasysh në fazën e Rikthimit në Gjendjen Normale

- Popullsia e evakuuar duhet të mbahet e informuar mbi rreziqet derisa kthimi të jetë i sigurt. Këtu përfshihen rreziqe, si ai i lidhur me zonat e kontaminuara.
- Sipas situatës, mund të ketë raste kur një popullsi e ka pasur të pamundur të kthehet në shtëpi e siguruar dhe, në këto raste, duhet të parashikohen mundësi alternative të përshtatshme.
- Është shumë e rëndësishme të vlerësohen ndikimet e konsiderueshme në numër, ndikimet afatgjata mjedisore dhe ndikimet mbi kafshët e egra, gjënë e gjallë, burimet ujore dhe të mbjellat.

A.7 Sulmi Terrorist

Duhet të theksohet se Shqipëria nuk ka përjetuar ndonjë sulm terrorist dhe, në përgjithësi, nuk konsiderohet si vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Sidoqoftë, ngjarjet e sulmeve terroriste janë rritur. Përvojat e fundit në Kenia, Spanjë dhe Turqi demonstrojnë se ky rrezik është me evident se më parë. Në këtë shtojcë është dhënë një përshkrim i përgjithshëm që lidhet me sulmet terroriste.

A.7-1 Karakteristikat bazë

- Ekspertiza për aktet terroriste dhe parandalimi i tyre realizohet nëpërmjet një pune shumë të specializuar ku përfshihen shërbimet sekrete, njësi të specializuara të policisë dhe të forcave të armatosura dhe shpesh edhe rrjete ndërkombëtare të specializuara. Si rezultat, këto çështje janë jashtë përgjegjësive dhe parametrave të punës së atyre që merren me çështjet e emergjencave civile.
- Sidoqoftë, në rast të ndodhjes së ndonjë akti terrorist mbi objekte ose mbi njerëz, atëherë janë mekanizmat e përballimit të emergjencave civile, të cilët duhet të përgjigjen në të njëjtën mënyrë, si në rastet e fatkeqësive natyrore.
- Eksplozionet mund të kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të grupeve të kërkim-shpëtimit dhe menaxhimin e të dëmtuarve në masë për të shpëtuar jetët e njerëzve në të njëjtën mënyrë si dhe në rastin e një tërmeti të vogël. Në mjaft situata kërcënuese terroriste janë dashur evakuime të shpejta dhe masive të njerëzve për t'i siguruar ata nga kërcënimet e mundshme, madje edhe nga një paralajmërim.
- Megjithatë, ka faktorë të veçantë shtesë që duhet të merren parasysh, duke përfshirë sulmet dytësore pas një sulmi që, nga pamja e jashtme, duket si kryesor, si dhe ngjarje jo të zakonshme, si për shembull sulmet me armë të shkatërrimit në masë (ASHM), për të cilat nuk ka shumë përvojë.
- Duke u nisur nga natyra e tyre, sulmet terroriste zakonisht ndodhin pa paralajmërim ose me një lajmërim në çastin e fundit, por mund të pasohen nga një numër ngjarjesh të lidhura dhe ndonjëherë të koordinuara që shkaktojnë panik dhe strese të mëdha.

A.7-2 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Parandalimit dhe Lehtësimit

- Parandalimi është detyrë e strukturave dhe e institucioneve të specializuara.
- Sidoqoftë, detyra për të koordinuar strukturat për përballimin e emergjencave civile do të jetë kurdoherë detyrë e strukturave të shërbimit të emergjencave civile.
- Si rezultat, koordinimi për përballimin e situatës mbetet çelësi, ndërkohë që rrjedha koherente e informacionit dhe fushatat e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe të strukturave përkatëse janë kurdoherë të domosdoshme. Në këtë mënyrë duhet të inkurajohen strukturat përkatëse dhe publiku i gjerë që të jenë sa më të përgatitur për çdo emergjencë civile duke bërë që të lehtësojnë ndikimin mbi jetën dhe pronën.
- Sulmet terroriste janë të paparashikueshme, kështu që, për përballimin e tyre, parapëlqehet të planifikohet në të njëjtën mënyrë si për çdo emergjencë civile tjetër, në mënyrë që të jetë e mundur të kalohet në këto plane, nëse një situatë e tillë bëhet realitet. Procedurat e evakuimit, planet, informimi i publikut, identifikimi i strehimit të sigurt dhe asistencë humanitare për emergjencat, mbështetja logjistike dhe të gjitha përgjegjësitë e tjera të lidhura me to duhet të merren nga seksioni i përballimit të PKEC-së dhe nga planet e emergjencave/gatishmërisë të përgatitura në nivel rajonal dhe lokal.

A.7-3 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Përgatitjes dhe të Mbrojtjes

- Sulmet terroriste shpesh nuk kanë paralajmërim të hershme, megjithëse mund të ndodhë të bëhen lajmërimet me telefon në minutën e fundit. Në rast të tillë, mobilizimi i shpejtë i forcave operacionale duhet të aktivizojë strukturat përkatëse si dhe për rastet e fatkeqësive natyrore. Zakonisht përparësi kanë evakuimi i shpejtë dhe i sigurt si dhe izolimi i zonës së kërcënuar.
- Për ndërgjegjësim publik në lidhje me kërcënimet terroriste është e nevojshme të merret një vendim

nga instancat e larta qeveritare. Marrja e këtij vendimi për rritjen e gatishmërisë, pra rritja e vigjilencës dhe e njohurive të publikut mbi atë çfarë duhet të bëhet në raste të tilla, është me rëndësi shumë të madhe pasi në këtë mënyrë shpëtohen jetë njerëzish. Këto aktivitete duhet të bëhen në të njëjtën mënyrë si për rastet e tërmeteve ose të përmytjeve. Si rezultat, duhet të ndërmerren të gjitha aktivitetet për angazhimin e përbashkët të publikut dhe të institucioneve në këtë drejtim. Shkollat, administrata publike, spitalet, subjektet private, media lokale dhe publike duhet të angazhohen për të transmetuar mesazhe të thjeshta dhe koherente nëpërmjet të gjitha mjeteve të komunikimit, duke u bazuar në njoftimet zyrtare.

- Planifikimi për përballimin e emergjencave në nivel qendror dhe lokal, përfshirë edhe planet specifike të përgatitura për fatkeqësitë natyrore, do të aplikohet edhe në rastin e një akti terrorist. Meqenëse skenarët për emergjencat që mund të shkaktohen nga akte terroriste nuk mund të kenë terren të përcaktuar, për këto raste mund të zhvillohen tipa duke i kushtuar rëndësi përdorimit të stukturave në situata konkrete
- Praktikimi dhe testimi i planeve nëpërmjet stërvitjeve është me shumë vlerë edhe në një situatë sulmi terrorist.

A.7-4 Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Përgjigjes

- Veprimet e menjëhershme të kërkim–shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komunitetet e prekura, ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjarët, miqtë ose fqinjët.
- Trajtimi i menjëhershëm mjekësor do të nevojitet për t'ua ofruar të plagosurve. Një fatkeqësi e një përmase të madhe do të kërkojë angazhim të gjerë jo vetëm të kapaciteteve lokale, por edhe të atyre kombëtare.
- Bëhet, gjithashtu, edhe një vlerësim i shpejtë i sigurisë së objekteve si dhe për dëmet dhe nevojat më emergjente.
- Mbatja e rendit publik dhe dhënia e një informacioni të saktë janë shumë të rëndësishme për të vendosur qetësinë si dhe për të ulur pështjellimin e mëtejshëm që të mos shkaktohen viktima të tjera.
- Mund të jetë e nevojshme të evakuhet e gjithë popullsia nga zona e prekur ose nga zona të tjera që mund jenë nën rrezik të lartë. Në këtë situatë nevojitet mbajtja nën kontroll e rendit publik, dhënia e informacioneve të qarta, dhënia e mesazheve dhe e udhëzimeve për popullsinë si dhe informimi për zonat e sigurta të identifikuara më parë.
- Mund të kërkohen ose të ofrohen operacione ndërkombëtare të specializuara të kërkim-shpëtimit. Ardhja e skuadrave të kërkim-shpëtimit do të shoqërohet me kërkesa për transportin ajror dhe për mjetet e transportit rrugor gjatë përpjekjeve për t'i dislokuar ato në zonat e prekura sa më shpejt të jetë e mundur.
- Edhe gjatë trajtimit të menjëhershëm mjekësor dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit mund të vlerësohen rreziqet dytësore për objektet e dëmtuara.
- Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor, aeroportet, telekomunikacioni dhe infrastruktura tjetër duhet të vihen në funksion sa më shpejt dhe sa më mirë që të jetë e mundur, me gjithë kufizimet.
- Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të prishura, skuadrat e specializuara të kërkim-shpëtimit, pasi të sigurohen, duhet të fillojnë menjëherë operacionet. Pjesa më e madhe e personave që shpëtohen do të jetë gjatë 24-48-orëshit të parë pas ngjarjes.

A.7-5 Faktorët për t'u marrë parashysh gjatë Rikthimit në Gjendjen Normale

- Siguria, eliminimi i materialeve të rrezikshme ose pastrimi i zonës nga ndotjet si dhe sigurimi i strukturave të dëmtuara duhet të garantohen përpara se popullsia të kthehet e sigurt në zonën e prekur.
- Shërbimet publike bazë ku përfshihen uji i pijshëm, ujërat e zeza, përdorimi i rrugëve dhe furnizimi me energji duhet të sigurohen sa më shpejt të jetë e mundur.
- Duhet të merren vendime të shpejta në lidhje me objekte bazë publike (duke përfshirë ndërtesat e shkollave dhe të spitaleve) që mund të jenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë. Ndërtesat që nuk riparohen, duhet të prishen plotësisht dhe të merret në konsideratë zëvendësimi i tyre i përkohshëm ose i përhershëm.

- Duhet të merren vendime të shpejta për strehimin e sigurt të popullsisë së prekur. Mund të nevojitet që njerëzit të vazhdojnë të qëndrojnë në strehime të përkohshme edhe për njëfarë kohe.
- Një emergjencë e përmasave të mëdha shpesh shoqërohet me ndihmë ndërkombëtare ose mbështetje të mundshme financiare apo materiale. Për strukturat shtetërore, është e rëndësishme të vendoset ritmi i jetës ashtu siç ishte, të koordinohen në mënyrë efektive donacionet në bazë të nevojave parësore dhe të jenë vazhdimisht të informuara për të qenë në gjendje të refuzojnë donacionet jo të përshtatshme dhe /ose ofertat për mbështetje.

B. BAZA LIGJORE, FUNKSIONET DHE DETYRAT E INSTITUCIONEVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT (MBU)

Angazhimi i MBU-së në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave bazohet në detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 8756, datë 26.III.2001, “Për emergjencat civile”, si dhe në ligjet e mëposhtme:

- ligjin nr. 7623, datë 13.X.1992, “Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor”;
- ligjin nr. 7662, datë 19.I.1993, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”;
- ligjin nr. 7941, datë 31.V.1995, “Për ushqimin”;
- ligjin nr. 8681, datë 2.XI.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe të dambave”;
- ligjin nr. 7674, datë 23.II.2003, “Për shërbimin veterinar”.

MBU-ja, nëpërmjet strukturave të saja në qendër dhe në nivel lokal, ushtron funksionet dhe detyrat që lidhen me fushën e emergjencave civile, si:

- Mbrojtjen e pyjeve dhe të kullotave nga zjarret.
- Mbrojtjen e shëndetit të shtetasve nga përdorimi i ushqimeve.
- Mbrojtjen e tokës nga erozioni.
- Mbrojtjen e burimeve dhe të rezervave ujore.
- Mbrojtjen e kafshëve nga sëmundjet dhe parandalimin e përhapjes së tyre.
- Njohjen e vazhdueshme të situatës fitosanitare në kulturat bujqësore në shkallë kombëtare si dhe mbrojtjen e tyre.
- Garantimin e qëndrueshmërisë, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin sipas rregullave të rezervuarëve.
- Inspektimin e kushteve optimale të prodhimit, magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve ushqimore, blegtorale dhe bujqësore.
- Inspektimin e kushteve të magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të preparateve të mbrojtjes së bimëve.
- Ushtrimin e kontrollit në vendkalimet kufitare, për parandalimin e transmetimit të sëmundjeve në bimë dhe në kafshë.
- Udhëzimin e drejtuesve të strukturave qendrore në nivel lokal, në varësi të saj, për përfshirjen dhe angazhimin e tyre sipas planit të emergjencave civile në nivel lokal.
- Mirëmbajtjen, monitorimin dhe vënien në gatishmëri të sistemit të kanalizimeve, pritave, argjinaturave dhe sistemeve të pompimit.
- Riaftësimin e zonave të përmytura.

MBU-ja realizon detyrat e saja në bashkëpunim me:

- MIE-në, për garantimin e ritmikës së furnizimit me energji elektrike të hidrovoreve dhe riparimin e shpejtë të defekteve në to.
- MRRTT-në dhe MIE-në, për kontrollin, inspektimin dhe ndërhyrjen e kualifikuar në digat e ujëmbledhësve dhe dambat.
- MPVD-në (PMNZSH) dhe Ministrinë e Mbrojtjes për fikjen e zjarreve në pyje.
- M M-në dhe biznesin privat për lëvizje masive dherash dhe gërmime.
- MSH-në dhe institucione të tjera kërkimore shkencore për trajtimin e zonave të infektuara me rrezik për bimët, kafshët dhe që rrezikojnë transmetimin tek njerëzit.
- MPVD-në dhe organet e qeverisjes vendore për vlerësimin e gjendjes, përcaktimin e zonave të rrezikuara nga përmytjet, shpërthimet e digave të ujëmbledhësve, me qëllim planifikimin e evakuimit në kohë të popullsisë së kërcënuar.
- Me MF-në, MSH-në për kontrollin e ushqimeve dhe garantimin e konsumit të tyre.
- Me MMj-në për kontrollin e ndotjes së ujërave.

MINISTRIA E MBROJTJES (MM)

Ministria e Mbrojtjes, me strukturat dhe kapacitet e saja, konsiderohet burimi me potencial aktiv dhe mbështetës në operacionet për përballimin e emergjencave civile me detyra në të gjitha fazat e ciklit të emergjencave. Roli i saj përcaktohet në ligjin nr. 8756, datë 26.III.2001, “Për emergjencat civile”, PKEC-në, si dhe në:

- ligjin nr. 8671, datë 26.X.200? “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
- ligjin nr.7978, datë 26.VII.1995, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- dokumentin e strategjisë ushtarake;
- doktrinën e përgjithshme ushtarake;
- Planin Kombëtar tëVeprimit për Anëtarësim në NATO;
- direktivën e mbrojtjes.

Ministria e Mbrojtjes:

- Merr pjesë në kërkim-shpëtimin, evakuimin, trajtimin e popullsisë së dëmtuar dhe rikthimin në zonat e tyre të banimit pas qetësimit të situatës, në bashkëpunim me MPVD-në, ministritë e tjera dhe organet e pushtetit vendor.
- Për bashkërendimin e dhënies së ndihmës në det, nëpërmjet rojës bregdetare dhe, në raste të aksidenteve ajrore, nëpërmjet shërbimit SAR.
- Në rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga veprime terroriste me përdorimin e lëndëve helmuese, bakteriologjike e radioaktive si dhe aksidentet industriale, bashkëpunon me ministritë përkatëse duke angazhuar repartet e specializuara për:
 - identifikimin e materialeve të përdorura;
 - izolimin e zonës, trajtimin e mëtejshëm të personave dhe të viktimave të infektuara;
 - dhënien e ndihmës mjekësore;
 - pastrimin e zonës nga ndotjet dhe të personave të infektuar.
- Në rastet e emergjencave të tjera, MM-ja siguron dhe vë në dispozicion:
 - grupe të kërkim –shpëtimit për të gjitha llojet e operacioneve;
 - shërbim shëndetësor të specializuar;
 - mjete të nevojshme të transportit masiv;
 - mjete të transportit ajror;
 - mjete gjurmimi dhe transportimi të materialeve;
 - mjete dhe forca për shuarjen e zjarreve;
 - logjistikë tjetër të nevojshme për të ndihmuar në operacionet e zhbllokimit të rrugëve, si dhe detyra të tjera në rindërtimin e rrugëve, urave, ujësjellësve etj.;
 - rrjetin e saj të informacionit dhe të telekomunikimit;
 - instalime të përhershme dhe provizore për strehim masiv të popullsisë.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË (MSH)

Ministria e Shëndetësisë është institucioni me rolin kryesor në kujdesin shëndetësor dhe mjekësor në emergjencat e çdo lloji dhe ka detyra në të gjitha fazat: në parandalim, lehtësim, përgjigje dhe riaftësimin e zonave të goditura. Funkzionet e saja realizohen në mbështetje të ligjit nr. 8756, datë 26.III.2001, “Për emergjencat civile”, Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, si dhe të akteve të tjera ligjore, si:

- ligjit nr.7693, datë 2. XII. 1992, “Për inspektoratin sanitar shtetëror”;
- ligjit nr. 7761, datë 19.X.1993, “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”;
- ligjit nr. 9106, datë 17.VII. 2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”;
- ligjit nr. 8032, datë 16.XI.1995, “Për shërbimin e transfuzionit dhe të kontrollit të gjakut, të produkteve të tija dhe të transplanteve”.

MSH-ja realizon bashkëpunimin e të gjitha strukturave shëndetësore të niveleve të ndryshme, si dhe të biznesit privat në fushën e shëndetësisë për:

- ndihmën e parë mjekësore dhe të urgjencës për të dëmtuarit;
- përkujdesjen shëndetësore në të gjitha nivelet për shtetasit e dëmtuar;
- krijimin e ekipeve shëndetësore të emergjencës;
- garantimin e rezervës farmaceutike për raste të emergjencave masive;
- parandalimin e sëmundjeve infektive;
- trajtimin e të kontaminuarve me materiale radioaktive;
- shpalljen e gjendjes së karantinës shëndetësore;
- menaxhimin e operacioneve të evakuimit të pacientëve nga spitalet e dëmtuara;
- evakuimin e të dëmtuarve në spitale të tjera jashtë zonës së dëmtuar;
- garantimin e transportit tokësor dhe ajror të personave të dëmtuar;
- garantimin e pajisjeve shëndetësore shtesë dhe gjakut rezervë;
- trajtimin e viktimave të infektuara;
- kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe të përdorimit familjar si dhe trajtimin etj.
- furnizimin ritmik me ushqime të pacientëve,
- kontrollin dhe ruajtjen e higjienës shëndetësore;
- trajtimin e zonave të ndotura;
- dhënien e asistencës për strukturat që trajtojnë popullsinë e strehuar në vendstrehime kolektive të përkohshme;
- kontrollin e barnave mjekësore në kufi, shpërndarjen dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Në kryerjen e detyrës së saj, MSH-ja bashkëpunon ngushtë me:

- MM-në, për vënien në dispozicion të ekipeve mjekësore, spitaleve dhe klinikave ushtarake të përhershme dhe fushore, transportin e pacientëve, aplikimin e regjimit të karantinës, trajtimin e viktimave, transportin ajror dhe tokësor, furnizimin me ushqime shtesë si dhe, në rastet e emergjencave shkaktuar nga armët e shkatërrimit në masë, për trajtimin e specializuar të personave të kontaminuar.
- KSSH-në, për dhënien e ndihmës së parë, trajtimin dhe përkujdesjen e mëtejshme të të dëmtuarve, mundësinë e sjelljes në Shqipëri të ekipeve mjekësore ndërkombëtare, furnizimin, shpërndarjen me racione ushqimore dhe barna nga ndihmat.
- MPVD-në dhe organet e qeverisjes vendore, për identifikimin dhe regjistrimin e pacientëve që do të evakohen jashtë zonës së dëmtuar.
- MRP-në, për ruajtjen e zonave të infektuara, garantimin e shpejtë të transportit të urgjencës, për sigurinë në spitale e klinika, për trajtimin e personave të ndaluar.
- MD-në, për ndihmë mjekësore në burgjet.
- MPJ-në, për identifikimin, trajtimin e personave të lënduar apo të viktimave të cilët janë shtetas të huaj, si dhe për lehtësimin procedurave për ekipet ndërkombëtare të ndihmës mjekësore dhe spitaleve fushore.

MINISTRIA E RENDIT PUBLIK (MRP)

MRP-ja luan rol parësor në emergjencat e shkaktuara nga aktet terroriste të çdo lloji. Ajo angazhohet në të gjitha emergjencat e tjera të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore apo nga njeriu. Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e saja burojnë nga detyrimet në ligjin nr. 8756, datë 26.III.2001, "Për emergjencat civile" dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore si:

- ligji nr. 8553, datë 25.XI.1999, "Për Policinë e Shtetit" dhe
- "Rregullorja e drejtimit operativ dhe e emergjencave për Policinë e Shtetit", nr. 1604, datë 22.XII.2001.

MRP-ja planifikon dhe bashkërendon përdorimin e strukturave të saja me strukturat e tjera në operacionet e emergjencave civile. Strukturat e Ministrisë dhe të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me strukturat e tjera, kryejnë aktivitetet, si:

- kërkim- shpëtim;
- dhënie të ndihmës së parë;
- evakuim dhe, sigurim të zonës;
- ruajtje dhe izolim të zonës;
- ruajtje të rendit dhe të qetësisë;
- garantim të qarkullimit normal në akset rrugore;
- ruajtje dhe kontroll të kufijve;
- bashkëpunim në veprimet e mëtejshme hetimore;
- shoqërim i mjeteve të evakuimit, urgjencës dhe i ndihmave humanitare;
- vënie në dispozicion të operacioneve në zonat e dëmtuara, mjete, materiale dhe burime njerëzore;
- ndihmë në informim dhe radiokomunikim;
- organizim shërbimi të përforcuar në të gjitha objektet e rëndësishë së veçantë, si dhe në pikat e kalimit kufitar, porte, aeroporte si dhe në institucione qendrore;
- garantim i kushteve normale për ekipet e huaja të ndihmës dhe mediat që ushtrojnë aktivitetin në zonën e dëmtuar.

Në përballimin e emergjencave civile, MRP-ja bashkëpunon me:

- MPVD-në dhe organet e pushtetit vendor, për operacionet e evakuimit dhe kërkim-shpëtimin.
- MM-në, për ekspertizë të specializuar për natyrën e materialeve të përdorura në aktet terroriste, futjen e forcave të specializuara në operacionet e kërkim- shpëtimin, angazhimin e mjeteve në hapjen dhe sigurimin e rrugëve,
- MSH-në, për dhënie të ndihmës së parë shëndetësore dhe për trajtimin e metejshëm të të dëmtuarve, me organet e qeverisjes vendore për identifikimin e viktimave etj.

MINISTRIA E MJEDISIT (MMj)

Duke qenë se fatkeqësitë natyrore të çdo lloji lënë pasojë të rënda edhe në mjedis, aq më tepër kur disa prej tyre shkaktohen nga materiale të rrezikshme, MMj-ja ka rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave. Aktiviteti i saj bazohet në ligjin nr. 8756, datë 26.III.2001, “Për emergjencat civile” dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, si:

- ligjin nr. 8934, datë 5.IX.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- ligjin nr. 9115, datë 24.VII.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”;
- ligjin nr. 8897, datë 16.V.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- VKM-në nr. 103, datë 31.III.2002, “Për monitorimin e mjedisit në RSH”;
- ligjin nr. 9010, datë 1.III.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.

Ministria e Mjedisit:

- Luan rol parësor në vlerësimin paraprak të situatave që bëhen shkak për të kaluar në një emergjencë mjedisore të përmasave të mëdha, me pasojë për mjedisin në përgjithësi, jetën e shtetasve, gjënë e gjallë, pronën private dhe publike dhe trashëgiminë kulturore.
- Angazhon struktura monitoruese informuese dhe struktura mbështetëse aktive, gjë që kërkon ekipe dhe struktura të specializuara ndërkombëtare në bazë të konventave dhe të marrëveshjeve dypalëshe.
- Siguron asistencën teknike për grupet e ndërhyrjes, pritjen dhe shoqërimin e tyre.
- Udhëzon drejtuesit e strukturave qendrore në nivel lokal në varësi të saj, për angazhimin e tyre në përballimin e emergjencave civile në nivel lokal.

Bashkërendon aktivitetet me:

- MPVD-në dhe organet e qeverisjes vendore, për evakuim të menjëhershëm.
- MSH-në, për përgatitjen dhe ndërhyrjen e strukturave shëndetësore.
- MIE-në, në rast të aksidenteve industriale dhe të atyre me prani lëndësh të rrezikshme, hidrokarburesh.

- MM-në, për rastet e rreziqeve nga shpërthimet, lëndët helmuese të veprimit në masë.
- MM-në, MSH-në dhe ASH-në, për prani të rënduar radioaktiviteti.
- MBU-në, për ndotje të mjedisit në ujërat e brendshme dhe zjarret në pyje.
- MTT-në, MM-në dhe MRP-në dhe organet e qeverisjes vendore, për ndotje masive të mjedisit në ujërat dhe brigjet e detit Adriatik dhe Jon.
- MRRTT-në, në rastet e ndotjeve masive nga mbetjet urbane.
- ME-në, MF-në, për rastet kur shkak për ndotjen e mjedist bëhen importimi/ eksportimi, transporti, magazinimi dhe përdorimi i materialeve të rrezikshme.

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT (MTT)

MTT-ja zbaton detyrat dhe funksionet e saja në përputhje me ligjin nr. 8756, datë 26.III.2001, “Për emergjencat civile” dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij si dhe:

- ligjin nr. 9096, datë 3.VII.2003, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.III.1998, “Për transportin rrugor”;
- ligjin nr. 8378, datë 22.VII.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”;
- ligjin nr. 9251, datë 8.VII.2004, “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”;
- ligjin nr. 7224, datë 22.VI.1988, “Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”;
- ligji nr. 8038, datë 23.XI.1995, “Për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë”;
- ligjin nr. 8530, datë 23.IX.1995, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit kryen këto funksione:

- Përballon problemet e mirëmbajtjes dhe të ndërtimit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore.
- Bashkërendon veprimtaritë e operatorëve të komunikimit për garantimin e komunikimit me zonat e dëmtuara dhe të të gjitha subjekteve të përfshira në operacionet e përgjigjes. Garanton komunikimin me tarifa të ulëta për këto struktura në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe të ndihmës mjekësore.
- Përgjigjet për angazhimin, menaxhimin e mjeteve të transportit për evakuim dhe transport mallrash deri në magazinimin e tyre, në bashkëpunim me MPVD-në, organet e pushtetit vendor dhe biznesin privat.
- Në rastet e aksidenteve të rënda tokësore, ajrore e detare dhe operacionet e kërkim- shpëtimit në zonat e vështira, bashkëpunon me MRP-në dhe MM-në.
- Përgjigjet për funksionimin normal të porteve dhe të strukturave të ngarkim- shkarkimit, përpunimin e mjeteve detare të ndihmave me procedurë të përsheptuar (e ndihmuar nga MF-ja dhe MJ-ja), garantimin e qarkullimit të mjeteve që dërgojnë në destinacion ndihmat (në bashkëpunim me MRP-në).
- Bashkëpunon me MM, MRP, MPVD dhe MSH, në rastet e aksidenteve në det, për operacionet e dhënies së ndihmës urgjente, të ndihmës mjekësore, akomodimin dhe dërgimin në destinacion të personave të dëmtuar dhe viktimave.
- Luan rol parësor, në bashkëpunim me MM-në dhe MRP-në, në rastet e aksidenteve ajrore si dhe në zbatimin e veprimeve dhe të procedurave në bazë të normave dhe të konventave ndërkombëtare dhe përgjigjet për informimin e agjencive dhe të shoqërive të transportit ajror për kapacitetet dhe regjimet e fluturimeve të avionëve dhe menaxhimin e procedurave në aeroporte.
- Bashkëpunon me MIE-në për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të mjeteve të ngarkim-shkarkimit elektrike.
- Kërkon ndihme të specializuar logjistike edhe nga shtete dhe organizata të huaja, në bazë të konventave ndërkombëtare.

MINISTRIA E INDUSTRIË DHE ENERGJITIKËS (MIE)

Detyrat e MIE-së në fushën e emergjencave civile bazohen në ato që përcakton ligji nr. 8756, datë 26.III.2001, “Për emergjencat civile” dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore, si:

- ligjin nr. 9126, datë.29.VII.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse”;
- ligjin nr. 8741, datë.15.II.2001, “Për sigurimin në punë në veprimtarinë minerare”;
- ligjin nr. 7664, datë.21.I.1993, “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- ligjin nr. 8736, datë 12.II.2001, “ Për garantimin e sigurisë në punë të pajisjeve në presion”;
- ligjin nr.7796, datë.17.II.1994, “Për minierat në Shqipëri”.

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës:

- Luan rol parësor në paralajmërimin, lehtësimin, përballimin e emergjencave civile të shkaktuara nga aksidentet në sistemin e industrisë, në sistemin e minierave dhe në atë të energjetikës si dhe bashkëpunon në rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga fatkeqësi të tjera.
- Organizon sistemin e lajmërimit dhe të ndërhyrjes së strukturave të gatshme në aksidentet industriale të lidhura me shpërthime eksplozivi, çlirime gazrash helmuese, rrjedhje të reaktivëve kimikë të rrezikshëm për banorët, gjënë e gjallë dhe mjedisin.
- Bashkëpunon me struktura të gatshme të shërbimit zjarrfikës dhe shpëtimin, shërbimin e urgjencës shëndetësore, shërbimet e Policisë së Shtetit dhe organizon teknikisht ndërhyrjen e strukturave operacionale.
- Bashkëpunon me ministritë përkatëse për evakuimin e popullsisë, dhënien e ndihmës mjekësore, për kufizimin e zonës së prekur nga aksidenti, me MMj-në për vlerësimin e ndotjes dhe marrjen e masave për riaftësimin e zonës.
- Në rastet e aksidenteve të ndodhura në miniera, rrëshqitjeve masive të tokës si dhe fundosjeve tektonike, vepron me grupet e saja vlerësuese dhe avaroshpëtuese.
- Menaxhon sistemin e prodhimit, të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, të menaxhimit dhe të ruajtjes së objekteve të veçanta, organizon sistemin e paralajmërimit për rrezikun nga shpërthimet e digave, menaxhon sistemin e shkarkimeve masive nga hidrocentralet dhe garanton prodhim të pandërprerë të energjisë elektrike, si dhe informimin e publikut për ndërprerjet e planifikuara.

MINISTRIA E RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT (MRRTT)

Detyrat e MRRTT-së në fushën e emergjencave civile bazohen në ligjin nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile” dhe në:

- ligjin nr. 8093, datë 21.III.1996, “Për rezervat ujore”;
- ligjin nr. 8681, datë 2.XI.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin e digave dhe të dambave”;
- ligjin nr. 9232, datë 13.V.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”;
- ligji nr. 8402 datë 10.IX.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”;
- ligjin nr.8405 datë 17.IX.1998, “Për urbanistikën”;
- ligjin nr. 8934, datë 5.IX.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- ligjin nr. 9010, datë 11.II.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”;
- ligjin nr. 8094, datë 21.III.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”;
- ligjin nr. 8408, datë 25.IX.1998, “Për policinë e ndërtimit”;
- ligjin nr. 7893, datë 22.XII.1994, “Për shkencat dhe zhvillimin teknologjik”.

MRRTT-ja:

- Siguron mbështetjen dhe organizon vlerësimin e dëmeve dhe të qëndrueshmërisë në objektet e banimit, në ujësjellës, kanalizime dhe objekte publike.
- Siguron mbështetjen për garantimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe cilësinë e tij.

- Miraton planet për ndërtimet me karakter të përkohshëm. Këshillon dhe jep ndihmesën e saj në menaxhimin e mbetjeve urbane në raste të emergjencave civile.
- Siguron informacion dhe mbështetje për turistët dhe zonat turistike gjatë situatës emergjente.
- Bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore dhe institucione të tjera për sigurimin e sipërfaqeve të nevojshme për varreza masive, në rastet kur, si rezultat i fatkeqësive të mëdha, do të kemi viktima në masë.

Për realizimin e përgjegjësive dhe të funksioneve të saja, MRRTT-ja bashkëpunon me:

- MM-në, në detyra inxhinierike dhe në evadimin masiv dhe të organizuar të mbetjeve urbane.
- MBU-në, në përcaktimin e rrezikshmërisë së baseneve, për riparimin e tyre dhe për devijimet e shtretërve të lumenjve, si dhe ato që lidhen me digat.
- MIE-në, për vlerësimin dhe përcaktimin e masave të menjëhershme për t'u mbrojtur nga rreziku i shpërthimit të digave dhe të dambave.
- MSH-në, për vlerësimin dhe trajtimin e ujit të pijshëm dhe trajtimin e viktimave.
- MMj-në, për ndotjen e mjedisit nga mbetjet urbane, materialet inerte dhe përcaktimin e territoreve ku ato do të evadohen.
- Institucione të tjera shkencore, për hartimin e projekteve të zhvillimit dhe përcaktimin e kritereve dhe të standardeve që do të ulin cenueshmërinë e objekteve në fatkeqësi të tjera.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS (MASH)

Funksionet e MASH-it bazohen në detyrat e ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile" dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore:

- ligjit nr. 8872, datë 29.III.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë";
- ligjit nr. 8461, datë 25.II.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".

MASH-i:

- Angazhohet në përgjigjen ndaj emergjencave, si strukturë mbështetëse. Harton dhe zbaton programet e edukimit, të trajnimit dhe planet e gatishmërisë dhe vepron në bazë të tyre në situatat e emergjencave civile.
- Në bashkëpunim me MSH-në dhe MM-në, ndihmon në dhënien e ndihmës së parë mjekësore nëpërmjet angazhimit të institucioneve shkollore dhe universitare mjekësore.
- Në bashkëpunim me MTT-në, MM-në, MRP-në dhe biznesin privat bashkëpunon për organizimin dhe përkujdesjen për nxënësit dhe studentët gjatë operacioneve të transportit dhe avakuimit të tyre. Me MPVD-në dhe KKSH-në bën regjistrimin e nxënësve dhe të studenteve të evakuar dhe dërgimin e tyre pranë familjeve.
- Bashkëpunon me MSH-në për dhënien e ndihmës së parë, për transportimin në mjedise spitalore, për krijimin e kushteve higjieno - sanitare të përshtatshme për persona të strehuar në mjedise shkollore/konvikte, si dhe angazhimin e grupeve të studentëve në shërbim të kujdesit shëndetësor.
- Në bashkëpunim me MRRTT, MTT, MBU, MPVD, prefektët e qarqeve dhe organet e qeverisjes vendore, angazhon stafet pedagogjike të specializuara, studentët dhe nxënësit e viteve të larta në detyrat vlerësuese, punë publike si dhe në teste lidhur me nevojat për përballimin e emergjencave civile.
- Në bashkëpunim me MF-në, MPVD-në dhe organet e qeverisjes vendore, punon për sigurimin e fondeve për riparimin e godinave shkollore, si dhe programimin e vazhdimin të mësimave në mjedise të tjera.

MINISTRIA E PUNËS DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE (MPCS)

Bazë ligjore në veprimtarinë e MPÇS-së, përveç ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, janë:

- ligji nr. 69 datë, 11.II.1999, “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë”;
- ligji nr. 7703, datë 11.V.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- ligji nr. 7710, datë 18.V.1993, “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”;
- ligji nr. 7995, datë 20.IX.1995, “Për nxitjen e punësimit”.

Ministria, në bashkëpunim me ministritë e tjera dhe institucionet:

- Programon dhe krijon një sistem mbrojtjeje dhe trajtimi financiar, punësimi, përkrahjeje dhe përkujdesjeje shoqërore për shtetas që, si pasojë e emergjencave civile, masivisht humbasin strehimin, vendin e punës.
- Ndhmon në dhënien e ndihmës së parë të dëmtuarve në objektet e varësisë së saj.
- Ndhmon në evakuimin e personave nga qendrat e përkujdesjes (azile dhe shtëpitë e fëmijëve) dhe krijimin e kushteve higjieno-sanitare në strehimet e përkohshme.
- Ndhmon në strehimin e përkohshëm të këtyre personave dhe përkujdesjen e mëtejshme të tyre.
- Mbështet fillimin e operacioneve të kërkim - shpëtimit për persona të mbetur nën rrënoja, të humbur e të zhdukur.
- Bën evidentimin, organizimin dhe përfshirjen e grupeve të personave si të papunë në punë publike gjatë gjendjes së emergjencave civile dhe sigurimin e financimit të tyre.
- Realizon sigurimin e asistencës sociale për persona të traumatizuar.
- Bën nxitjen e programeve të zhvillimit për biznesin.
- Angazhon OJF-të në dhënien e ndihmës për zonat e dëmtuara.
- Vë në dispozicion listën e grupeve/personave të paracaktuar për punë publike dhe specialiteteve të ndryshme dhe së bashku me organet e qeverisjes vendore përkujdeset për regjistrimin dhe trajtimin e personave që do të strehohen në familje të tjera.

MINISTRIA E FINANCAVE (MF)

Detyrimet e MF-së në përballimin e emergjencave civile burojnë nga ligji nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile” dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, si:

- “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 8449, datë 27.I.1999;
- ligji nr. 8901, datë 23. V.2002, “Për falimentimin”;
- ligji nr.8081, datë 7.III.1996, “ Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”;
- ligji organik i buxhetit, nr. 8379, datë 29.VII.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”;
- ligji nr. 8560, datë 22.XII.1999, “Për procedurat tatimore”;
- ligji nr. 7928, datë 27.IV.1995, “ Për tatimin mbi vlerën e shtuar”;
- ligji nr. 7979, datë 26.VII.1995, “ Për fondet e investimeve”;
- ligji nr. 8873, datë 29.III.2002, “Për sigurimin e depozitave”;
- ligjin nr. 8210, datë 23.IV.2002, “Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të ndihmave humanitare dhe të emergjencës”.

Roli i MF-së në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave lidhet me menaxhimin e burimeve financiare, zbatimin e procedurave ligjore në dogana dhe kontrollin e aktiviteteve tregtare kur është shpallur gjendja e emergjencave civile.

MF-ja ka përgjegjësi për:

- Parandalimin e importit, eksportit, kalimit transit, depozitimit, prodhimit, tregtimit të materialeve dhe produkteve të ndaluara.

- Krijimin e kushteve, lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurave doganore për mallra, materiale, grupe, individë, si dhe pajisjet e tyre, kur vërtetohet se ardhja e tyre është në funksion të përballimit të emergjencave civile.
- Favorizimin dhe mbështetjen e krijimit dhe të përdorimit me efikasitet të bazës së duhur materiale për rastet e emergjencave civile, nëpërmjet lehtësimit të procedurave doganore dhe tatimore.
- Parashikimin dhe ndërhyjen në buxhetin vjetor të planifikuar, me synim gjetjen e fondeve të nevojshme për përballimin e detyrave shtesë që rrjedhin nga aktivitetet e institucioneve në gjendjen e emergjencave civile.
- Programimin dhe ndryshimin e buxhetit vjetor në funksion të realizimit të shpejtë të investimeve bazë për kthimin në normalitet të aktivitetit jetësor në zonat e dëmtuara.
- Marrjen e masave parandaluese në bashkëpunim me Bankën Kombëtare të Shqipërisë, për të garantuar stabilitet në inflacion dhe për të parandaluar kolapse financiare.

Për realizimin e këtyre detyrave, MF-ja bashkëpunon me të gjitha ministritë e përfshira në këtë plan dhe institucionet e tjera vartëse, si dhe me organet e qeverisjes vendore dhe biznesin privat.

MINISTRIA E PUSHTETIT VENDOR DHE DECENTRALIZIMIT (MPVD)

MPVD-ja, duke qenë se ka rolin kryesor në bashkërendimin e të gjitha institucioneve qendrore dhe lidhjen e tyre me organet e qeverisjes vendore, është institucioni i cili angazhohet në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave. Baza ligjore për funksionet dhe detyrat e saja në lidhje me emergjencat civile janë:

- ligji nr. 8756, datë 26.III.2001, “Për emergjencat civile”;
- ligji nr. 8766, datë 5 .IV.2001, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”;
- vendimi nr.531, datë I.VIII.2003, “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile”;
- vendimi nr.654, datë 18.XII.2002, “ Për përdorimin e përkohshëm të tarifave nga organet shtetërore, në situata emergjente të çdo mjeti privat”;
- vendimi nr.664, datë 18.II.2002 “ Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjëndjes së emergjencave civile ”;
- vendimi nr.663, datë 18.XII.2002 “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e komisionit tekniko-këshillimor të specialistve për emergjenca”;
- vendimi nr. 532, datë I.VIII.2003, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e departamentit të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile”;
- vendimi nr.533, datë I.VIII.2003 “Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile”.

MPVD-ja:

- Bashkërendon veprimet e institucioneve, të strukturave monitoruese, informuese, planizuese dhe reaguese në nivel qendror dhe atë lokal, KKSJ-së, vullnetarëve, donatorëve dhe organeve të qeverisjes vendore.
- Menaxhon sistemin qendror të mbledhjes dhe të dhënies së informacionit për emergjencat nëpërmjet DPPEC-së (QKOEK-së), si dhe krijon kushte normale pune për KNEC-në dhe DQO-në dhe stafin e tyre ndihmës.
- Bashkërendon veprimtarinë e grupeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-shpëtimin, të grupeve të vlerësimit të dëmeve dhe të nevojave. Administron ndihmën humanitare, përcakton rregullat e marrjes në dorëzim dhe të lëvrimit të saj si dhe të donacioneve financiare.
- Përgatit dhe propozon kërkesat për ndihmë nga organizata dhe shoqata të specializuara ndërkombëtare, si dhe merr masa për sistemimin dhe menaxhimin e ndihmës së ofruar.
- Bashkërendon veprimtarinë e prefektëve të qarqeve dhe të organeve të qeverisjes vendore, me ministri dhe institucione të tjera sipas përgjegjësi të përcaktuara në këtë plan dhe monitoron procedurat e evakuimit dhe mbështetjen e këtij operacioni.
- Bashkërendon punën për sigurimin e strehimeve provizore për popullsinë e evakuuar.
- Bashkërendon punën për sigurimin dhe dërgimin në destinacion si dhe shpërndarjen e artikujve

- ushqimorë dhe të artikujve të tjerë të ndihmës.
- Organizon mbështetjen për fëmijët e mbetur pa prindër dhe personat pa familje, në bashkëpunim me KKSJH-në dhe MRP-në.
- Organizon sistemin e regjistrimit të popullsisë së lëvizur nga vendbanimet e përhershme, regjistrimin e personave të vdekur, të humbur dhe të zhdukur.
- Kujdeset për garantimin e shërbimeve dhe të nevojave bazë të popullsisë së dëmtuar.
- Krijon struktura të përkohshme në marrjen dhe përpunimin e informacioneve.

MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTEVE (MKRS)

Detyrimet ligjore të MKRS-së për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile, përveç bazës ligjore për emergjencat civile, bazohen në:

- ligjin nr. 9048, datë 7.IV.2003, “ Për trashëgiminë kulturore”;
- ligjin nr. 8114, datë 28.III.1996, “Për sportin”, me ndryshimet përkatëse.

Në rastet e emergjencave, MKRS-ja angazhohet në:

- Parandalimin, lehtësimin dhe riaftësimin e objekteve kulturore, të bibliotekave, të mjediseve sportive, si dhe në ruajtjen e vlerave të monumenteve të kulturës, prekur nga emergjenca.
- Merr masat e nevojshme dhe përcakton standardet/normat për ndërtimin dhe pajisjen e objekteve me sistemet e mbrojtjes nga fatkeqësitë.
- Gjatë emergjencave organizon evakuimin e spektatorëve dhe të popullsisë, evakuimin, sistemin dhe ruajtjen e materialeve të rëndësishme nga institucionet e saja, të vlerave kulturore dhe objekteve monumentale, ruajtjen e objekteve muzeale.
- Gjatë emergjencave angazhon grupe specialistësh në operacione specifike kërkim - shpëtimi.Vë në dispozicion mjediset sportive të mundshme për strehim kolektiv të përkohshëm.
- Organizon aktivitete për largimin e stresit të shtetasve të dëmtuar.
- Pas mbarimit të emergjencës, bën rindërtimin e objekteve socialkulturore.

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME. (MPJ)

Në gjendje të qetë dhe gjatë gjendjes së emergjencave civile, Ministria e Punëve të Jashtme krijon lidhjet e nevojshme me shtete, organizma dhe struktura të huaja, të cilat ofrojnë ndihmë të çdo lloji për përballimin e emergjencave civile.

Kjo ministri:

- Mundëson pajisjen me dokumente dhe procedura të përsheptuara vizash, për punonjësit e emergjencave të grupeve ndërkombëtare dhe pajisjet e tyre, nëse vijnë në territorin e vendit.
- Ndiemon në hyrjen pa pengesë dhe të përsheptuar të ndihmave humanitare.
- Kontakton me ambasadat e huaja për evidentimin, trajtimin dhe rikthimin në vendet e tyre të të huajve që, gjatë fatkeqësive të ndodhura në Shqipëri, dëmtohen ose vdesin.
- Merr informacion, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet me MPVD-në, si dhe ministri dhe institucione të tjera të përfshira gjatë përballimit të emergjencave civile.

MINISTRIA E DREJTËSISË (MD)

Në lidhje me emergjencat civile, Ministria e Drejtësisë vepron në bazë të ligjit “Për emergjencat civile” dhe legjislacionit tjetër që lidhet me fushën e veprimit të saj në raste të emergjencave.

Në bazë të planeve të gatishmërisë, angazhohet për:

- Nxjerrjen e akteve të veçanta për situata emergjente.
- Evakuimin e të burgosurve jashtë zonës së dëmtuar.

- Organizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në godinat e dëmtuara të burgjeve.
- Organizimin e ruajtjes së personave të burgosur në zonën e evakuimit.

Për detyrat e mësipërme Ministria e Drejtësisë bashkëpunon me të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet përkatëse.

MINISTRIA E EKONOMISË (ME)

Kjo ministri luan rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e emergjencave civile, veçanërisht në atë të parandalimit, të lehtësimit si dhe të rikthimit në gjendje normale të zonave të dëmtuara.

Në rastet e emergjencave, Ministria e Ekonomisë angazhohet në:

- Evidentimin e kompanive private dhe të burimeve të tyre njerëzore dhe mjeteve, që mund të vihen në dispozicion për përballimin e emergjencës civile, nëpërmjet Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe të Industrisë (UDHTI) dhe dhomave të tregtisë dhe të industrisë (DHTI) në rrethe.
- Grumbullimin e informacionit të nevojshëm lidhur me nevojat më emergjente të ndërhyrjeve me investime publike në infrastrukturën kritike, me qëllim programimin e financimit të tyre sipas përparësive, nga ministritë e linjës dhe organet e qeverisjes vendore drejtpërdrejt ose nëpërmjet MPVD-së.
- Përpunimin e informacionit të marrë nga ministritë e linjës dhe organet e qeverisjes vendore, për ndërhyrje emergjente në rehabilitimin e infrastrukturës që ndodhet në gjendje kritike dhe me rrezikshmëri për popullatën, ekonominë publike dhe private dhe parashikimin e kërkesave për financimin e tyre, veçanërisht komunitetit të donatorëve.
- Në fazën e rikthimit në gjendje normale, detyra e kësaj ministrie është paraqitja e situatës së përgjithshme për:
 - nevojat dhe përparësitë e rehabilitimit të infrastrukturës publike të dëmtuar dhe sigurimin e financimeve nga donatorë të huaj;
 - masat mbështetëse në drejtim të sektorit privat për riaktivizimin e bizneseve të dëmtuara në një kohë sa më të shkurtër dhe me kapacitet të plotë.

Për realizimin e funksioneve dhe të detyrave të saja, ME-ja bashkëpunon me:

- MF-në për sigurimin e financimeve dhe të ndihmave shtetërore dhe nxitjen e financimeve të donatorëve të huaj në zonat e dëmtuara
- MPVD-ja dhe organet e qeverisjes vendore për përcaktimin e nevojave parësore në rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar dhe përfshirjen e tyre në programet emergjente të riaftësimit..

AKADEMIA E SHKENCAVE (ASH)

Instituti i Hidrometeorologjisë, Sizmologjisë, Fizikës Bërthamore dhe i Gjeografisë.

ASH-ja dhe institutet në varësi të saj janë struktura vlerësuese shkencore, monitoruese, njoftuese dhe japin informacion paralajmërues në kohë emergjencash.

Akademia me institutet e saja:

- Realizon nëpërmjet rrjetit kombëtar të stacioneve dhe të grupeve në terren , vlerësimin dhe monitorimin e emergjencave dhe propozon masa mbrojtëse ndaj tyre.
- Jep asistencë teknike për situata të ndryshme emergjente dhe, kur i kërkohet, merr pjesë drejtpërdrejt në vlerësimin dhe likuidimin e pasojave.
- Jep informacione dhe ekspertizë për të gjitha strukturat e emergjencave civile, ministritë dhe institucionet e interesuara si dhe organet e qeverisjes vendore.
- Harton dhe mban statistika shumëvjeçare për ngjarjet dhe faktet e vrojtuar.
- Harton metodika për mënyrën e vrojtimit, të përpunimit dhe të vlerësimit të të dhënave.
- Angazhohet në studime dhe freskimin e të dhënave për vlerësimin e rreziqeve.

KRYQI I KUQ SHQIPTAR (KKSH)

KKSH-ja është organizatë vullnetare e shtrirë në të gjithë territorin e vendit (me zyrat qendrore në Tiranë, 12 degë dhe 40 nëndegë në nivel qarku, komune dhe bashkie). Ka një sistem radiokomunikimi si dhe kapacitete të konsiderueshme në përgjigje të emergjencave.

Veprimtaria e KKSH-së bazohet në ligjin nr. 7894, datë 29.IX.1994, “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”

Në raste të emergjencave, KKSH-ja:

- Bashkërendon aktivitetet për parandalimin, lehtësimin dhe përgjigjen ndaj emergjencave me DPPEC, MPVD, ndërsa, në nivel lokal, me administratën e qarqeve dhe organet e pushtetit vendor, bazuar edhe në Memorandumin e Mirëkuptimit, të lidhur midis MPVD-së, PNUD-it dhe DMEP-së në Shqipëri.
- Bashkëpunon me PMNZSH, MRP, MSH për të dhënat për aksidentet dhe jep kurset e ndihmës së parë, në përbërje të kurseve të licencimit për drejtimin e automjetit.
- Ngre qendra informacioni, vlerësimi dëmsh dhe nevojash, jep ndihmën e parë dhe asistencë psikologjike, shpërndan ndihma dhe siguron kushte për jetesë, gjen persona të humbur në bashkëpunim me ICRC- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Gjithashtu, nëse është e nevojshme, bën aktivitete me komunitetin në fushën e edukimit, të informimit dhe të këshillimit për lloje të ndryshme emergjencash e sidomos për çështjet shëndetësore dhe mjedisin.
- I drejton apel nëpërmjet IFRC -Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, duke përfshirë ERU-të- njësitë e përgjigjes ndaj emergjencës (spitalet fushore, njësitë e mbështetjes logjistike, njësitë e dhënies së asistencës nga ajri dhe njësitë e gjetjes të personave të humbur), nëse emergjenca i tejkalon kapacitetet e tija të përballimit. Kërkon asistencë nëpërmjet bashkërendimit të RDRT-ve, grupeve rajonale të përgjigjes ndaj fatkeqësive ose grupeve FACT- grupet e vlerësimit dhe të bashkërendimit në terren dhe bashkëpunon ngushtësisht me UNDAC-un.

C. STRUKTURAT E GATISHMERISE DHE SKEMAT E GRUMBULLIMIT TE INFORMACIONIT DHE LAJMERIMIT NE RASTET E EMERGJENCEVE CIVILE

Strukturat e gatishmërisë për emergjencat civile janë struktura monitoruese, informuese dhe të përgjigjes së menjëhershme, të cilat kanë shërbim 24-orësh ose janë të disponueshme në çdo kohë.

Strukturat e gatishmërisë, nëpërmjet dhënies së njoftimit të parë, përpunimit të informacionit dhe reagimit të shpejtë për aktivizimin e sistemit, bëjnë të mundur që strukturat e tjera të vlerësojnë situatën emergjente dhe të ndërhyjnë në kohën e duhur për stabilizimin e saj.

Shërbimi i këtyre strukturave është mjaft i vlefshëm jo vetëm në fazën e paralajmërimit, por edhe në atë të reagimit të shpejtë, për arsye se një pjesë e tyre kanë mjete dhe kapacitete për të vepruar në kohë të shkurtër dhe në fazën e reagimit.

QKOEK-ja është një nga këto struktura rreth së cilës veprojnë një sërë strukturash të tjera. Në të përqendrohet dhe përpunohet informacioni që vjen nga qendrat e tjera dhe pikat e kontakteve që kanë shërbim 24 orë dhe struktura që disponojnë informacion.

Me informacionin që ato sigurojnë, komunikimet e para dhe aktivizimin e menjëhershëm të strukturave të tyre, bëjnë të mundur vlerësimin e menjëhershëm të situatës, si dhe përfshirjen e shpejtë të strukturave të tjera kryesore në përballimin e emergjencave civile.

Përpunimi i centralizuar i informacionit në QKOEK nuk nënkupton që strukturat e tjera të përfshira nuk komunikojnë me strukturat e tyre drejtuese.

C.1 Detyrat dhe Përgjegjësitë e Strukturave të Gatishmërisë të Emergjencave Civile

Detyrat dhe Përgjegjësitë e SEC të gadishmërisë janë si vijon:

C.1-1 Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (QKOEK)

QKOEK-ja është struktura qendrore e gatishmërisë, e cila monitoron situatat e emergjencave civile në të gjithë territorin e vendit dhe shërben si pikë kontakti për mbledhjen dhe përpunimin e të gjithë informacionit. Këtu përfshihen situatat emergjente, aksidentet dhe incidentet të cilat prekin ose rrezikojnë jetën e komunitetit, pasurinë publike dhe private dhe trashëgiminë kulturore. QKOEK-ja mban lidhje të vazhdueshme me të gjitha strukturat e tjera të emergjencave civile në gatishmëri për përballimin e situatave dhe informon struktura të ndryshme shtetërore dhe median rreth gjendjes/nivelit të situatës së emergjencës. QKOEK-ja freskon rregullisht pikat e kontaktit dhe sistemet e njoftimit për strukturat e gatishmërisë.

C.1-2 Personel i arritshëm në çdo kohë

Struktura të disponueshme dhe në kontakt gjatë 24 orëve janë personeli i strukturave të Sistemit Kombëtar të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, si dhe ai i PMNZSH. Ky personel mban kontakte të vazhdueshme me strukturat e gatishmërisë për emergjencat, si dhe këshillon drejtuesit e niveleve të ndryshme për masat urgjente që duhen marrë.

C.1-3 Qendra Informacionit dhe Evakuimeve në MRP (QIEMRP) dhe Qendra e Bashkuar Operacionale në MM (QBOMM)

Këto dy struktura janë strukturat kryesore bashkëpunuese në sigurimin e informacionit dhe veçanërisht

për përgjigjen e menjëhershme, për përballimin e situatave të emergjencave civile. Kjo për arsye se forcat e PSH-së dhe Forcat e Armatosura (FA) kanë shpërndarje të gjerë gjeografike dhe mundësi për të marrë dhe për të transmetuar informacionin në mënyrë të shpejtë dhe të saktë. Këto mundësi dhe kapacitete shfrytëzohen si në grumbullimin e informacionit, edhe në reagimin e shpejtë në përgjigje të emergjencave civile.

Me marrjen e informacionit nga QKOEK-ja, i cili konsiderohet për veprim, ato zbatojnë udhëzimet dhe rregulloret e brendshme për ndjekjen e informacionit dhe, në rast nevojë, bëjnë aktivizimin e strukturave të tyre vepruese. Këto struktura janë të detyruara të informojnë QKOEK-në për veprimet e ndërmarra dhe zhvillimin e situatës në proces.

C.1-4 Forcat e Armatosura (FA), Strukturat e Policisë së Shtetit, ambulancat, PMNZSH dhe forcat e tjera operacionale

Në përputhje me natyrën e misionit të tyre në rajonin e tyre të veprimit, në momentin që marrin informacion rreth një ngjarjeje e cila ka sjellë një situatë emergjence civile ose bëhet shkas për një ngjarje të tillë, vendosen në gjendje gatishmërie. Në varësi të nivelit të situatës dhe të llojit të emergjencës, ato mund të fillojnë veprimet e tyre në bazë të kërkesës së prefektit të qarkut dhe të urdhëruara nga strukturat e tyre drejtuese në varësi të të cilave janë. Informacioni i dhënë nga QKOEK-ja dhe QOQ-ja pranë strukturave të gatishmërisë, duhet të vlerësohet prej tyre duke marrë masa për hapat e mëtejshëm.

Kur këto struktura përfshihen në përballimin e situatave të emergjencës, ato vendosin, mbajnë kontakte dhe shkëmbejnë informacione me komandat dhe strukturat e tyre përkatëse, si dhe me QKOEK-në, e cila, nga ana e saj, gjithashtu bashkërendon veprimet me strukturat e tjera dhe organet pushtetit vendor.


C.1-5 Strukturat monitoruese dhe njoftuese, si Instituti i Sizmiologjisë, Instituti i Hidrometeorologjisë (IH), Instituti i Fizikës Bërthamore (IFB), si dhe Institute, inspektoriate e struktura të tjera të kësaj natyre

Këto struktura, nëpërmjet rrjeteve të tyre të monitorimit dhe të komunikimit, marrin dhe japin informacion për QKOEK-në rreth rreziqeve apo kërcënimeve të mundshme dhe, në rast të një emergjence, bashkërendojnë aktivitetet për vlerësimin e situatës dhe të nevojave. Sigurojnë informacion të vazhdueshëm për bashkëpunim me strukturat e tjera të emergjencave civile, bëjnë analiza dhe monitorim të situatës në progres dhe japin informacion të freskuar.

C.1-6 Strukturat e gadishmërisë në shërbimet e transportit, furnizimit me ujë të pijshëm, të komunikimit dhe të energjisë elektrike


Nëpërmjet strukturave të tyre të përhershme dhe të përkohshme që veprojnë gjatë 24 orëve, përveç kontakteve me strukturat e tyre drejtuese, mbajnë kontakte të vazhdueshme me QKOEK-në dhe QOQ-në, japin informacione për ngjarjet emergjente të cilat kanë ndodhur ose ka mundësi të ndodhin në fushat e tyre të veprimit. Gjithashtu, ato kërkojnë prej tyre asistencë për përfshirjen e strukturave të tjera në përgjigjen e situatave të emergjencës. Bashkëpunojnë me strukturat e tjera rajonale dhe lokale të cilat veprojnë në rajonet e tyre.

Për disa nga emergjencat specifike, më poshtë trajtohet në mënyrë skematike mënyra e grumbullimit dhe e shpërndarjes së informacionit. QKOEK-ja dhe të gjitha qendrat apo strukturat e tjera që lidhen me emergjencat civile hartojnë skema dhe tabela me pikat e kontaktit të strukturave për emergjencat të ndryshme dhe i freskojnë ato në mënyrë periodike.



C.2 Skema e Informimit dhe Lajmerimit ne Rast Termeti

Burime te mundshme informacioni per konstatimin e ngjarjes



Në QKOEC mund të japin informacion për emergjenca shkaktuar nga rënia e një tërmeti në zona të ndryshme, çdo qytetar, Instituti i Sizmiologjisë, administrata e prefektëve, strukturat e Policisë së Shtetit, PMNZSH-ja, punonjës të ngarkuar me emergjencën civile, drejtues të njëjësive të qeverisjes vendore, strukturat e Forcave të Armatosura etj.

Informacioni i marrë nga këto burime i përcillet menjëherë:

ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, drejtorit të PPEC-së, drejtorit të PKEC-së, drejtorit të PMNZSH-së, përgjegjësit të QKOEC-së.

Në të njëjtën kohë, me QKOEC-në, informohen QBO-ja në Ministrinë e Mbrojtjes, BMC-ja dhe strukturat që kanë grupe kërkim –shpëtimi sipas inventarit në këtë plan, QEE-ja në Ministrinë e Rendit Publik, Ministria e Shëndetësisë, repartet e shërbimit të urgjencës, ambulancat dhe transporti ajror, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, reparti i kërkim - shpëtimit në miniera, KESH-i, Ministria e Transporteve dhe e Telekomunikacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujërave (DPU), Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Drejtoria e Ujë- analizimeve (DUK) dhe Sekretariati i Digave të Larta.


QKOEC-ja mban evidenca të institucioneve dhe të pikave të kontakteve, të cilat, nga ana e tyre, janë të detyruara të informojnë atë për ndryshimet që mund të kenë në lidhje me pikat e tyre të kontaktit.

Një format i listës së pikave të kontaktit jepet më poshtë:

Institucioni	Tel	Fax	Cel	✓
Q.K.Operacionale				
Ministri i PVD				
Drejtori i PPEC				
Drejtori i PKEC				
Drejtori i PMNZSH				
Pergjegjesi i QKO				
BMC				
SAR				
Sherbimi Urgjences + Helikopter				
Kerkim Shpetim Miniera				
Stacionet e PMNZSH				
KK Shqiptar				
D.P.Ujrave				
Sek.Digave.Larta				
QBO M.Mbrojtjes				
QEE ne MRP				
M.Shendetesise				
MIEnergjitikes				
M.T.Telekomunikacionit				
M.B.Ushqimit				
M.RR.T.Turizmit				

C.3 Skema e Informimit dhe Lajmerimit ne Raste Aksidentesh Industriale

Burime te mundshme informacioni per konstatimin e ngjarjes



Në QKO mund të japin informacion për fatkeqësi që lidhen me aksidente industriale në zona të ndryshme, çdo qytetar, subjekti i rrezikuar/dëmtuar, punonjësit e ngarkuar me emergjencën civile, strukturat e PMNZSH-së, strukturat e policisë, FA, inspektoratet përkatëse, prefektët, organet e pushtetit vendor, strukturat monitoruese etj


Informacioni i marrë nga këto burime i përcillet menjëherë:

Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, drejtorit të PPEC-së, drejtorit të PKEC-së, drejtorit të PMNZSH-së, përgjegjësit të QKOE-së.

Në të njëjtën kohë, informohen stacionet zjarrfikëse më të afërta, M. I. Energjetikës dhe Kërkim - Shpëtimi Miniera, M. Mbrojtjes dhe BMC-ja, M. Shëndetësisë, shërbimi i urgjencës dhe helikopter, M. Mjedisit, M.R. Publik, prefekti i qarkut përkatës dhe kryetari i b/komunes në juridiksionin e së cilës ka ndodhur aksidenti, KK Shqiptar etj.

C.4 Skema e Informimit dhe Lajmerimit ne Raste Aksidentesh Gjate Transportit te Materialeve te Rrezikshme

Burime te mundshme informacioni per konstatimin e ngjarjes



Në QKO mund të japin informacion për fatkeqësi që lidhen me aksidente gjatë transportit të materialeve të rrezikshme në zona të ndryshme, çdo qytetar, transportues, subjekt, prefekt, punonjës i ngarkuar me emergjencat civile, strukturat e PMNZSH-së, të policisë, veçanërisht roja rrugore, FA, inspektoratet përkatëse, organet e pushtetit vendor etj.


Informacioni i marrë nga këto burime i përcillet menjëherë:

Ministrin të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, drejtorit të PPEC-së, drejtorit të PKEC-së, drejtorit të PMNZSH-së, përgjegjësit të QKOE-së.

Në të njëjtën kohë informohen stacionet zjarrfikëse më të afërta, QEE-ja në M.R. Publik dhe policia rrugore, M. Mbrojtjes dhe BMC-ja, M. Shëndetësisë, Komiteti i Mbrojtjes nga Rrezatimet, M. Mjedisit dhe inspektorati i mjedisit, M.I. dhe e Energjetikës, M.T.dhe e Telekomunikacionit dhe D.P.e Rrugëve, prefekti i qarkut përkatës dhe kryetari i b/komunës në juridiksionin e së cilës ka ndodhur aksidenti, Instituti i Fizikës Bërthamore etj.

C.5 Skema e Informimit dhe Lajmerimit ne Raste Aksidentesh ne Det

Burime te mundshme informacioni per konstatimin e ngjarjes



Në QKO mund të japin informacion për fatkeqësi që lidhen me aksidente gjatë transportit në det, çdo qytetar, transportues, subjekt i rrezikuar ose goditur, media, kapiteneritë e porteve, strukturat e policisë, strukturat e forcave ushtarake detare, prefektë, punonjësi i EC, kapitenerite e porteve, Drejtoria e Përgjithshme e Transporteve, strukturat ushtarake ose policore ndërkombëtare etj.


Informacioni i marrë nga këto burime i përcillet menjëherë:

Ministrin të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, drejtorit të PPEC-së, drejtorit të PKEC-së, drejtorit të PMNZSH-së, përgjegjësit të QKOE-së.

Në të njëjtën kohë informohen: QEE-ja në M.R. Publik dhe Drejtoria e Kufirit, M.Mbrojtjes dhe Komanda e Forcave Detare, roja bregdetare, M.T.Telekomunikacionit, D.P.Transporteve dhe kapiteneria e porteve, M. Shëndetësisë, shërbimi i urgjencës, helikopterëve dhe spitalet zonale, stacioni zjarrfikës i portit më të afërt, M. Mjedisit, M.P. të Jashtme, prefekti i qarkut përkatës dhe kryetari i b/komunës në juridiksionin e së cilës ka ndodhur aksidenti etj.

C.6 Skema e Informimit dhe Lajmerimit ne Raste Aksidentesh Ajrore

Burime te mundshme informacioni per konstatimin e ngjarjes



Në QKO mund të japë informacion për fatkeqësi që lidhen me aksidente gjatë transportit ajror, çdo qytetar, media, Shërbimi i Kontrollit të Trafikut Ajror, strukturat e policisë, strukturat e FA, organet e pushtetit, Qendra Operacionale Ndërkombetare etj.


Informacioni i marrë nga këto burime i përcillet menjëherë:

ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, drejtorit të PPEC-së, drejtorit të PKEC-së, drejtorit të PMNZSH-së, përgjegjës të QKOEC-së.

Në të njëjtën kohë informohen: M.T.Telekomunikacionit dhe D.P.Aviacionit Civil, M.Mbrojtjes, shërbimi i kërkim-shpëtimit të FA - SAR, QEE në M.R. Publik, Drejtoria e Policisë së Shtetit, M. Shëndetësisë, shërbimi i urgjencës, helikopterëve dhe spitaleve zonale, stacioni zjarrfikës më i afërt, M.P.Jashtme, prefekti i qarkut përkatës dhe kryetari i b/komunës në juridiksionin e së cilës ka ndodhur aksidenti etj.

C.7 Skema e Informimit dhe Lajmerimit ne Raste Aksidentesh Shkaktuar nga Aktet Terroriste

Burime te mundshme informacioni per konstatimin e ngjarjes



Në QKO mund të japë informacion për emergjencat e shkaktuara nga akte terroriste, çdo qytetar, media, strukturat e policisë, FA, PMNZSH, prefekt, punonjës i EC-së, organe të Pushtetit Vendor, struktura të SHISH-it etj.


Informacioni i marrë nga këto burime i përcillet menjëherë:

ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, drejtorit të PPEC-së, drejtorit të PKEC-së, drejtorit të PMNZSH-së, përgjegjësit të QKOE-së.

Në të njëjtën kohë, informohen: QEE-ja në MRP, Drejtoria e Policisë së Shtetit, M.Mbrojtjes dhe BMC, Forcat Speciale, M. Shëndetësisë, shërbimi i urgjencës, helikopterëve dhe spitalet zonale, stacioni zjarrfikës më i afërt, sipas rastit, struktura të specializuara për ndotjen kimike, bakteriologjike dhe radioaktive, SHISH-i dhe ministria e linjës, nëse mbulon objektin ku ka ndodhur akti terrorist, si dhe prefekti i qarkut përkatës dhe kryetari i b/komunës në juridiksionin e së cilës ka ndodhur ngjarja.

C.8 Skema e Informimit dhe Lajmerimit ne Raste Shperthimi Digash dhe Dambash

Burime te mundshme informacioni per konstatimin e ngjarjes:



Në QKO mund të japë informacion për fatkeqësi që lidhen me rrezikun e shpërthimeve të digave dhe të dambave, çdo qytetar, persona të ruajtjes dhe shfrytëzues, media, punonjës i EC-së në njësi vendore, strukturat e policisë, PMNZSH, FA, organet e pushtetit vendor, MRRTT, MBU, MIE, Qendra e Bashkuar e Operacionale në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe Qendra e Emergjencave dhe e Evakuimit në Ministrinë e Rendit Publik.

Informacioni i marrë nga këto burime i përcillet menjëherë:

ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, drejtorit të PPEC-së, drejtorit të PKEC-së, drejtorit të PMNZSH-së, përgjegjësit të QKOE-së.

Në të njëjtën kohë, informohen MRRTT-ja, MBU-ja dhe D.Përgj.Ujërave, prefekti i qarkut përkatës dhe kryetari i b/komunës në juridiksionin e së cilës ndodhet diga/damba, MM-ja dhe repartet e Forcave të Armatosura më të afërta, MRP-ja dhe komisarjate të policisë në zonë, MSH-ja, shërbimi i urgjencës, helikopterëve dhe spitaleve zonale, MTT-ja, MIE-ja dhe KESH-i, MASH-i dhe ministri dhe institucione të tjera.

D. FORMATET E RAPORTEVE DHE TË KËRKESAVE

D.I Raporti i njoftimit të parë

FORMULARI I

NJOFTIMI I PARË PËR KONSTATIMIN E FATKEQËSIVE

Karakteri i njoftimit

URGJENT

Nr. i Qendrës Operacionale _____

Koha e plotësimit të formularit: Në çastin që njoftoheni apo konstatooni ndodhjen e një fatkeqësie.

Qëllimi: Verifikimi i njoftimit, karakteri dhe lloji i fatkeqësisë, përmasat si dhe ndikimet e saj.

Plotësohet nga: Persona përgjegjës, bazuar në vëzhgimin personal apo marrjen dijeni nga persona të përgjegjshëm.

Lloji i fatkeqësisë së konstatuar / njoftuar:

Tërmet

Përmytje

Zjarr në banesa

Shkatërrim dige

Rrëshqitje masive dheu

Aksident

Zjarr në pyje

Blokime nga bora

Të tjera _____

Koha e ndodhjes së fatkeqësisë: ora _____ data _____

Vendndodhja: Në territorin e _____
(qarkut, bashkisë, komunës, fshatit)

Cili është burimi i informacionit _____

Ka njoftim për viktimal/ të plagosur/ të humbur? PO JO

Keni informacion për dëme materiale/ infrastrukturë? PO JO

Kërkohet ndihmë urgjente e specializuar? PO JO

Keni njoftuar eprorin tuaj? PO JO

Koha e plotësimit të formularit: ora _____ data _____

Personi informues _____ me detyrë _____ në _____ .(institucioni)

Vendndodhja e institucionit, qarku _____ rrethi _____ bashkia/komuna _____ fshati _____

Numri i telefonit tuaj apo mënyrë tjetër komunikimi _____

Njoftuesi

D.2 Raporti i të dhënave të para për emergjencën

FORMULARI 2

RAPORT I TË DHËNAVE TË PARA PËR FATKEQËSINË

Karakteri i informacionit

I RËNDËSISË SË VEÇANTË

Rëndësia e plotësisimit të formularit: bëhet përcaktues për njohjen më në detaje të llojit të fatkeqësisë dhe shërben për marrjen e masave urgjente, apo për plotësimin e kushteve për shpalljen e gjendjes së emergjencave civile.

Koha e plotësisimit: jo më vonë se 24 orë nga çasti i ndodhjes së fatkeqësisë.

Vëmendja kryesore: Vërtetësia e informacionit të parë për ndodhjen e fatkeqësisë, vendndodhjen e saktë të saj, shtrirjen territoriale, si dhe pasojat.

Lloji i fatkeqësisë së konstatuar:

Tërmet

Përmytje

Zjarr në banesa

Shkatërrim dige

Rrëshqitje masive dheu

Aksident

Zjarr në pyje

Blokime nga bora

Të tjera _____

Koha e ndodhjes së fatkeqësisë: ora _____ dt _____

Vendndodhja: Në territorin e _____
(qarkut, bashkisë, komunës, fshatit)

Cili është burimi i informacionit _____

Saktësia e informacionit _____ (i saktë, ndoshta i saktë, i dyshimtë)

Cilat janë aktivitetet e ndërmarra nga strukturat lokale deri në çastin e raportimit?

A janë evidentuar kërcënime dytësore si rrjedhojë e fatkeqësisë?

Dëmtime në njerëz:

Numri i viktimave: i vërtetuar _____ i pavërtetuar _____

Numri i të zhdukurve: i vërtetuar _____ i pavërtetuar _____

Numri i të plagosurve rëndë: i vërtetuar _____ i pavërtetuar _____

Dëmtime në objekte

Të shkatërruara: objekte banimi kolektive PO JO

shtëpi individuale PO JO

spitale PO JO

konvikte PO JO

Të dëmtuara rëndë: objekte banimi kolektive PO JO

shtëpi individuale PO JO

spitale PO JO

konvikte PO JO

Dëmtime në infrastrukturë

Rrjeti i furnizimit me ujë, _____ (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të furnizimit me ujë.

Rrjeti i furnizimit me energji elektrike, _____ (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të furnizimit me energji.

Ura _____ në rrugë nacionale (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të qarkullimit.

Segmenti rrugor/rruga _____ (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me/pa ndërprerje të qarkullimit.

Kërkohet ndihmë _____ (urgjente/e menjëhershme) në zonën e _____ me/ për _____

Shënime të veçanta

Njoftimi bëhet sot, më ora _____ date _____

Nga _____ me detyrë _____ në _____ (institucioni).

Vendndodhja e institucionit, qarku _____ rrethi _____

Bashkia / komuna _____ fshati. _____

Informoi

(Firma / vula e institucionit)

D.3 Formati i raportimit të situatës për organizmat ndërkombëtare

(Shembull)

Raporti i situatës së emergjences në nivel kombëtar, për organizmat ndërkombëtare përmbledh të gjithë informacionin dhe vlerësimet për dëmet dhe nevojat për përballimin e emergjences, duke dhënë një tablo të përgjithshme lidhur me efektet, si dhe aktivitetet vijuese për menaxhimin e saj.

Përgatitur nga: _____

Per: _____

Data e raportit: _____

I. Situata e Emergjences

- Përshkrimi i situatës
 - o Specifikoni: ngjarjen, shkaku, magnitudën/intensitetin kur është i zbatueshëm, datën, kohën dhe vendin, duke e lidhur me shpjegime të veçanta të cilat mund të identifikohen në hartë.
- Zona e prekur
 - o Specifikoni: emrin, përmasat, klimën, topografinë dhe vlerësimin e popullsisë në zonën e prekur, zonat më të prekura nga fatkeqësia.
- Ndikimi:
 - o Dëmtime sipas sektorëve, p.sh: ndërtesat, infrastrukturen, objektet dhe shërbimet publike etj.
 - o Efektet mbi popullsinë, p.sh: numri i të vdekurve, të humburve, të pastrehëve.
- Kërcënimet dytësore. Si pritet të zhvillohet situata, duke përfshirë
 - o efektet/kërcënimet dytësore, p.sh., reshje të mëtejshme, lëvizje e popullsisë,
 - o kushtet atmosferike sezonale të pritshme.
 - o përhapja e lëndëve helmuese ose të rrezikshme etj

II. Reagimi në nivel kombëtar ndaj emergjences

- Organizimi.
 - o Specifikoni: autoritetet përgjegjëse për drejtimin e përgjithshëm të përballimit të situatës dhe për aspekte të veçanta, strukturat bashkërenduese dhe personat/institucionet e kontaktit për asistencën ndërkombëtare etj.
- Masat administrative.
 - o Lloji dhe ndikimet e pritshme të masave të marra, p.sh: deklarimi i situatës së emergjencës, sigurimi i mjeteve të transportit, kontrolli i lëvizjeve të çmimeve në treg.
- Operacionet/ mobilizimi i burimeve.
 - o Përshkruani veprimet e kërkim-shpëtimit, se çfarë fondesh, materialesh, transporti dhe personeli janë mobilizuar në shkallë kombëtare.
 - o Përshkruani si po i përballon efektet e kësaj emergjence pushteti vendor dhe popullsia e prekur. Cilat burime janë mobilizuar në nivel vendor?
- Pengesat.
 - o Fushat të cilat përgjigja dhe kapacitetet kombëtare/lokale e kanë të pamundur t'i përballojnë.

III. Reagimi ndërkombëtar ndaj emergjences

- o Përshkruani cili ka qenë reagimi ndërkombëtar ndaj kësaj situatë. Specifikoni cilat qeveri apo organizata kanë ofruar tashmë ndihmë, ç'loj ndihme, kur dhe ku janë dërguar.
- o Specifikoni listën e premtimeve dhe të kontributeve të tjera dhe datat e planifikuara për mbërritjen e tyre.

IV. Nevojat për ndihmë humanitare

- Nevojat me përparësi sipas këtyre specifikimeve:

- o Kërkim – shpëtimi.
- o Grupet mjekësore dhe ilaçet.
- o Strehimet e përkohshme, çadrat, shtresa, mbulesa, veshjet, pajisjet shtëpiake.
- o Uji dhe higjena.
- o Artikujt ushqimorë.
- o Logjistika (transportin brenda vendit, magazinimin dhe trajtimin e artikujve të ndihmës).
- o Mjete komunikimi.
- o Riparimet në infrastrukturë.
- o Ekspertize për vlerësime sipas sektorëve, bashkërendimin.
- o Të tjera.
- o Specifikoni artikujt që nuk duhen. Shpjegoni pse.

V. Mundësitë për ndihmën ndërkombëtare

- Kontributet në para.
 - o Specifikoni saktësisht: cilit dhe ku duhet të dërgohen paratë (duke dhënë numrin e llogarisë bankare, kur është e përshtatshme).
- Kontributet në natyrë.
 - o Specifikoni: adresën e marrësit të ngarkesës për artikuj të veçantë të ndihmës për t'u shpërndarë në porte/ aeroporte të ndryshme, formalitetet e lejeve të hyrjes, kostot, vonesat e mundshme, detajet për lehtësirat aeroportuale për menaxhimin e ndihmës dhe personelit ndërkombëtar, vendndodhjen dhe kapacitetet e magazinimit të ndihmës etj.

VI. Veprimet bashkërenduese

- o Specifikoni mekanizmat (p.sh, takimet, faqja e internetit) për bashkërendimin e përgjigjes së donatorëve, qeverisë dhe agjencive të tjera.

VII. Informacione të tjera

Kontaktet me personin/institucionin emri _____, titulli _____
 adresa _____.

D.4 Format kërkesë drejtuar kryeministrit ose ministrit të Mbrojtjes për angazhimin e FA

(Shembull)

KËRKESË

Nr. 1

Urgjent

Për: Z/Znj. _____
Kryeminister/ Ministër i Mbrojtjes i RSH
Tiranë

Nga: _____

Z/Znj. Kryeminister/Ministër,

Më datë _____, në ultësirën bregdetare të qarkut _____ nga zona e _____ deri në zonën e _____, si pasojë e reshjeve intensive, të rëna nga data _____ deri në datën _____, është përmbytur një territor i konsiderueshëm sipërfaqe toke bujqësore si dhe fshatrat _____.

Niveli i ujërave është rritur deri në _____ m, në zonat pranë bregdetit deri në _____ m në zonat fshatare të banuara _____ m.

Nisur nga vështirësitë e konstatuara nga grupi i vleresimit, i ngritur me urdhër të _____, nga vazhdimi i pandërprerë i reshjeve edhe në këto çaste si dhe nga parashikimi i motit për ditët në vazhdim, gjendja e konstatuar konsiderohet tepër e vështirë, si për banorët, bagëtitë, të mbjellat, edhe për subjeket e tjera private që kryejnë aktivitetet në këto zone.

Grupi i vleresimit i ngarkuar për këtë qëllim konstaton se:

Rrezik emergjent paraqet zona e fshatrave _____, banorët e së cilës kërkohet të evakohen jo më vonë se 12 orët e ardhshme.

Numri i banorëve me në rrezik _____ banorë.

Numri i bagëtitë në këtë zonë _____ bagëti (të imëta dhe të trasha).

Kemi përcaktuar vendin e vendosjes së të evakuarve, por, në pamundësi të disponimit të mjeteve të posaçme të përshtatshme për ndërhyrje në zonat e përmbytura dhe mjediseve të përshtatshme për strehim, kërkohet:

Ndërhyrjen e Forcave të Armatosura me efektiva, mjete lundruese të përshtatshme për zona të përmbytura, mjete transporti, helikopterë për shpëtim, çadra për strehim familjar, personel mjekësor si dhe materiale të tjera për strehim të perkohshëm për rreth _____ njerez. Efektivi dhe mjetet e ndërhyrjes të llogaritet në bazë të numrit të banorëve dhe të bagëtitë të evidentuara më sipër.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë po ju dërgojmë edhe një hartë të zonës së prekur nga përmbytja, duke evidentuar rrugët, urat dhe vendet ku, për momentin, është i mundur afrimi i efektivave të te FA sa më afër zonave të banimit të përmbytura.

Jemi në pritje të ardhjes sa më të shpejtë të forcave mjeteve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Numri i kontaktit _____

Më poshtë po ju paraqesim disa të dhëna dhe kërkesa të detajuara rreth zonës së përmbatur.

Nr.	Fshati i përmbatur	Numri i familjeve	Numri i banorëve	Bagëti	Niveli i ujit	Distanca më e afërt e mundshme	Rrugë e lirë	Ura të dëmtuara	Nevojë për evakuim me helikopterë
1	Fshati "A"	120	560	250	1.5 km	0.8 km	Jo	Jo	Jo
2	Fshati "B"	85	340	150	1.7 km	1.0 km	Po	Po	Po

SHKURTIMET

Akademia e Shkencave.	ASH
Bashkimi European.	BE
Baza e Mbrojtjes Civile.	BMC
Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile	DPPEC
Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve	DPRr
Drejtoria e Pergjithshme e Rezervave të Shtetit.	DPRSH
Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve	DPRR
Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimit	DPUK
Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile.	DPKEC
Drejtoria e Uje Kanalizimeve	DUK
Drejtoria e Ujrave	DU
Drejtuesi Qendror i Operacionit.	DQO
Drejtuesi i Operacionit në Qark.	DOQ
Ekipi i Menaxhimit të Emergjencave Civile.	EMEC
Emergjence Civile.	EC
Enti Kombetar i Banesave.	EKB
Forcat e Armatosura.	FA
Forcat Operacionale.	FO
Gjëndje e Emergjencës Civile	GJEC
Kërkim – Shpetimi	SAR
Grupi i OKB për Vlerësimin dhe Bashkërendimin e Fatkeqësive.	UNDAC
Grupi Ndërkombëtar Këshillues i Kërkim Shpetimit.	INSARAG
Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes Civile.	IKMC
Instituti i Fizikes Berthamore	IFB
Instituti i Hidrometereologjise	IH
Instituti i Sismilogjise	IS
Instituti i Studimeve Urbanistike.	ISU
Këshilli i Ministrave	KM
Këshilli i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.	KRRTT
Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.	KRRTRSH
Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark.	KPPECQ
Komisioni Teknik Këshillimor i Specialistëve të Emergjencave Civile.	KTKSEC
Komisioni Vendor i Emergjencave Civile.	KVEC
Komiteti Nderministror i Emergjencave Civile	KNEC
Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	KESH
Kryqi i Kuq Shqiptar	KKSH
Ministra e Punëve të Jashtme	MPJ
Ministria e Arsimit dhe Shkences	MASH
Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.	MBU
Ministria e Drejtësisë	MD
Ministria e Ekonomise	ME
Ministria e Financave	MF
Ministria e Industrisë dhe Energjitikës	MIE
Ministria e Kultures Rinise dhe Sporteve	MKRS
Ministria e Mbrojtjes	MM
Ministria e Mjedisit.	MMj
Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	MPÇS
Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.	MPV&D

Ministria e Rendit Publik	MRP
Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	MRRT&T
Ministria e Shëndetësisë.	MSH
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit.	MTT
Operacionet e Emergjencave Civile	OEC
Organizata Boterore e Shendetesise	OBSH
Plani i Gadishmërisë së Kombeve të Bashkuara	PGKB
Plani Kombëtar i Emergjencave Civile.	PKEC
Policia e Mbrojtës nga Zjarri dhe Shpetimi.	PMNZSH
Policia e Shtetit	PSH
Qendra e Bashkuar Operacionale e Ministrisë së Mbrojtjes	QBOMM
Qendra e Informacionit dhe Evakuimi në Ministrinë e Rendit Publik	QIEMRP
Qendra Kombëtare e Trajnimeve	QKT
Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile.	QKOEC
Qendra Operacionale në Qark	QOQ
Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	SHGJSH
Sherbimi i Emergjencave Civile.	SHEC
Sherbimi i Kërkim Shpetimit.	SHKSH
Sherbimi i Urgjencës	SHU
Sistemi i Menaxhimit të Emergjencave Civile	SMEC
Sistemi Kombëtar i Sherbimit të Emergjencave Civile.	SKShEC
Strukturat Aktive Vepruese	SAV
Strukturat e Emergjencave Civile.	SEC
Strukturat Mbështetëse	SM

Sqaruese: Ne disa organograma dhe skema ne kete plan jane perdorur dy lloj shigjetash te cilat jane perdorur per te treguar mardheniet e meposhteme:

- ▶ Mardhenie bashkepunimi
- ▶ Mardhenie vartesis (per organogramat)
- ▶ Shkembim informacioni (per skemat e informacionit dhe lajmerimit)

Ne procesin e hartimit te Planit Kombetar për Emergjencat Civile, kontribuan:

I. Grupi i punës:

1	Z. Pajtim Bello	Zevendesminister i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
2	Z. Sadedin Stankaj	Zevendesminister i Mbrojtjes
3	Zj.Saemira Pino	Zevendesministre e Shendetesise
4	Z. Eduart Andoni	Zevendesminister i Arsimit dhe Shkences
5	Z. Arben Demeti	Zevendesminister i Rregullimit te Territorit dhe Turizmit
6	Z. Proletar Roshi	Zevendesminister i Transporteve dhe Telekomunikacionit
7	Z. Thoma Miço	Zevendesminister i Punes dhe Çeshtjeve Sociale
8	Z. Ymer Tola	Zevendesminister i Bujqesise dhe Ushqimit
9	Z. Gjergj Liqejza	Zevendesminister i Industrise dhe Energjitikes
10	Z. Thoma Jano	Zevendesminister i Rendit Publik
11	Z. Besnik Baraj	Zevendesminister i Integritimit
12	Zj.Etleva Canaj	Zevendesministre e Mjedisit
13	Zj.Adriana Berberi	Zevendesministre e Financave
14	Z. Enis Hoxha	Sekretar i Pergjithshem i Ministrise se Ekonomise
15	Z. Edmond Dragoti	Zevendesminister i Kultures Rinise dhe Sporteve
16	Z. Eduart Sulstarova	Sekretar i Pergjitheshem i Akademise se Shkencave
17	Z. Zamir Muço	Sekretar i Pergjitheshem i Kryqi te Kuq Shqiptar
18	Zj.Manjola Banja	Zevendesdrejtore e Institutit te Hidrometeorologjise
19	Z. Llambro Duni	Shef i Sektorit të Sizmiologjisë Inxhinierike, Instituti i Sizmiologjisë

2. Grupi teknik

1	Z. Bujar Kapllani	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
2	Z. Alfred Kristuli	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
3	Z. Sokol Hajro	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
4	Z. Alfred Prifti	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
5	Z. Agim Bregasi	Ministria e Industrisë dhe Energjitikës
6	Z. Agim Selenica	Instituti i Hidrometeorologjisë, Akademia e Shkencave
7	Z. Gramoz Bregu	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
8	Z. Vasil Premçi	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
9	Z. Armand Skapi	Ministria e Punëve të Jashtme
10	Z. Salvator Bushati	Akademia e Shkencave
11	Z. Gavrosh Qatipi	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
12	Z. Musa Hyka	Ministria e Financave
13	Z. Ferjat Janushaj	Ministria e Rendit Publik
14	Z. Gjergji Sotiri	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
15	Z. Arjan Avrazi	Ministria e Rinisë dhe Sporteve
16	Z. Dhimiter Dervishi	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve
17	Z. Arjan Bundo	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve
18	Zj.Silva Bino	Ministria e Shëndetësisë
19	Z. Sami Bidollari	Ministria e Shëndetësisë
20	Z. Hysen Gjyli	Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
21	Z. Nexhmedin Dumani	Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
22	Z. Thanas Tane	Ministria e Mbrojtjes
23	Z. Nazmi Cahani	Ministria e Mbrojtjes
24	Z. Vojo Tasho	Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit
25	Zj.Fatbardha Zenelaj	Ministria e Integritimit European
26	Z. Thoma Rusha	Ministria e Ekonomisë
27	Z. Fatos Xhengo	Kryqi i Kuq Shqiptar
28	Z. Hajredin Kurti	Administrata e Prefektit të Tiranës
29	Z. Ruzhdi Baxhaku	Bashkia Tirane

3. Sekretariati Teknik

1	Z. Bujar Kapllani	Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të EC, MPVD
2	Z. Adrian Bala	Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të EC, MPVD
3	Z. Xhuvanaq Gjylameti	Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të EC, MPVD
4	Zj.Valentina Golemi	Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të EC, MPVD
5	Znj.Dukate Dodaj	Drejtorja e Planifikimit dhe Koordinimit të EC, MPVD

4. Projekti i PNUD –it per Menaxhimin e fatkeqësive dhe parapërgatitjet ndaj emergjencave

1	Z. Mihallaq Spirollari	Oficeri Kombëtar i projektit
2	Znj. Sonila Aliaj	Koordinatorë e projektit për Trainimet
3	Zj. Entela Ifti	Asistente e projektit

5. Konsulenti për Planin Kombëtar të Emergjencave Civile

Z. Lawrence Neil Barry	Konsulent Ndërkombëtar i PNUD-it, Mbretëria e Bashkuar
------------------------	--

Përgatitja e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile u mundësua nga :



DFID Department for
International
Development



Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile

Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel: +355 4 233542 • Fax: +355 4 233544

www.mpvd.gov.al/dpppec/index.htm